

# Raporti vjetor 2018



## Përmbajtja

---

Përmbajtja	2
Lista e shkurtimeve	3
HYRJE	4
Funksionimi i INSTAT	6
Strategjia e zhvillimit të INSTAT	18
Sistemi Kombëtar Statistikor dhe Zbatimi i PSZ	25
Aksione të reja statistikore gjatë vitit 2019	36
Censi i Popullsisë dhe Banesave	39
Cilësia e të dhënave	42
Komunikimi dhe Publikimet	50
Marrëdhëniet me jashtë dhe Integrimi Evropian	65
Burimet njerëzore dhe financiare	76
Zbatimi i rekomandimeve	84
Kontaktet e institucionit	91

**Lista e shkurtimeve**

---

AFP	Anketa e forcave të punës
AKP	Anketa e kostos së punës
ANR	Anketa e ndërmarrjeve të reja
ANJL	Anketa e njësisive lokale
APC	Anketa post-census
ASN	Anketa strukturore e ndërmarrjeve
ATN	Anketa tremujore e ndërmarrjeve
BE	Bashkimi Evropian
CAPI	Intervista me kompjuter
CATI	Intervista me telefon
CFCU	Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve
DAP	Departamenti i Administratës Publike
EDP	Procedura e Deficit të Tejkualuar
ESA	Sistemi Evropian i Llogarive
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GIS	Informacioni Gjeo-hapsinor
IÇK	Indeksi i çmimeve të konsumit
IÇP	Indeksi i çmimeve të prodhimit
INSTAT	Instituti i Statistikave
IPA	Instrumenti Mbështetës para Pranimit në BE
ISCO	Klasifikimi i Profesioneve
KS	Këshilli i Statistikave
NVE	Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike
NJEF	Njësi ekonomike familjare
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
PSZ	Programi i Statistikave Zyrtare
SCB	Zyra e statistikave të Suedisë
SIDA	Agjencia Suedeze për Zhvillim
SKS	Sistemi Kombëtar Statistikor

## HYRJE

---

Të dashur lexues,

Është kënaqësi e veçantë të prezantoj Raportin Vjetor të Institutit të Statistikave për vitin 2018, i cili paraqet një pasqyrë të aktiviteteve të INSTAT dhe Sistemit Kombëtar Statistikor.

INSTAT, si institucioni kryesor prodhues i statistikave zyrtare dhe koordinatori i Sistemit Kombëtar Statistikor, në përbushje të misionit të tij për prodhimin e statistikave asnjëanëse, transparente dhe të përditësuar, të cilat ndihmojnë në gjykimin e përdoruesve mbi proceset e zhvillimit e transformimit në fushat ekonomiko-sociale brenda vendit, synon të ofrojë të dhëna të besueshme dhe të krahasueshme, duke përshtatur metodologjitë dhe duke shtuar listën e treguesve statistikorë nga viti në vit.

Viti 2018 ishte një vit i mbushur plot me sfida dhe risi për Sistemin Kombëtar Statistikor dhe Institutin e Statistikave në veçanti. Ndër sukseset kryesore përmenden ato në drejtim të përmirësimit të kuadrit ligjor mbi të cilin INSTAT ushtron veprimtarinë e tij, pozicionimi i tij në një shkallë më të lartë hierarkie, forcimi i pavarësisë profesionale dhe mandatit për hyrjen në të dhënat administrative dhe zgjerimi i autonomisë në përdorimin e burimeve të veta. Kuadri i ri ligjor mundësoi pasqyrimin e drejtpërdrejtë të interesave të përdoruesve në statistikat zyrtare që prodhon Sistemi Kombëtar Statistikor, nëpërmjet riformatimit të Këshillit të Statistikave, tashmë me përfaqësues nga përdoruesit e statistikave.

Përgjatë vitit 2018, INSTAT u përqëndrua në fillimin e punëve përgatitore për Censin e ardhshëm të Popullsisë e Banesave. Për këtë qëllim u bë e mundur përgatitja e një strategjie të domosdoshme për evidentimin e rrugës që duhet ndjekur dhe burimet e nevojshme, për të garantuar suksesin e këtij operacioni madhor.

Sistemi Statistikor Shqiptar po përballet me sfida të mëdha, që lindin nga kërkesa për një grup më të gjerë të treguesve statistikorë.

Gjatë vitit 2018, INSTAT u angazhua në zbatimin e objektivave të paravendosura në kuadër të strategjisë së zhvillimit të institucionit.

Në kaudër të prodhimit statistikor, INSTAT rriti numrin e publikimeve në 159, nga 137 që ishin në vitin 2017, duke u rritur kështu me 22 publikime, nga të cilat 12 të reja. Për të rritur eficiencën, cilësinë dhe kosto-efektivitetin, gjatë 2018, INSTAT u angazhua në rritjen e burimeve të të dhënave administrative.

Në kuadër të përmirësimit profesional dhe organizativ i Sistemit Kombëtar Statistikor, gjatë 2018, INSTAT, në zbatim të strategjisë së trajnimeve është angazhuar në ngritjen e qendrës së trajnimit statistikor në bashkëpunim me ASPA, për trajnimin e Institucioneve publike mbi njohuritë statistikore; ka nënshkruar 5 Memorandume Mirëkuptimi të reja me ministrinë e linjës apo institucione të tjera publike; ka intensifikuar bashkëpunimin me botën akademike si dhe ka publikuar për herë të parë revistën e tij shkencore “Kërkimi”.



Në kaudër të modernizimit të institucionit dhe rritjes së komunikimit me grupet e ndryshme të përdoruesve, INSTAT është angazhuar në zhvillimin e sistemeve inovative ITC për përpunimin statistikor, në përmbushje të strategjisë së Teknologjisë së Informacionit dhe të strategjisë së komunikimit, të dyja të miratuara gjatë viti 2018.

Gjatë vitit 2019, janë parashikuar të kryhen në total 308 aktivitete statistikore dhe jo statistikore. Plani Vjetor, i miratuar nga Kuvendi, parashikon gjithashtu kryerjen e 185 aktiviteteve mbështetëse statistikore, të cilat lidhen me natyrën e administrimit të institucionit dhe rritjen e performancës së tij.

Me qëllim zgjerimin e të dhënave të disponueshme për përpunim statistikor si dhe numrin e treguesve statistikorë, gjatë vitit 2019 do të zhvillohen disa anketa të reja, publikimi i rezultateve, të të cilave do të shoqërohet me aktivitete prezantuese, konferenca, workshope etj.

Me qëllim rritjen e cilësisë së statistikave në nivel vendor dhe zgjerimin e gamës së tyre, në vitin 2018, INSTAT do të angazhohet në ndërtimin dhe përforsimin e mekanizmave të sigurimit të statistikave në nivel vendor, aq të domosdoshme për pushtetin e vetëqeverisjes vendore për hartimin e politikave zhvillimore dhe matjen e performancës.

Gjatë vitit 2019, stafi i INSTAT do të përqendrohet në përmirësimin e cilësisë dhe angazhimin e stafit në artikuj shkencorë dhe akademikë; vlerësimin e cilësisë së aktiviteteve statistikore nëpërmjet auditimit/vetvlerësimit statistikor; forcimin e Sistemit Kombëtar Statistikor nëpërmjet intensifikimit të marrëdhënieve ndër-institucionale dhe zbatimit të metodologjive bashkëkohore.

Viti 2019 është një vit i rëndësishëm në kuadër të procesit të antarësimit të Shqipërisë në BE. Në këtë drejtim, INSTAT si prodhues i statistikave zyrtare ka rol kyç në monitorimin e arritjes së objektivave të shtetit shqiptar dhe kjo do të kërkojë vëmendje dhe angazhim maksimal të institucionit në përmbushjen e detyrimeve të këtij procesi thelbesor për vendin.

Së fundi, me lejon të falenderoj ekspertet dhe drejtuesit e institucionit për përkushtimin dhe profesionalizmin e treguar gjatë vitit në arritjen e objektivave të Institucionit.

Delina IBRAHIMAJ  
Drejtor i Përgjithshëm i INSTAT

## Funksionimi i INSTAT

---

### Misioni i INSTAT

Misioni i INSTAT-it është të prodhojë statistika asnjëanëse, transparente dhe të përditësuara, të cilat ndihmojnë në gjykimin e përdoruesve mbi proceset e zhvillimit e transformimit në fushat ekonomiko-sociale brenda vendit.

### Vizioni i INSTAT


INSTAT, si institucioni kryesor prodhues i statistikave zyrtare dhe koordinatori i Sistemit Kombëtar Statistikor, synon të ofrojë të dhëna të besueshme dhe të krahasueshme, duke përshtatur metodologjitë dhe duke shtuar listën e treguesve statistikor.

INSTAT, si burimi kryesor i informacionit statistikor, u përgjigjet kërkesave gjithnjë e në rritje të përdoruesve për vendimmarrje dhe kërkime, duke shpërndarë informacionin statistikor në të njëjtën kohë për të gjithë grupet e përdoruesve.

Gjithashtu, INSTAT ndihmon edhe komunitetin ndërkombëtar të interesuar nëpërmjet sigurimit të informacionit statistikor të sigurt dhe të krahasueshëm.

## Struktura e re e Institutit të Statistikave

Në fund të vitit 2018, gjendja faktike në INSTAT kishte 192 punonjës, nga të cilët 176 punonjës të shërbimit civil dhe 16 punonjës administrativ, si dhe 24 pozicione vakante.



## Legjislacioni

Veprimtaria e INSTAT dhe krejt Sistemit Kombëtar Statistikor ushtrohet në përputhje me Ligjin Nr.17/2018 “Për statistikat zyrtare”, aktet nënligjore për zbatimin e tij, Programin e Statistikave Zyrtare për periudhën 2017-2021, miratuar me Vendimin e Kuvendit nr. 10/2017, datë 09.02.2017, si dhe aktet e tjera të cilat rregullojnë veprimtarinë e institucioneve prodhuese të statistikave zyrtare, mbrojtjen e të dhënave personale etj.

Gjithashtu, bazuar në Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit, konventat e marrëveshjet e tjera me institucionet ndërkombëtare, institucionet prodhuese të statistikave zyrtare në vend synojnë të përfrojnë standardet statistikore të përcaktuara vecanërisht me Rregulloren (KE) nr.223/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 11 mars 2009, “Mbi statistikat evropiane, e cila shfuqizon rregulloren (KE, Euroatom) nr.1101/2008, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi dërgimin e të dhënave, të

cilat i nënshtrohen konfidencialitetit statistikor, Zyrës Statistike të Komuniteteve Evropiane, rregulloren e Këshillit (KE) nr.322/97, “Mbi statistikat e komunitetit”, dhe vendimin e Këshillit 89/382/EEC, Euroatom, “Për krijimin e një komisioni mbi programet statistikore të Komuniteteve Evropiane”, (Numri CELEX: 32009R0223, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr.87, datë 31.3.2009, faqe 164 – 173), ndryshuar me rregulloren (KE) e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 29 prill 2015.

Instrumentë të tjerë rregullatorë janë edhe marrëveshjet e mirëkuptimit, të nënshkruara me institucionet që furnizojnë prodhuesit me të dhëna administrative si edhe institucionet që ndikojnë në zhvillimin e cilësisë statistikore.

Vendimet e Këshillit të Ministrave për miratimin e klasifikimeve statistikore janë gjithashtu pjesë e kornizës ligjore që siguron harmonizimin e emërtimeve dhe kodifikimeve të produkteve, mallrave e shërbimeve nga të gjitha institucionet publike, dhe, për rrjedhojë, edhe harmonizimin e definicioneve të tyre nga pikëpamja statistikore, në përputhje me klasifikimet statistikore ndërkombëtare.

#### **Programi Pesëvjeçar i Statistikave Zyrtare**

Programi Pesëvjeçar i Statistikave Zyrtare (PSZ) është dokumenti bazë që parashikon prodhimin nga Sistemi Kombëtar Statistikor të dhënave statistikore të nevojshme për vëzhgimin e gjendjes ekonomike, shoqërore dhe mjedisore në Republikën e Shqipërisë, duke respektuar garancinë e zbatimit të parimeve statistikore të parashikuara në ligj, në Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice)<sup>1</sup> dhe parimet themelore të Kombeve të Bashkuara (Fundamental principles).

#### **Parimet e statistikave zyrtare**

Për të siguruar besueshmërinë e publikut në statistikat zyrtare, INSTAT-i dhe agjencitë statistikore duhet të udhëhiqen nga parimet e Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane

Kodi i Praktikës i Statistikave Evropiane përcakton standarde për zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave evropiane, për të siguruar statistika cilësore dhe për të arritur besueshmërinë përdoruesve në to. Ai është ndërtuar mbi një përkufizim të

---

<sup>1</sup> <http://ec.europa.eu/eurostat/web/quality/european-statistics-code-of-practice>



përbashkët të cilësisë së Sistemit të Statistikave Evropiane (SSE) dhe shtrihet në të gjitha fushat e rëndësishme të mjedisit institucional, proceset e prodhimit të statistikave deri në publikimin e statistikave zyrtare evropiane. Parimet e statistikave zyrtare që përmban ky kod janë të përafuara edhe në ligjin për statistikën zyrtare përkatësisht në nenet 4 e 5 të tij. Synimi i përafërimit të këtyre standardeve mundëson zbatimin e duhur të PSZ nëpërmjet përmirësimit të proceseve të mbledhjes, përpunimit e publikimit të statistikave zyrtare dhe rritjen e imazhit në publik drejt besueshmërisë në statistikën zyrtare. Parimet e statistikave zyrtare janë si më poshtë:

a) "paanshmëria", që nënkupton mënyrën objektive dhe të pavarur të prodhimit të statistikave, të lira nga çdo presion politik ose i grupeve të tjera të interesuara, veçanërisht lidhur me përzgjedhjen e teknikave, përkufizimeve dhe metodologjisë më të mirë të përshtatshme për të arritur objektivat e vendosur. Ajo nënkupton disponueshmërinë e statistikave me një vonesë sa më të vogël për të gjithë përdoruesit;

b) "besueshmëria", që është karakteristikë e statistikave për të reflektuar sa më mirë që të jetë e mundur realitetin, të cilin ato janë parashikuar të përfaqësojnë. Ajo nënkupton përdorimin e kriterëve shkencore për zgjedhjen e burimeve, metodave dhe procedurave;

c) "pavarësia profesionale", që i referohet personelit të INSTAT-it ose të agjencive statistikore, gjatë zbatimit të programit, nuk i lejohet të kërkojë ose të marrë udhëzime nga Qeveria, autoritetet e tjera shtetërore, partitë politike ose çfarëdo lloj grupi tjetër i interesuar, veçanërisht në përzgjedhjen e burimeve të të dhënave, metodave dhe procedurave statistikore, në përmbajtjen, formën dhe kohën e shpërndarjes, si dhe në zbatimin e konfidencialitetit statistikor;

ç) "përkatësia", që është mbledhja e të dhënave që kufizohet në atë çfarë është e nevojshme për arritjen e rezultatit të kërkuar;

d) "kosto-efektiviteti", që është përdorimi më i mirë i mundshëm i të gjitha burimeve të disponueshme dhe kufizimi i barrës së atyre që përgjigjen. Puna dhe kostoja që kërkon prodhimi i statistikave duhet të jenë në përpjesëtim me rëndësinë e rezultatit të kërkuar;

dh) "konfidencialiteti statistikor", që është mbrojtja e të dhënave që lidhen me njësi statistikore të veçanta, të cilat janë marrë direkt për qëllime statistikore ose indirekt nga burime administrative ose të tjera kundër çdo shkeljeje të së drejtës së konfidencialitetit. Ajo nënkupton parandalimin e përdorimit jostatistikor të të dhënave të marra dhe zbulimin e paligjshëm;

e) "transparenca", që është e drejta e atyre që përgjigjen të kenë informacion mbi bazën ligjore, qëllimin për të cilin janë kërkuar të dhënat dhe masat mbrojtëse të marra.

Një standard i vecantë që vendos Rregullorja (KE) 223/2009 është edhe detyrimi i qeverive të vendeve anëtare për të deklaruar angazhimin e tyre në garantimin e pavarësisë së statistikave zyrtare dhe mbështetjen e institucioneve me burimet e nevojshme për arritjen e kërkesave të përdoruesve. Një vullnet të tillë e ka shprehur edhe qeveria shqiptare nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 650, datë 10.11.2017 “Për angazhimin e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për ruajtjen e besimit në statistika”. Nëpërmjet këtij vendimi, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë rikonfirmon angazhimin e tij të plotë, për të respektuar plotësisht, standardet ndërkombëtare dhe evropiane për cilësinë e statistikave zyrtare, për të garantuar dhe mbrojtur pavarësinë profesionale të Institutit të Statistikave (INSTAT), dhe për ta promovuar atë duke e mbështetur në ruajtjen e besimit të publikut në statistikat zyrtare që prodhohen në Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu, Këshilli i Ministrave ka deklaruar se do të sigurojë burimet e përshtatshme dhe të qëndrueshme, të nevojshme për të kryer aktivitetet statistikore.

#### **Ndryshimet që i janë bërë kuadrit rregullator për vitin 2018**

Në zbatim të rekomandimeve të BE-së për Shqipërinë në lidhje me forcimin e Sistemit Kombëtar Statistikor dhe rritjen e pavarësisë profesionale të prodhuesve të statistikave zyrtare, kuadri i cili rregullon mënyrën e funksionimit të Sistemit Kombëtar Statistikor dhe Institutit të Statistikave në veçanti ka pësuar ndryshime domethënëse. Në Prill të vitit 2018, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin e ri për statistikat zyrtare. Përparësitë që solli ligji ishin forcimi i pavarësisë profesionale të INSTAT, forcimi i rolit udhëheqës të INSTAT në prodhimin e statistikave zyrtare, forcimi i mandatit të prodhuesve statistikorë për të drejtën e hyrjes në të dhënat administrative, si dhe zgjerimi i autonomisë së INSTAT për administrimin dhe përdorimin e burimeve të veta.

Ligji nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare” e pozicionon INSTAT si institucion publik të pavarur, i cili i raporton drejtpërdrejt Kuvendit. Gjithashtu, ai riformaton Këshillin e Statistikave me anëtarë përfaqësues të përdoruesve të statistikave zyrtare, si aktorët e drejtpërdrejtë të interesuar për produktet e SKS. Roli i Këshillit të Statistikave është kthyer nga vendimmarrës në këshillimor.

Në zbatim të ligjit të ri për statistikat zyrtare, Këshilli i Ministrave miratoi:

- Vendimin Nr. 669, datë 7.11.2018 “Për miratimin e procedurave, të kritereve të vlerësimit dhe afateve të njoftimit për përzgjedhjen e kandidatave për t’u emëruar në pozicionin “Drejtor i Përgjithshëm i Institutit të Statistikave”

Ky projektakt është nxjerrë në vijim të frymës së ligjit për të forcuar pavarësinë profesionale të organit drejtues të INSTAT. Ai përcakton në mënyrë të detajuar

procedurat që duhen ndjekur për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT, duke ndjekur procedurën transparente dhe publike të përzgjedhjes së tij.

- Vendimin nr. 670, datë 7.11.2018 “Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes, të përfaqësimit, emërimit e shkarkimit, rregullat e funksionimit dhe masën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit të Statistikave”

Vendimi i miratuar është nxjerrë si pasojë e ndryshimit të natyrës së përfaqësimit të anëtarëve të Këshillit të Statistikave. Sipas kërkesave të ligjit, Këshilli i Statistikave duhet të përbëhet nga përfaqësues të përdoruesve të statistikave zyrtare, si grupi i drejtpërdrejtë i interesuar për produktin statistikor. Në përbërje të tij janë përfshirë anëtarë përfaqësues të përdoruesve kryesorë të statistikave zyrtare, organet e vetëqeverisjes vendore, medias, botës akademike, shoqërisë civile.

Për shkak të ligjit të ri për statistikat zyrtare, INSTAT ka ndryshuar statusin nga institucion qendror në varësi të ekzekutivit, në institucion publik të pavarur, i cili i raporton drejtpërdrejtë Kuvendit të Shqipërisë. Për rrjedhojë, në lidhje me organizimin dhe funksionimin e INSTAT-it, me Vendimin e tij nr. 127/2018 datë 29.12.2018, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar strukturën dhe organikën e INSTAT.

Në funksion të plotësimit të kuadrit rregullator, në lidhje me zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare, ligji për statistikat zyrtare detyron INSTAT të hartojë Planin Vjetor për zbatimin e tij. Gjatë tremujorit të fundit të vitit 2018, INSTAT ka përgatitur projekt-Planin Vjetor 2019 për zbatimin e PSZ, i cili i është përcjellë Këshillit të Ministrave për propozim në Kuvendin e Shqipërisë.

Kuadri rregullator do të përmirësohet më tej gjatë vitit 2019. Vitin e ardhshëm INSTAT ka planifikuar të përgatisë projektaktet:

- Projektligji “Për censin e popullsisë dhe banesave”;
- Projektvendimin e Këshillit të Ministrave “Për miratimin e nomenklaturës së klasifikimit ndërkombëtar të sëmundjeve, ICD-10”
- Projektvendimin e Këshillit të Ministrave “Për miratimin e nomenklaturës së klasifikimit të llojeve të ndërtimit (KN)”;
- Projektvendimin e Këshillit të Ministrave “Për miratimin e nomenklaturës së statistikave të transportit, NST-2007”;
- Projektvendimin e Kuvendit të Shqipërisë “Për disa shtesa dhe ndryshime në Programin e e Statistikave Zyrtare 2017-2021”;

- Projektvendimin e Kuvendit të Shqipërisë “Për miratimin e Programit Vjetor 2020 për zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2017-2021”.

### **Bordi Drejtues**

Bordi Drejtues është organ drejtues i INSTAT-it, i cili ka për detyrë të përcaktojë strategjinë e zhvillimit të institucionit dhe të propozojë planet për zbatimin e buxhetit dhe mënyrën e shpërndarjes së të ardhurave të tij. Detyrat specifike të tij përcaktohen në ligjin nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare”.

Bordi Drejtues përbëhet nga të gjithë nëpunësit civilë të INSTAT-it, të cilët janë të paktën të nivelit të mesëm drejtues, duke iu referuar strukturës organizative të miratuar me vendimin e Kuvendit.

Gjatë vitit 2018 janë zhvilluar katër mbledhje. Në mbledhjen e parë, të zhvilluar në datë 03.08.2018, anëtarët zgjodhën me shumicë votash zëvendëskryetarin e Bordit Drejtues, Z. Alban Çela - Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Mjedisit. Mbështetur në pikën 5 të nenit 18 të ligjit për statistikat zyrtare, Bordi miratoi propozimin e drejtorit të Përgjithshëm për delegimin e disa detyrave zëvendëskryetarit të Bordit.

Gjithashtu, në mbledhje u caktua përbërja e sekretariatit dhe njëkohësisht, u ngarkua të hartojë projekt-rregulloren e Bordit Drejtues. Bordi ka caktuar një anëtar të tij të mbikëqyrë veprimtarinë e sekretariatit dhe përgatitjen e dokumentacionit përkatës të mbledhjeve.

Gjatë vitit 2018, Bordi ka miratuar llojet e shërbimeve statistikore me tarifë të paracaktuar, për t’ia propozuar për miratim Këshillit të Ministrave.

Në zbatim të shkronjës a) të nenit 20 të ligjit për statistikat zyrtare, një detyrë e rëndësishme e këtij organi për vitin 2018 ka qenë përgatitja e projekt-Planit Vjetor 2019 për zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare. Në Nëntor të vitit 2018, pas miratimit nga Bordi Drejtues, projekt-dokumenti i është dërguar Këshillit të Ministrave për propozim në Kuvend.

Çështje të tjera të shqyrtuara nga Bordi, të cilat vlen të përmenden në këtë Raport Vjetor, janë edhe ato që kanë të bëjnë me përmirësimin e standardeve për zbatimin e parimeve të statistikave zyrtare dhe rekomandimeve të Eurostat, të reflektuara në Raportin e Vlerësimit “Peer Review” 2018. Kështu, për sigurimin e konfidencialitetit statistikor, mbështetur në shkronjën ç) të nenit 20 të ligjit për statistikat zyrtare, Bordi diskutoi “Rregulloren e Dhomës së Sigurisë”, si edhe përbërjen e Komitetit të Konfidencialitetit, të cilat më pas do të kalojnë për miratim përgjatë vitit 2019. Për

zbatimin e parimeve të kosto-efektivitetit dhe koherencës, janë miratuar indikatorët e performancës së institucionit (PAF indicators), sipas standardit të paracaktuar me ekspertët suedezë, i cili aplikohet nga institucioni kombëtar statistikor i Suedisë.

Lidhur me aktivitetet për vitin 2019, duke synuar arritjen e objektivave strategjike për zhvillimin e Sistemit Kombëtar Statistikor, zbatimin e rekomandimeve të lartpërmendura, detyrat që rrjedhin nga Programi i Statistikave Zyrtare, Bordi Drejtues ka miratuar Planin Operacional 2019 të INSTAT. Plani Operacional përmban tërësinë e aktiviteteve teknike e operative që INSTAT do të ndërmarrë gjatë vitit 2019, si dhe përcakton strukturat përgjegjëse të INSTAT për zbatimin e tyre.

#### **Vendimet e Bordit Drejtues për vitin 2018**

1. Vendimi nr. prot. 1174/2 datë 02.08.2018 “Për caktimin e zëvendëskryetarit të Bordit Drejtues”;
2. Vendimi nr. Prot., 1174/3 datë 03.08.2018 “ Urdhër për ngritjen e Sekretariatit të Bordit Drejtues”;
3. Vendimi nr. Prot., 1174/4 datë 28.08.2018 “ Llojet e Shërbimeve Statistikore me Tarifë të Paracaktuar që i Propozohen Këshillit të Ministrave”;
4. Vendimi nr. prot. 1174/7 datë 26.09.2018 “ Vendim Për Delegim Detyrash”;
5. Vendimi nr. prot., 1174/8 datë 26.09.2018 “Vendim për Miratimin e Pyetësorit të Vetëvlerësimit”;
6. Vendimi nr. prot., 1174/12 datë 29.11.18 “Miratimi i Përmbajtjes së Planit Vjetor të PSZ-së”;
7. Vendimi nr. prot., 1174 /13 datë 29.11.2018 “Miratimi i Rregullores së Bordit Drejtues”;
8. Vendimi nr. prot., 1174/17 datë. 31.12.2018 “Për Caktimin e Anëtarit të Bordit Drejtues Mbikqyrës i Punës së Sekretariatit të Bordit Drejtues”.

#### **Përbërja e Bordit Drejtues 2018**

1. Znj. Delina Ibrahimaj, Kryetare e Bordit Drejtues;
2. Z. Alban Çela, Zëvendëskryetar i Bordit Drejtues;
3. Z. Maldi Dema, Anëtar dhe anëtar mbikqyrës për Sekretariatit;
4. Znj. Elsa Dhuli, Anëtare
5. Znj. Helda Mitre, Anëtare
6. Z. Klajd Shuka, Anëtar
7. Z. Ervin Shameti, Anëtar
8. Z. Etugert Llazi, Anëtar

## 9. Znj. Elona Sevrani, Anëtare

**Këshilli i Statistikave**

Këshilli i Statistikave (KS) është organ i përbërë nga përdorues të statistikave zyrtare dhe njohës të fushës së statistikave. KS mbështet Sistemin Kombëtar Statistikor dhe INSTAT-in në rolin e tij për të siguruar se programi është hartuar në përputhje me parimet themelore të Kombeve të Bashkuara për statistikat zyrtare dhe standardet e tjera ndërkombëtare statistikore.

Mbështetur në pikën 5 të nenit 5/a të Rregullores (KE) 223/2009 parashikohet krijimi i bordit këshillimor në nivel kombëtar, i cili jep mendime mbi programet statistikore si dhe ndikon në sigurimin e pavarësisë profesionale të prodhuesve statistikorë. Për këtë arsye, duke u mbështetur edhe në rekomandimet e Eurostat-it, Ligji i ri për statistikat zyrtare mundësoi krijimin e Këshillit të Statistikave me qasje nga përdoruesit. Në këtë mënyrë, ai ka rol këshillimor për dhënien e inpute-ve të duhura gjatë përgatitjes së programit të statistikave zyrtare, planeve të punës për zbatimin e tij si dhe monitorimin e veprimtarisë së Sistemit Kombëtar Statistikor nëpërmjet raporteve periodike që i paraqiten nga drejtori i Përgjithshëm i INSTAT.

Duke qenë se në përbërje të Këshillit janë përfaqësues nga përdoruesit e statistikave zyrtare, numri i anëtarëve të Këshillit është rritur nga 7 në 11, duke shtuar një përfaqësues nga vetëqeverisja vendore, bota akademike dhe media.

Këshilli i Ministrave, me VKM nr. 670, datë 7.11.2018, përcaktoi në hollësi kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes, të përfaqësimit, emërimit e shkarkimit, rregullat e funksionimit dhe masën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit të Statistikave.

Këshilli i Statistikave performon nëpërmjet komunikimeve me drejtuesit e strukturave që merren me prodhimin e statistikave zyrtare në mënyrë që të sigurohet cilësia e produktit të tyre. Gjithashtu, për të siguruar cilësinë e statistikave, Këshilli mund të kërkojë vlerësime apo kontrole të pavarura nga ekspertë të huaj për një fushë të caktuar të statistikave zyrtare. Te shtohet dicka per paraqitjen e raporteve.

Përveç veprimtarive të tjera të përcaktuara në ligjin e statistikave zyrtare, ai kryen detyrat e mëposhtme: a) jep mendim për projektprogramin, ndryshimet e tij, duke garantuar që programi të pasqyrojë nevojat parësore të përdoruesve për informacion statistikor dhe, nëpërmjet Drejtorit të Përgjithshëm, i njoftohet Këshillit të Ministrave për dërgimin e tij për miratim Kuvendit; b) jep mendim për planin vjetor të INSTAT-it për zbatimin e programit; c) vlerëson raportin vjetor të Drejtorit të Përgjithshëm për zbatimin

e programit dhe ecurinë e Sistemit Kombëtar Statistikor; ç) shqyrton raportet e shkurtra katërmujore të ecurisë në zbatimin e programit, të paraqitura nga Drejtori i Përgjithshëm; d) vlerëson zbatimin e parimeve statistikore nga institucionet prodhuese të statistikave zyrtare.

Gjatë vitit 2018 janë zhvilluar 2 mbledhje të KS, përkatësisht të datave 19.04.2018 dhe 03.05.2018. Në mbledhjen e parë janë përfshirë tema të rëndësishme diskutimi, si:

- Raporti 4 mujor i PSZ-së Shtator – Dhjetor 2017
- Raporti Vjetor 2017 i INSTAT
- Ligji i ri për Statistikat Zyrtare
- Çështje në kuadrin e integritimit Evropian dhe rolin e INSTAT në punët përgatitore për Çeljen e Negociatave
- Rekomandimet e Komisionit Evropian-progres raporti 2018 për Kapitullin 18 “Statistikat”
- Procesi i vlerësimit të SKS nga Eurostat nëpërmjet Peer Review (Mision vlerësimi)
- Projekti SALSTAT
- Përgatitjet për Censusin e Popullsisë dhe Banesave
- Roli i Qendrës së Trajnimit

Në lidhje me temat e lartpërmendura, KS ka lënë disa rekomandime, ku më të rëndësishmet janë ato mbi procesin e celjes së negociatave. Për këtë, KS ka rekomanduar përgatitjen e një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të BE-së dhe Eurostat. Në lidhje me këtë rekomandim, institucioni ka marrë parasysh përfshirjen e aktiviteteve zbatuese në Planin Operacional vjetor të tij.

Gjithashtu, KS ka rekomanduar qartësimin e definicioneve të të dhënave sipas nomenklaturave dhe regjistrave statistikore. Në këtë aspekt, INSTAT ka bashkëpunuar me Komisionin e Nomenklaturave për miratimin e nomenklaturave të reja statistikore, të përafuara me klasifikimet ndërkombëtare, siç është klasifikimi statistikor i ndërmarrjeve NACE Rev.2.

Tema kryesore e shqyrtuar nga Këshilli i Statistikave në mbledhjen e dytë (të datës 03.05.2018) është ajo e Raportit vjetor të INSTAT për vitin 2017. Raporti 2017 është i aksesueshëm në faqen zyrtare elektronike të INSTAT.

Rekomandime të tjera të këshillit, të dhëna gjatë mbledhjeve të lartpërmendura kanë qenë edhe ato në lidhje me zgjerimin e numrit të statistikave të inovacionit, të dhënat në raport me tregun digjital, statistikat e transportit rrugor etj. Në lidhje me këto rekomandime, INSTAT ka filluar punën për tu dakortësuar me AKSHI'n për modernizimin

e transmetimit të të dhënave administrative, si institucioni përgjegjës për administrimin e bazave të të dhënave shtetërore.

Ndryshimet e reja ligjore në lidhje me përbërjen dhe funksionimin e Këshillit të Statistikave e bënë të pamundur zhvillimin e mbledhjeve të tjera gjatë vitit 2018 për shkak të mungesës së kuorumit të nevojshëm.

Së fundmi, në zbatim të VKM nr. 670, datë 7.11.2018 "Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes, të përfaqësimit, emërimit e shkarkimit, rregullat e funksionimit dhe masën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit të Statistikave", kanë filluar procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve për anëtarët e rinj të Këshillit të Statistikave dhe brenda tremujorit të dytë të vitit 2019 pritet emërimi nga Kuvendi i Shqipërisë i kandidatëve të propozuar.

#### **Etika e institucionit dhe e titullarit të institucionit**

Në kryerjen e funksioneve të tij publike titullari, por dhe çdo punonjës i institucionit e bazon aktivitetin në përputhje me parimet e etikës së shëndoshë të diktuar nga ligji nr. 9131, datë 8.9.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike". Për zbatimin e standardeve të etikës institucionale, INSTAT ka miratuar Kodin e Etikës, me Vendimin nr. 390 prot., datë 13.03.2017. Rregullorja e Brendshme e INSTAT përmban gjithashtu kapitull të veçantë për normat e etikës në institucion dhe mënyrat e trajtimit të rasteve të shkeljes së saj.

Vitin e kaluar është evidentuar vetëm një rast për shkeljen e etikës profesionale, e cila bie në kundërshtim me normat e Kodit të Etikës së institucionit dhe Rregullores së Brendshme të tij. Bazuar në këto akte, si dhe legjislacionin në fuqi, INSTAT ka marrë masat e duhura për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës. Nuk është paraqitur ankesë ndaj vendimmarrjes.

#### **Struktura Mbikqyrëse e Etikës**

Struktura Mbikqyrëse e Etikës përcaktohet me autorizim të Drejtorit të Përgjithshëm. Në përbërje të saj, dhe sipas hierarkisë, është Përgjegjësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore dhe Drejtori i Financës dhe Projekteve. Kjo strukturë i raporton Drejtorit të Përgjithshëm rast pas rasti, por dhe në mënyrë periodike, rastet e konstatuara në shkelje të Kodit të Etikës. Në bazë të raportimeve, ajo fillon procedurën disiplinore në përputhje me legjislacionin dhe aktet nënligjore në fuqi. Procedura mund të fillojë edhe kryesisht.

Çdo punonjës i institucionit është i detyruar të bashkëpunojë dhe të raportojë pranë kësaj Strukturës Mbikqyrëse të Etikës. Për çdo rast të raportuar, apo të filluar kryesisht,



Struktura Mbikqyrëse e Etikës duhet të përpilojë një raport të posaçëm, të cilin ia paraqet Drejtorit të Përgjithshëm në formën e njoffimit apo të propozimit për marrje masë disiplinore.

## Strategjia e zhvillimit të INSTAT

---

Strategjia e zhvillimit të INSTAT 2017-2030, është hartuar duke marrë në konsideratë objektivat strategjike kombëtare dhe sektoriale zhvillimore për periudhën afat-mesme dhe afatgjatë, për të përmbushur kërkesat gjithnjë e në rritje të përdoruesve për statistika cilësore. Strategjia përmban 4 objektiva kryesorë të cilët kanë të bëjnë me zhvillimin e cilësisë statistikore, përdorimin e burimeve të informacionit, përmirësimin e infrastrukturës dhe kapaciteteve profesionale të SKS si dhe zhvillimin e infrastrukturës së prodhimit statistikor. Objektivat strategjike afatgjatë të institucionit janë hartuar gjithashtu edhe në përputhje me ato të parashikuara në PSZ 2017-2021, për zhvillimin e Sistemit Kombëtar Statistikor. Me qëllim arritjen e këtyre objektivave, INSTAT ka hartuar gjithashtu edhe një plan veprimi afatmesëm (2017-2020), i cili përmban një sërë nënobjektivash dhe aktiviteteve konkrete, si dhe përcakton përgjegjësitë e njëjësive strukturore të institucionit për përmbushjen e tyre. Aktivitetet në frekuencë vjetore përfshihen në Planin Operacional të INSTAT-it.

Në vijim paraqitet informacioni mbi veprimtarinë e INSTAT, gjatë vitit 2018 në interes të përmbushjes së 4 objektivave strategjike madhorë përkatësisht:

### **Objekti 1: Prodhimi dhe shpërndarja në kohë e me cilësi e të dhënave statistikore në fushat ekonomike, sociale, të zhvillimit demografik dhe mjedisor në nivel qendror dhe lokal.**

Objekti ndikon drejtpërdrejtë në plotësimin e pritshmërive të përdoruesve për statistika zyrtare për qëllime vendimmarrje, politikëbërje, kërkimore-shkencore apo orientuese, si dhe në besueshmërinë e publikut në cilësinë e statistikave të prodhuara.

Gjatë vitit 2018 INSTAT, në përmbushje të këtij objekti ka realizuar një sërë aktiviteteve. Numri i publikimeve të INSTAT shkoi në 159, nga 137 që ishin në vitin 2017, duke u rritur kështu me 22 publikime, nga të cilat 12 të reja.

INSTAT, disponon një publikim të dedikuar për të dhënat, e ndara sipas rajoneve statistikore, i cili quhet "Vjetari Statistikore Rajonal". Në këtë vjetar përshkruhen dhe publikohen të gjithë indikatorët statistikorë në nivelet Rajonale (NUTS I, NUTS II dhe NUTS III). Në vitin 2018, në këtë vjetar është shtuar një kapitull i ri me indikatorë për Bashkitë, i cili do të përditësohet çdo vit me indikatorë të rinj.

Gjithashtu përgjatë vitit 2018, INSTAT ka shpërndarë te përdoruesit, 159 produkte statistikore dhe numri i botimeve të publikuara në kohë – online ka qënë 82.10%. Në vitin 2018, INSTAT hartoi edhe strategjinë e shpërndarjes së produkteve statistikore, e cila do të ndikojë në cilësinë e shpërndarjes së Statistikave dhe rritjen e imazhit të INSTAT.

Në kuadër të monitorimit dhe përmirësimit të cilësisë statistikore INSTAT, në vitin 2018, zbatoi modelin e përgjithshëm të menaxhimit të proceseve statistikore, sipas rekomandimeve të Eurostat dhe Komisionit Europian të Kombeve të Bashkuara për Ekonominë. Në vetvete ky model përshkruan dhe përcakton të gjithë bashkësinë e proceseve të nevojshme për t'u ndjekur në prodhimin e statistikave zyrtare, duke siguruar harmonizimin e terminologjisë dhe përcaktimin e një kornize standarde për planifikim dhe monitorim. Në kuadër të monitorimit të cilësisë statistikore u përgatit procesi i auditimit statistikor dhe vetëvlerësimit si edhe u dokumentuan 48 aktivitete statistikore. Puna e kryer gjatë këtij viti do të shërbejë si themel për përmirësimin e cilësisë dhe proceseve të prodhimit statistikor. INSTAT në rolin e koordinatorin të SKS, përdor auditin statistikor si mekanizëm i mbështetur në Ligjin Për Statistikat Zyrtare, për sigurimin e cilësisë së tyre.

Përgjatë vitit 2018, është ndërtuar edhe moduli i trajnimit për cilësinë statistikore dhe në bashkëpunim me Shkollën e Administratës Publike, janë kryer trajnime me stafin e institucioneve përkatëse të cilat dërgojnë të dhëna pranë INSTAT.

Vlen për tu përmendur se Strategjia për zhvillimin e Sitemit Kombëtar Statistikor, e cila do të përgatitet brenda gjashtëmuorit të parë të vitit 2019, do të jetë instrument i rëndësishëm në funksion të zgjerimit të gamës së statistikave zyrtare dhe përfshirjen e prodhuesve të tjerë statistikorë si pjesë e sistemit.

**Objekti 2: Përdorimi i burimeve të të dhënave dhe instrumenteve të duhura, për të përmirësuar prodhimin dhe cilësinë e treguesve dhe shërbimeve statistikore.**

Rritja e burimeve të të dhënave administrative ndikon drejtpërdrejtë jo vetëm në koherencën dhe cilësinë e produktit statistikor, por edhe në reduktimin e kostove për sigurimin e këtyre të dhënave. Agjencitë statistikore dhe institucionet e tjera publike, për ushtrimin e kompetencave dhe përmbushjen e natyrës së punës që kanë, mbledhin të dhëna të cilat mund të përdoren për qëllime statistikore.

INSTAT i ka dhënë rëndësi të veçantë testimit të mënyrave të reja të mbledhjes së të dhënave dhe përdorimit gjithmonë e më shumë të të dhënave administrative. Përgjatë vitit është diskutuar dhe vendosur edhe për sigurimin e të dhënave administrative mikro nëpërmjet një pike hyrëse të vetme në INSTAT, duke ndikuar në përdorimin dhe përpunimin më eficient të të dhënave administrative të marra.

Është punuar gjithashtu për përmirësimin e teknikave të grumbullimit të informacionit statistikor duke përdorur metoda moderne si CAPI (mbledhja e të dhënave me tablet/laptop) të cilat përmirësojnë cilësinë, kohën e kapjes dhe përpunimit të të dhënave, dhe reduktojnë afatin e publikimit të tyre. Përmirësimi i treguesve ekzistues

dhe respektimi i afateve kohore, do të jenë disa prej orientimeve kryesore për vitin në vazhdim. Metoda CAPI është përdorur në pesë vrojtime të realizuara nga INSTAT.

Në fund të vitit 2018, bazuar në planin opercional të punës, INSTAT zhvilloi edhe një testim pilot për këqyrjen e mundësisë së aplikimit të metodës CATI (Intervistimi nëpërmjet sistemit telefonik) tek vrojtimi mujor “Besimi i Biznesit”. Vrojtim i cili deri më tani realizohej duke përdorur metodën e intervistimit të drejtpërdrejtë me pyetësorë letër nga anketuesi. Testimi u realizua mbi një pjesë të kampionit rreth 10% të njësisë statistikore, të shpërndara në 100 ndërmarrje në Bashkinë Tiranë dhe 20 ndërmarrje në bashki të tjera.

Vlen për tu përmendur se INSTAT prej vitesh tashmë kryen rregullisht publikim të të dhënave statistikore, të shpërndara gjeografikisht. Mjeti kryesor i përdorur për këtë qëllim është portali WebGIS, i quajtur “Atlasi Statistikor i Shqipërisë” ku rregullisht publikohen të dhëna të reja dhe përditësohen treguesit aktualë në tre nivele të informacionit (Qark, Njësi vendore dhe sistem GIRD 1 km<sup>2</sup>). Të dhënat gjithashtu, paraqiten edhe nëpërmjet hartave tematike në faqen Web të INSTAT (publikime, botime dhe analiza të thelluara).

Përmirësimi i treguesve ekzistues dhe respektimi i afateve kohore, do të jenë disa prej orientimeve kryesore për vitin në vazhdim.

### **Objekti 3: Përmirësimi profesional dhe organizativ i Sistemit Kombëtar Statistikor.**

Forcimi i Sistemit Kombëtar Statistikor është një ndër rekomandimet kryesore të Eurostat për Shqipërinë. Fillimisht INSTAT synoi të përgatisë kuadrin e plotë ligjor për funksionimin e këtij sistemi dhe më tej, përdorimin e instrumenteve formale për rritjen e bashkëpunimit ndërmjet prodhuesve të statistikave zyrtare. Në muajin Maj 2018, hyri në fuqi ligji i ri për statistikave zyrtare, i cili përcakton qartë institucionet përbërëse të SKS, detyrat dhe përgjegjësitë e INSTAT si koordinator dhe përfaqësues i tij, si dhe aktivitetet koordinuese për performimin e duhur të sistemit.

Më tej, është punuar për forcimin e bashkëpunimit me institucionet e tjera që ndikojnë drejtpërdrejtë ose në mënyrë të tërthortë në aktivitetet statistikore, siç janë institucionet që furnizojnë prodhuesit me të dhëna administrative. Në vitin 2018, INSTAT ka nënshkruar 5 Memorandume të reja Mirëkuptimi ndërmjet me ministrinë e linjës apo institucione të tjera publike.

Bashkëpunimi me botën akademike është cilësuar gjithashtu si element prioritar për arsye se ky grup interesi ndihmon në përmirësimin e standardeve të prodhimit e përdorimit të statistikave zyrtare në fushën kërkimore-shkencore. Në vitin 2018, INSTAT publikoi për herë të parë revistën e tij shkencore “Kërkimi”, si edhe organizoi një sërë

tryezash të rrumbullakëta me përfaqësues të botës akademike, për t'iu afruar më tepër kërkesave të grupeve të interesuara.

Ngritja e Qendrës së Trajnimit Statistikor, falë kontributit dhe mbështetjes së qeverisë Suedeze, është një instrument tjetër i vlefshëm për të rritur kapacitetet profesionale të statisticienëve dhe për t'iu ofruar përdoruesve, studentëve, medias e kërkuesve shkencorë infrastrukturën e duhur për aksesimin e të dhënave të disponueshme, duke siguruar njëkohësisht mbrojtjen e konfidencialitetit statistikor. Duke bashkëpunuar ngushtësisht me Shkollën e Administratës Publike (ASPA), gjatë tremujorit të fundit të vitit 2018 në këtë qendër u organizuan disa trajnime me përfaqësues nga grupet e lartpërmendura të interesit.

Në tetor të vitit 2018, duke synuar rritjen e kapaciteteve profesionale të statisticienëve, me kërkesën e INSTAT dhe në bashkëpunim me Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës, Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë pranoi hapjen e programit të ciklit të dytë të studimit “Master i Shkencave” në statistikat zyrtare”. Ndërkohë, INSTAT dhe Fakulteti i Ekonomisë kanë aplikuar për përfitimin e çertifikimit nga EMOS “Masteri Evropian në Statistika Zyrtare”, i cili është është një projekt i përbashkët i universiteteve dhe prodhuesve të të dhënave në Evropë. Pas marrjes së çertifikimit të programit të masterit, me logon e EMOS, do të bëhet e mundur për herë të parë, çelja e masterit shkencorë dedikuar statistikave zyrtare sipas standardeve evropiane, mbështetur tek përvojat më të mira të disa universiteteve të huaja të cilat ofrojnë programe të ngjashme studimi.

Në aspektin e menaxhimit të burimeve njerëzore, INSTAT zhvilloi për të dytin vit radhazi anketën e Vrojtimit të Kënaqësisë së Stafit të INSTAT. Bazuar në gjetjet dhe rezultatet e vrojtimit të vitit 2017, për vitin 2018 u hartua një plan për përmirësimin e kënaqësisë së stafit. Ndërkohë, rezultatet e vrojtimit të vitit 2018 janë përfshirë në aktivitetet zbatuese për vitin 2019.

Në planin e zhvillimit të infrastrukturës së prodhimit statistikor, para së gjithash në vitin 2019, falë një mbështetje të Bankës Botërore, INSTAT do të ndërtojë një strategji zhvillimi për të gjithë sistemin kombëtar statistikor. Strategjia do të ndihmojë zbatimin e rekomandimit të Eurostat për zgjerimin e gamës së treguesve zyrtarë statistikorë që prodhon sistemi, shtesën e numrit të institucioneve prodhuese si agjenci statistikore si dhe modernizimin e mënyrave të mbledhjes, përpunimit e publikimit të të dhënave zyrtare. Strategjia e zhvillimit të sistemit kombëtar statistikor do të shoqërohet me një plan konkret veprimi, i cili do të parashikojë aktorët përgjegjës për zbatimin e saj dhe afatet për përmbushjen e aktiviteteve.

**Objektivi 4: Zhvillimi i sistemeve inovative ITC për përpunimin statistikor, shkëmbimin e të dhënave dhe komunikimin.**

Me qëllim përmbushjen e këtij objekti, INSTAT është angazhuar në lidhje me modernizimin e teknologjive për mbledhjen e të dhënave dhe proceseve prodhuese të statistikave.

Rritja e kërkesës për të dhëna statistikore kërkon një përmirësim të vazhdueshëm të sistemeve të Teknologjisë së Informacionit.

Për të mbështetur dhe monitoruar modernizimin e proceseve prodhuese, INSTAT kryen një sërë procesesh vlerësimi të hardware dhe software në dispozicion të prodhimit statistikor për automatizimin dhe standardizimin e procesve të punës. Në përputhje me Kodin e Praktikës, prioriteti i lartë është dhënë edhe sigurisë së Informacionit. Punë përgatitore është kryer për zhvillimin e web-serviceve (metodë transmetimi të sigurt të të dhënave administrative) për të ulur ngarkesën e të intervistuarve, rritur cilësinë statistikore dhe përmirësuar metodat e shpërndarjes dhe komunikimit.

Gjatë vitit 2018 është miratuar Strategjia e Teknologjisë së Informacionit si edhe plani për zbatimin e saj me qëllim udhëheqjen e maturuar të TI, qeverisjen dhe ofrimin e shërbimeve të TI.

Gjithashtu u ndërtua, sistemi i integruar i teknologjisë së informacionit (Data warehouse statistikor), i cili do të shërbejë si një sistem qëndror për menaxhimin e të dhënave dhe metadata-ve statistikore.

**Sfidat për 2019**

Për arritjen e objektivave strategjike dhe zbatimin me sukses të aktiviteteve statistikore në tërësi sfidat kryesore për vitin 2019 parashikohet të jenë:

**1. Kultura e ndryshimit dhe e zhvillimit:** INSTAT do të përdorë instrumente komunikimi dhe motivimi tek punonjësit në mënyrë që të rritet ndërgjegjja për zhvillim dhe inovacion, e cila synon të arrihet nëpërmjet angazhimit të INSTAT me artikuj shkencorë cilësorë në revistën Shkencore Kërkimi, si edhe rritjen e edukimit statistikor nëpërmjet hartimit të një strategjie të drejtuar të gjithë grupeve të përdoruesve.

**2. Politika dhe strategji efikase:** INSTAT do të ndërtojë standarde duke aplikuar rregullore, udhëzime, manuale dhe stimuj të tjerë formalë që të drejtojnë institucionin drejt arritjes së objektivave strategjike, e cila synon të arrihet nëpërmjet zbatimit të rregulloreve, udhëzimeve dhe manualeve të BE-së.

**3. Niveli organizativ e institucional:** INSTAT do të punojë për ndërtimin e sistemeve menaxheriale adekuate, ndërveprimin vertikal dhe horizontal ndërmjet sektorëve për arritjen e qëllimeve afat-shkurtra, afatmesme dhe afat-gjata duke përdorur në mënyrën më të mundshme burimet që disponon institucioni, nëpërmjet prodhimit dhe monitorimit të indikatorëve që shërbejnë për matjen e Performancës së Indikatorëve PAF.

**4. Komunikimi me përdoruesit:** Përdoruesit e statistikave zyrtare janë klientela e produkteve të siguruar nga INSTAT. Institucioni do të punojë për t'iu përafuar gjithnjë e më tepër pritshmërive dhe kënaqësisë së përdoruesve të statistikave zyrtare, duke respektuar në mënyrë rigorozë parimet statistikore dhe standardet ndërkombëtare, e cila synon të arrihet nëpërmjet rritjes së edukimit statistikor, duke hartuar një strategji drejtuar të gjithë grupeve të përdoruesve. Gjatë vitit 2018, INSTAT, ka miratuar strategjinë e Edukimit Statistikor, e cila do të fillojë implementimin e saj në vitin 2019.

#### **Indikatorët e performancës**

Një nga objektivat e INSTAT është ndërtimi i kornizës për vlerësimin e performancës institucionale, e cila ka për qëllim të kontribuojë në rritjen e njohurive dhe mirëkuptimin e rrugëve me anë të të cilave INSTAT punon në plotësimin e kërkesave si agjenci statistikore në menaxhim, kontroll dhe ndjekje.

INSTAT ka ndërtuar kornizën për vlerësimin e performancës institucionale, e cila ka për qëllim të kontribuojë në rritjen e njohurive dhe mirëkuptimin e rrugëve me anë të të cilave INSTAT punon në plotësimin e kërkesave si agjenci statistikore në menaxhim, kontroll dhe ndjekje.

Indikatorët e identifikuar për matjen e performancës së institucionit lidhen me aspektet kryesore strategjike dhe menaxheriale të tij, përfshirë edhe standartizimin e proceseve statistikore të cilat rrisin cilësinë e produktit statistikor. Gjithashtu, janë përfshirë indikatorë të cilët lidhen me publikimin e produkteve statistikore për të qenë pranë përdoruesit në një kohë sa më të shpejtë, për të plotësuar nevojat e tij me informacion cilësor, të përditësuar dhe të ri statistikorë si dhe për të qenë të krahasueshëm me vendet e tjera në rajon dhe Evropë.

Tabela emëposhtme paraqet indikatorët që do të përdoren për të matur performancën e institucionit në aspektin menaxherial dhe prodhues në harkun e në viti kalendarik.

Tabela 1: Indikatorët e performancës për vitin 2018 dhe niveli i arritjes

<b>Numri i aktiviteteve të dokumentuara në GSBPM</b>		<b>85.7%</b>
Numri i publikimeve të reja		4.3%
Numri i publikimeve në kohë - online		82.10%
Numri i aktiviteteve që kanë përmirësim afati të aktiviteteve tradicionale sipas kërkesave të Eurostat		27
Data points në Eurostat data base për Shqipërinë		56%
Numri i vizitave në web site		10%
Numri i raporteve të cilësisë		30%
Niveli i përgjithshëm i kënaqësisë së përdoruesve		15,8 pikë përqindje
<b>Numri i vrojtimit pranë familjeve dhe NjEF e intervistuar</b>		10 vrojtimit dhe 59.702 NjEF
Numri i vrojtimit pranë ndërmarrjeve dhe Ndermarrjet e intervistuar		16 vrojtimit dhe 21.752 Ndërmarrje
<b>Kohëzgjatja e intervistës për anketat pranë familje mesatarisht</b>		40.47 minuta
<b>Kohëzgjatja e intervistës për anketat pranë ndërmarrjeve është mesatarisht</b>		37.87 minuta
<b>Numri i aktiviteteve të dokumentuara në GSBPM</b>		48 aktivitete të dokumentuara nga synimi 56 aktivitete
<b>Numri i aktiviteteve që kanë përmirësim afati të aktiviteteve tradicionale sipas kërkesave të Eurostat</b>		27



## **Sistemi Kombëtar Statistikor dhe Zbatimi i PSZ**

Sistemi Kombëtar Statistikor (SKS) është tërësia e institucioneve dhe organizatave që ushtrojnë aktivitet brenda Republikës së Shqipërisë, të cilat mbledhin, përpunojnë dhe publikojnë statistika zyrtare sipas PSZ. SKS e ushtron veprimtarinë e tij në mbështetje të Ligjit nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare”, dhe veçanërisht neneve 11, 12 dhe 13 të tij. Sipas pikës 1 të nenit 12, INSTAT është përgjegjës për koordinimin e funksionimin e këtij sistemi, duke u fokusuar kryesisht në rritjen e bashkëpunimit ndërmjet agjencive statistikore, planifikimin e programeve zhvillimore dhe monitorimin e ecurisë së tyre, përmirësimin e uniformitetit të metodologjive, mbështetjen teknologjike, zbatimin e parimeve statistikore etj.

Aktualisht, duke iu referuar listës së prodhuesve të statistikave zyrtare sipas PSZ 2017-2021, Sistemi Statistikor përbëhet nga INSTAT, Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

### **Kuadri rregullator për funksionimin e SKS**

Në Shkurt të vitit 2017, Kuvendi i Shqipërisë miratoi Programin pesëvjeçar, nëpërmjet Vendimit nr. 10, datë 09.02.2017 “Për miratimin e Programit të Statistikave Zyrtare për periudhën 2017-2021”. Programi është dokumenti kryesor mbi të cilën bazohen veprimtaritë e institucioneve prodhuese të statistikave zyrtare gjatë pesë viteve të ardhshme. Ai përcakton institucionet prodhuese të statistikave, njësitë që detyrohen të ofrojnë të dhënat administrative etj, metodologjinë e prodhimit dhe frekuencën e publikimit të tyre.

Miratimi në Prill të vitit 2018 i ligjit të ri për statistikat zyrtare, ishte një hap i rëndësishëm drejt përafrimit me standardet europiane. Përparësitë që solli ligji ishin forcimi i pavarësisë profesionale të INSTAT, forcimi i rolit udhëheqës të INSTAT në prodhimin e statistikave zyrtare, forcimi i mandatit të prodhuesve statistikorë për të drejtën e hyrjes në të dhënat administrative, si dhe zgjerimi i autonomisë së INSTAT për administrimin dhe përdorimin e burimeve të veta. Ligji nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare” e pozicionon INSTAT si institucion publik të pavarur, i cili i raporton drejtpërdrejt Kuvendit. Gjithashtu, ai riformaton Këshillin e Statistikave me anëtarë përfaqësues të përdoruesve të statistikave zyrtare, si aktorët e drejtpërdrejtë të interesuar për produktet e SKS. Roli i Këshillit të Statistikave është kthyer nga vendimmarrës në këshillimor.

Pas hyrjes në fuqi të ligjit për statistikat zyrtare, Këshilli i Ministrave miratoi akte të tjera nënligjore për të rregulluar proceset e emërimit të Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT apo anëtarëve të Këshillit të Statistikave.

**Memorandume mirëkuptimi**

Për të rritur bashkëpunimin ndërinstytucional në interes të përmirësimit të statistikave zyrtare, besueshmërisë së publikut në to dhe për t'iu përshtatur standardeve të reja të përcaktuara nga ligji për statistikën zyrtare, gjatë vitit 2018 INSTAT ka nënshkruar dhe përditësuar disa marrëveshje mirëkuptimi me institucione të tjera të cilët mbajnë të dhëna administrative, si dhe aktorë të tjerë nga bota akademike, etj. Nëpërmjet marrëveshjeve, palët janë dakordësuar për shkëmbimin e të dhënave që disponojnë, duke respektuar parimet e konfidencialitetit statistikor dhe kuadrin ligjor mbi të cilat e ushtrojnë veprimtarinë institucionet përkatëse. Gjithashtu, nëpërmjet marrëveshjeve, palët kanë shprehur vullnetin për të zhvilluar aktivitete e projekte të përbashkëta për rritjen e kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimeve, përfshirjes së stafit në proceset e mbledhjes, përpunimit dhe prodhimit statistikor, etj. Për të siguruar zbatimin e duhur të marrëveshjeve, palët janë dakordësuar për ngritjen e grupeve të përbashkëta të punës, të cilët jo vetëm do të kujdesen për zbatimin e saj, por edhe për të propozuar ide apo veprime të tjera në interes të përmirësimit të cilësisë statistikore. Lista e memorandumeve të bashkëpunimit të nënshkruara ndërmjet INSTAT dhe institucioneve të tjera është si vijon:

**Tabela 3: Memorandume Mirëkuptimi**

Nr.	Memorandume Mirëkuptimi	Data e nënshkrimit
Prodhues të statistikave zyrtare		
1	Banka e Shqipërisë	12.05.2008
2	Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë	03.10.2016
Ofrues të të dhënave administrative / Përdorues		
3	Ministria e Punëve të Brendshme	11.11.2010
4	Ministria e Mbrojtjes	13.06.2017
5	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	31.03.2016
6	Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	20.01.2017
7	Ministria e Kulturës	11.03.2015
8	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	02.06.2017
9	Shërbimi Kombëtar i Punësit	08.07.2014
10	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	11.03.2015
11	Qendra Kombëtare e Bisesit	08.05.2017
12	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	11.04.2017
13	Instituti i Sigurimeve Shoqërore	11.04.2017
14	Shërbimi Social Shtetëror	06.06.2017
15	Drejtoria e Policisë së Shtetit	05.09.2017
16	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor	27.09.2017
17	Agjencia e Zhvillimit të Territorit	13.10.2017
18	Agjencia Kombëtare Elektronike dhe Postare	14.12.2017
19	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor	12.01.2018
20	Financial Supervisory Authority	29.12.2017
21	Autoriteti Mbikqyrës Financiar	22.11.2017
22	Agjencia e Zhvillimit Rural dhe Bujqësor	16.09.2016
23	Instituti i Shëndetit Publik	26.04.2018
24	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore	09.02.2018
Bota akademike / përdorues të tjerë		
25	Universiteti Luarasi	14.07.2016
26	Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë	14.04.2016
27	Universiteti i Tiranës – Fakulteti i Ekonomisë	02.05.2017
28	Universiteti Bujqësor i Tiranës	25.05.2017
29	Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë e Tiranës	20.03.2018
30	Kolegji Harvard	03.02.2018

Bazuar në aktivitetet e Planit Operacional synohet që, për vitin 2019, të nënshkruhen marrëveshje të tjera mirëkuptimi, si edhe të rishikohen ato ekzistuese, në kuadër të rritjes së bashkëpunimit dhe koordinimit ndër-institucional.

Memorandumet e reja që priten të nënshkruhen në 2019 janë:

1. Ministrinë e Energjisë dhe Infrastrukturës
2. Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit
3. Ministrinë e Drejtësisë

Përgjatë vitit 2019, do të rishikohen Memorandumet me:

1. Bankën e Shqipërisë
2. Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave
3. Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve

### **Strategjia për Zhvillimin e Sistemit Kombëtar Statistikor**

Një hap i rëndësishëm drejt zhvillimit të Sistemit Kombëtar Statistikor është edhe përgatitja e një strategjie në nivel vendi. Për këtë qëllim, Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim i ka siguruar Shqipërisë një grant, i cili do të përdoret gjatë vitit 2019 për angazhimin e ekspertëve të fushës në përgatitjen e strategjisë. Strategjia do të shoqërohet edhe me një plan të posaçëm veprimi, në terma afat-mesëm, i cili do të bëhet gjithashtu pjesë e planeve të punës në periudhat në vazhdim. Në terma të përgjithshme, strategjia e zhvillimit të SKS do të synojë:

- përmbushjen e detyrimeve të Eurostat për forcimin e SKS dhe zbatimin e parimeve statistikore;
- zgjerimin diapazonit të temave dhe sasisë së statistikave zyrtare;
- përmirësinë e cilësisë statistikore nëpërmjet prezantimit të teknikave inovative përpunuese;
- forcimin e marrëdhënieve ndër-institucionale dhe prodhues-përdorues për t'iu përgjigjur sa më mirë kërkesave të publikut për statistika

**Zbatimi i PSZ për vitin 2018**

Programi i Statistikave Zyrtare është dokumenti bazë i cili përcakton objektivat strategjike të zhvillimit të Sistemit Kombëtar Statistikor dhe aktivitetet prioritare statistikore për tu përmbushur nga sistemi gjatë harkut kohor prej pesë viteve. Programi hartohet nga INSTAT në bashkëpunim me prodhuesit e tjerë të statistikave zyrtare dhe, pasi diskutohet në Këshillin e Statistikave dhe grupet e interesit, i përcillet Kuvendit të Shqipërisë për miratim. Mbështetur në ligjin e ri për statistikave zyrtare, zbatimi i Programit sigurohet nëpërmjet një Plani Vjetor, dokumenti i cili miratohet gjithashtu nga Kuvendi. Programi aktual përfshin periudhën 2017-2021.

Për vitin 2018, në Programin e Statistikave Zyrtare 2017-2021 ishin parashikuar 149 aktivitete statistikore për tu realizuar, nga të cilat 3 mbulohen nga Ministria e financave dhe Ekonomise, 30 nga Banka e Shqipërisë dhe 116 nga INSTAT. Ministria e Financave dhe Ekonomise dhe Banka e Shqipërisë kanë realizuar të gjitha aktivitetet e planifikuara për vitin, ndërsa INSTAT nuk ka realizuar 3 aktivitete statistikore si më poshtë:

1. Publikimi i rezultateve të Anketës së të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës 2016, 2017.
2. Publikimi i treguesve të Kërkim-zhvillimit dhe Inovacionit
3. Publikimi i anketës së Turizmit në familje

Informacion më i detajuar rreth aktiviteteve të porealizuara ndodhen në fund të këtij seksioni.

Gjatë vitit 2018, INSTAT, Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë janë angazhuar për të realizuar të gjitha detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i Programit. Në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse për të dhënat administrative, janë realizuar aktivitetet statistikore sipas parashikimeve për vitin 2018, ku në fushën ekonomike mund të veçohet: Prodhimi i statistikave të Produktit të Brendshëm Bruto vjetor dhe tremujor, publikimi i Llogarisë së Prodhimit dhe Gjenerimit të të ardhurave sipas sektorëve institucional, prodhimi i treguesve të Indeksit të Çmimeve të Konsumit dhe Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit, Punës, Pagave dhe Panunësisë, treguesve Afatshkurtër dhe Strukturorë të Ndërmarrjeve. Në fushën sociale: prodhimi i treguesve të Popullsisë, treguesve mbi të Huajt dhe Azilkërkuesit, treguesve të Arsimit, Shëndetësisë, Krimeve, Kulturës si dhe në fushën e bujqësisë dhe mjedisit: prodhimi i treguesve të Qumështit, indeksit të Çmimeve të Prodhimeve Bujqësore; prodhimi i treguesve mbi Mbetjet e Ngurta Urbane të menaxhuara si dhe i treguesve mbi Sipërfaqen Bujqësore të përdorur, Pyjet dhe Kullotat.

Informacioni në vijim paraqet aktivitetet kryesore të realizuara, sipas fushave përkatëse statistikore.

**Produktet statistikore në fushën ekonomike**

Në lidhje me statistikat e fushës ekonomike, Sistemi Kombëtar Statistikor ka prodhuar treguesit e PBB final 2015, gjysmëfinal 2016; tregues tremujorë të PBB-së me metodën e prodhimit dhe shpenzimeve; tregues për indeksin e çmimeve të konsumit dhe indeksin e harmonizuar; tregues për ndërmarrjet; bilancin e pagesave; statistika monetare dhe financiare, të borxhit etj.

Për prodhimin e këtyre treguesve, janë kryer vërtetimet statistikore, si: Vërtetimi për matjen e fuqisë blerëse; Vërtetimi mujor për matjen e çmimeve të konsumit apo Vërtetimi për teknologjinë e informacionit dhe komunikimit në ndërmarrje.

INSTAT ka kryer, në veçanti edhe një sërë aktivitetesh të tjera, të cilat nuk kanë qenë të parashikuara në PSZ, por që kanë ndikuar në sasinë dhe cilësinë e produkteve statistikore, për të rritur gamën dhe kënaqësinë e përdoruesve për këto produkte, si: publikimi i statistikave të ndërmarrjeve të vogla e të mesme; publikimi i statistikave të bizneseve të huaja në Shqipëri; Publikimi i treguesve rajonal të ndërmarrjeve dhe publikimi i "Turizmi në Shifra". Në vijim paraqiten në formë të përmbledhur aktivitetet kryesore statistikore për fushën ekonomike:

- Prodhimi i PBB me metodën e prodhimit dhe shpenzimeve, final 2015, gjysmëfinal 2016;
- Prodhimi i PBB sipas rajoneve statistikore, për vitin 2016;
- Hartimi i tabelave burim-përdorime dhe input – output për vitin 2015;
- Dërgimi i tabelave të Precedurës së Deficitit të Tejkalluar (EDP) në përputhje me ESA 2010, vitet 2014 – 2017;
- Prodhimi i statistikave financiare të Qeverisë sipas GFSM2015;
- Prodhimi i Statistikave të Borxhit;
- Prodhimi i statistikave Monetare dhe Financiare;
- Prodhimi i treguesve tremujorë të PBB-së me metodën e prodhimit dhe shpenzimeve, Tr4-2017, Tr1-2018, Tr2-2018, Tr3-2018;
- Prodhimi i statistikave të indeksit të çmimeve të konsumit dhe indeksit të harmonizuar të çmimeve të konsumit;
- Prodhimi i statistikave të çmimeve të prodhimit, të ndërtimit, të importit;

- Prodhimi i statistikave të tregtisë së jashtme;
- Prodhimi i statistikave të Bilancit të Pagesave;
- Prodhimi i statistikave të indeksit të çmimeve të konsumit dhe atij të harmonizuar;
- Prodhimi i statistikave të çmimeve të prodhimit, ndërtimit, importit;
- Prodhimi i statistikave mbi lejet e ndërtimit;
- Prodhimi i statistikave të bilancit të energjisë elektrike, tremujor;
- Prodhimi i statistikave të bilancit energjetik, vjetor;
- Prodhimi i statistikave të tregtisë së jashtme;
- Prodhimi i statistikave të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në ndërmarrje;
- Prodhimi i statistikave strukturore të ndërmarrjeve;
- Prodhimi i statistikave mbi regjistrin e ndërmarrjeve;
- Prodhimi i statistikave mbi lëvizjen e shtetasve;
- Prodhimi i statistikave të turizmit;
- Prodhimi i statistikave të transportit (hekurudhor, detar dhe ajror);
- Prodhimi i statistikave mbi aksidentet rrugore;

#### **Produktet statistikore në fushën e statistikave sociale**

Fusha e statistikave sociale përfshin një gamë të gjerë treguesish në PSZ dhe kërkon angazhimin e një pjese të konsiderueshme të burimeve financiare dhe njerëzore. Në të përfshihen statistika demografike të popullsisë, forcave të punës, arsimit, shëndetësisë, konsumit, mbrojtjes sociale etj. Gjatë vitit 2018, INSTAT ka prodhuar tregues të popullsisë dhe strukturës për grup-moshë dhe qarqe si dhe e treguesve të statistikave demografike; statistika mbi të huajt me leje qëndrimi dhe azil-kërkuesve; tregues gjinorë; statistika të krimeve dhe tregues të tregut të punës, punësimit, papunësisë dhe pagave, me periodicitet tremujor dhe vjetor.

Për prodhimin cilësor të treguesve të kësaj kategorie, janë kryer vërtetime statistikore, si Vërtetimi “Anketa e Forcave të Punës 2017”; Vërtetimi “Anketa e Kostove të Punës 2016”, Vërtetimi “Anketa e Buxhetit të Familjes 2017” apo anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës, e cila siguron mbledhjen e informacionit mbi strukturën e të ardhurave dhe nivelit të jetesës në Shqipëri.

Gjithashtu, janë kryer edhe një sërë aktivitete të reja statistikore, të paparashikuara në PSZ, si “Statistikat e regjistrimeve dhe diplomimeve”; Studimi i Demografisë dhe Shëndetit në Shqipëri apo edhe kryerja e vërtetimit shtesë si Anketa e Turizmit në Familje – Pushime dhe Udhëtime, në Shqipëri”, e cila mbledh informacion mbi udhëtimet e kryera nga NjEF/individët për qëllime pune apo personale në vitet 2017 dhe 2018; Vërtetimi mbi Përdorimin e Teknologjisë së Komunikimit të Informacionit nga ana e Familjeve dhe Individëve, 2018, e cila mbledh informacion mbi nivelin e përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në NjEF/individët në Shqipëri.

Në vijim aktivitetet kryesore statistikore të performuara gjatë vitit 2018:

- Prodhimi i treguesve të popullsisë dhe strukturës për grup-moshë dhe qarqe, për vitin 2017, si dhe e treguesve të statistikave demografike;
- Prodhimi i treguesve të lindjeve, vdekjeve dhe migracionit të brendshëm e të jashtëm;
- Prodhimi i treguesve të statistikave mbi të huajt me leje qëndrimi dhe azil-kërkuesve;
- Prodhimi i treguesve të arsimit sipas ISCED 2011 dhe treguesve për institucionet arsimore publike e private;
- Prodhimi i treguesve të tregut të punës, punësimit, papunësisë dhe pagave, me periodicitet tremujor dhe vjetor;
- Prodhimi i treguesve statistikor mbi dhunën ndaj grave dhe vajzave, 2018;
- Prodhimi i treguesve gjinor;
- Prodhimi i treguesve vjetor mbi statistikën e krimeve;
- Prodhimi i treguesve tremujor të krimeve;
- Prodhimi i treguesve tremujor të kulturës;
- Prodhimi i treguesve të shëndetësisë;
- Prodhimi i treguesve për regjistrimet në arsim 2017-18;
- Prodhimi i treguesve për diplomimet 2016-17.

#### **Produktet statistikore në fushën e bujqësisë dhe mjedisit**

Si faktor shumë i rëndësishëm në ekonominë e vendit, sektori i bujqësisë dhe mjedisit ka zënë fokus gjithnjë e më të madh tek institucionet prodhuese të statistikave. Rritja e cilësisë dhe shtesa e treguesve të kësaj fushe i mundëson politikbërësve të hartojnë



strategjitë e duhura për planifikimin, zhvillimin dhe monitorimin e aktiviteteve në sektorët bujqësorë dhe mjedisorë.

Ndër zhvillimet kryesore në fushën e statistikave të bujqësisë, veçohen statistikave që rrjedhin nga vërtetimet në fermat bujqësore, prodhimi i statistikave të qumështit dhe nënprodukteve të tij, indeksi i çmimeve të prodhimeve bujqësore; prodhimi i statistikave mbi mbetjet e ngurta urbane të menaxhuara; prodhimi i treguesve mbi sipërfaqen bujqësore të përdorur apo prodhimi i statistikave të pyjeve dhe kullotave.

Për prodhimin cilësor të treguesve të kësaj kategorie, janë kryer edhe një sërë vërtetimesh të tjera ose pilot, si vërtetimi mbi mbetjet industriale sipas aktiviteteve ekonomike; Vërtetimi mbi ujin dhe përdorimin e tij, sipas aktiviteteve ekonomike; Vërtetimit vjetor në bujqësi; Vërtetimi pilot mbi sipërfaqen e mbjellë.

Aktivitetet kryesore statistikore të zhvilluara gjatë vitit 2018 në fushën e statistikave të bujqësisë e mjedisit janë si vijon:

- Prodhimi i treguesve mbi sipërfaqen bujqësore të përdorur;
- Prodhimi i statistikave të bimeve të arave;
- Prodhimi i statistikave të drufrutorëve;
- Prodhimi i statistikave mbi metodat e prodhimit bimor;
- Prodhimi i statistikave të pyjeve dhe kullotave;
- Prodhimi i statistikave të biodiversitetit;
- Prodhimi i statistikave rreth numrit të krerëve të bagëtive;
- Prodhimi i statistikave për prodhimet blegtorale;
- Prrodhimi i statistikave rreth strukturës së blegtorisë në njësi gjedhi;
- Indeksi i çmimeve të prodhimeve bujqësore;
- Prodhimi i mishit të therur sipas llojeve nga thertoret;
- Prodhimi i llogarive ekonomike në bujqësi, me bazë tre-mujore, vjetore;
- Prodhimi i statistikave të qumështit dhe nënprodukteve të tij, në ferma;
- Prodhimi i statistikave të qumështit dhe nënprodukteve të tij, në industri;
- Prodhimi i statistikave të peshkimit, sipas kategorive ujore;

- Prodhimi i statistikave mbi llogaritë ekonomike në peshkim dhe akuakulturë, në nivel vendi dhe rajonal;
- Prodhimi i të dhënave rreth taksave mjedisore;
- Prodhimi i të dhënave rreth llogarive të flukseve të materialeve mjedisore;
- Prodhimi i statistikave mbi cilësinë e ajrit sipas qyteteve;
- Prodhimi i statistikave mbi cilësinë e ujit në det dhe lumenj;
- Prodhimi i statistikave mbi mbetjet e ngurta urbane të menaxhuara;
- Prodhimi i statistikave rreth automjeteve sipas lëndëve djegëse dhe vitit të prodhimit;

## AKTIVITETE TË PAREALIZUARA

Nga 149 aktivitete statistikore të parashikuara në Program, për vitin 2018, 3 aktivitete statistikore nuk janë realizuar. Informacioni mbi aktivitetet e perealizuara dhe shkaqet e mosrealizimit të tyre paraqiten në tabelën e mëposhtme.

**Tabela 4: Lista e aktiviteteve të perealizuara apo jo të përputhura plotësisht me standartet e Eurostatit, për vitin 2018**

Nr	Aktivitete	Shkaku i mosrealizimit
1	Publikimi i rezultateve të Anketës së të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës 2016, 2017.	Janë mbledhur të dhënat në terren për vitet 2016, 2017 dhe 2018. Publikimi i rezultateve është shtyrë për në vitin 2019 ku do të paraqiten rezultatet e Anketës së të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës 2016, 2017, 2018.
2	Publikimi i treguesve të Kërkim-zhvillimit dhe Inovacionit	Janë mbledhur të dhëna, por nuk u publikuan si rezultat i një cilësie të dobët dhe ekspertizë jo të plotë.
3	Publikimi i anketës së Turizmit në familje	Është menduar konsolidimi i anketës për një seri kohore 2 ose 3 vjeçare duke qenë se është një anketë komplekse me qëllim studimin dhe analizimin e indikatorëve dhe cilësisë së tyre në seri.

## Shkaqet e mosrealizimit

1. Publikimi i rezultateve të Anketës së të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës 2016, 2017 u shty për në vitin 2019. Arsyeja e mosrealizimit të publikimit ka të bëjë me faktin se një pjesë e kampionit përsëritet nga viti në vit dhe është e domosdoshme të kontrollohet konsistenca e të dhënave në disa vite. Gjithashtu, anketa duhet të konsolidohet meqenëse po kryhet për herë të parë në Shqipëri. Publikimi i rezultateve në vitin 2019 do të paraqesë rezultatet e Anketës së të

Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës për vitet 2016, 2017 dhe 2018. Një praktikë e tillë është ndjekur edhe nga vendet e tjera që kanë implementuar për herë të parë Anketën e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës si Maqedonia, Mali i Zi etj.

2. Aktiviteti statistikor "Statistikat e Kërkim-zhvillimit dhe Inovacionit" nuk është publikuar për shkak të cilësisë së dobët të të dhënave të mbledhura dhe ekspertizës jo të plotë.
3. Nuk janë publikuar treguesit kryesorë të anketës së Turizmit në familje pasi është menduar konsolidimi i anketës për një sërë kohore 2 ose 3 vjeçare duke qenë se është një anketë komplekse me qëllim studimin dhe analizimin e indikatorëve dhe cilësisë së tyre në seri.

#### **Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm**

Në vitin 2015, Shqipëria firmosi angazhimin global për zbatimin e Agjendës 2030, për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, për ta zbatuar atë dhe në kontekstin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) si dhe procesit të integritimit Evropian si prioriteti më i lartë dhe strategjik i vendit. Në këtë angazhim edhe INSTAT, si institucioni lider për prodhimin e statistikave zyrtare në vend dhe më i rëndësishmi për furnizimin dhe prodhimin e indikatorëve të nevojshëm për zbatimin e agjendës 2030 dhe monitorimin e arritjeve të 17 objektivave të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm ka vënë në dispozicion ekspertizën e saj. Konkretisht, INSTAT është pjesë e Grupit Teknik Ndërinstitucional për OZHQ-që drejtuar nga Kryeministria, por akoma nuk ka një rol zyrtar për prodhimin dhe monitorimin e indikatorëve të agjendës 2030. INSTAT ka qenë vazhdimisht aktiv dhe i gatshëm për të qenë lider në validimin e të dhënave dhe në ofrimin e ekspertizës për prodhimin e të dhënave nga ministrinë e linjës ashtu sikurse të gjithë Institutet e Statistikave në të gjithë botën. INSTAT ka punuar vullnetarisht për prodhimin e një aneksi statistikor, i cili ju bashkëngjiti Raportit Vullnetar për OZHQ-të prezantuar në Forumin e Lartë Politik, në Korrik të vitit 2018. Gjithashtu INSTAT shumë shpejt do të publikojë, botimin e parë për OZHQ-të me fokus indikatorët statistikorë si dhe Dashboard për OZHQ-të, i cili do të përditësohet vazhdimisht me indikatorë të rinj.

## Aksione të reja statistikore gjatë vitit 2019

Me qëllim përgjigjen sa më të mirë të kërkesave të përdoruesve si dhe rritjen e cilësisë së produkteve statistikore, duke marrë parasysh edhe gjendjen e vendit tonë në kuadër të hapjes së negociatave, për vitin 2019, INSTAT ka ndërmarrë iniciativa të reja në të gjitha fushat e prodhimit statistikor dhe modernizimin e infrastrukturës së prodhimit, ku në fushën ekonomike ndër të tjera mund të veçohet: Vlerësimi eksperimental i indeksit të Çmimeve të Banesave, implementimi i gjuhës R për kontrollin dhe llogaritjen e treguesve statistikorë, prodhimi i statistikave mbi bazën e Produkteve të Industrisë Përpunuese, prodhimi i të dhënave paraprake për Inovacionin në Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme si dhe publikimi i të dhënave paraprake të shpenzimeve për Kërkim-Zhvillim nga institucionet dhe ndërmarrjet private; Në fushën sociale: Kryerja e Anketës së Migracionit, publikimi i rezultateve të Anketës së Dhunës ndaj grave dhe vajzave 2018, fillimi i punës për Anketën e Shëndetit, publikimi i Rezultateve të Anketës mbi Përdorimin e Teknologjisë së Komunikimit të Informacionit nga ana e Familjeve dhe Individëve, 2018 si dhe publikim i rezultateve të Anketës së të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës, 2016-2017-2018 dhe në fushën e bujqësisë dhe mjedisit: Llogaritja e treguesve për prodhimin bimor, blegtoral dhe treguesve të llogarive ekonomike në bujqësi, kryerja e vrojtimit mbi sipërfaqen e mbjellë, llogaritja e SO (standard outputit) për bujqësinë dhe për blegtorinë si dhe kryerja e vrojtimit mbi përpunimin e lëndës drusore pranë ndërmarrjeve të përpunimit të drurit.

Më poshtë, aksionet e reja që do të ndërmerren në vitin 2019 sipas fushave kryesore statistikore:

### Statistikat ekonomike:

1. Llogaritja e Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit-Taksa Konstante;
2. Vlerësimi eksperimental i Indeksit të Çmimeve të Banesave;
3. Prodhimi i treguesit të Shitjeve nga burime administrative;
4. Përmirësimi i metodës së mbledhjes së çmimeve duke përdorur tabletat, për produktet ushqimore;
5. Implementimi i gjuhës R për kontrollin dhe llogaritjen e treguesve statistikorë;
6. Prodhimi i statistikave mbi bazën e produkteve të industrisë përpunuese (PRODCOM);
7. Publikimi i të dhënave paraprake për Inovacionin në Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme;

8. Publikimi i të dhënave paraprake të shpenzimeve për Kërkim-Zhvillim nga institucionet dhe ndërmarrjet private;
9. Prodhimi i statistikave të turizmit (strukturat akomoduese);
10. Publikimi i regjistrit të mjeteve të transportit rrugor;

**Statistikat sociale:**

1. Kryerja e Censit pilot të Popullsisë e Banesave;
2. Kryerja e Anketës së Migracionit;
3. Publikimi i Rezultateve të Anketës së Turizmit – Pushime dhe Udhëtime, 2017-18;
4. Publikimi i Rezultateve të Anketës mbi Përdorimin e Teknologjisë së Komunikimit të Informacionit nga ana e Familjeve dhe Individëve, 2018;
5. Publikim i rezultateve të Anketës së të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës, 2016-2017-2018;
6. Publikimi i rezultateve të Anketës së Dhunës ndaj grave dhe vajzave 2018;
7. Publikimi vjetor i statistikave të krimeve;
8. Llogaritja e treguesve të barazisë gjinore;
9. Rishikimi i botimit tremujor të statistikave të kulturës;
10. Përfshirja e treguesve për personat me aftësi të kufizuara;
11. Fillimi i punës për anketën e shëndetit;
12. Plotësimi i pyetësorit të shpenzimeve në shëndetësi;

**Statistikat e bujqësisë dhe mjedisit:**

1. Vrojtimi vjetor në bujqësi për vitin 2018. Llogaritja e treguesve për prodhimin bimor, blegtoral dhe treguesve të llogarive ekonomike në bujqësi;
2. Vrojtimi vjetor në bujqësi për vitin 2019. Përgatitja e pjesës metodologjike të vrojtimit;
3. Vrojtimi vjetor për ujin dhe përdorimin e tij. Llogaritja e treguesve të përdorimit të ujit sipas aktivitetit ekonomik;
4. Llogaritja e SO (standard output) për bujqësinë dhe për blegtorinë;
5. Revizionimi i serisë kohore mbi statistikën e prodhimit bimor 2013-2017;
6. Vrojtim për sipërfaqen e mbjellë;
7. Mbledhja e të dhënave administrative për prodhimin bimor në nivel bashkie;
8. Mbledhja e të dhënave administrative për prodhimin shtazor në nivel bashkie;
9. Mbledhja e të dhënave administrative mbi pyjet, kullotat dhe biodiversitetin në nivel bashkie;
10. Mbledhja e të dhënave administrative mbi peshkimin dhe flotën detare;

11. Vrojtimi mbi përpunimin e lëndës drusore pranë ndërmarrjeve të përpunimit të drurit;
12. Mbledhja e të dhënave vjetore mbi të mirat dhe shërbimet në mjedis, bazuar në të dhënat administrative;
13. Mbledhja e të dhënave vjetore mbi llogaritë e emetimeve në ajër dhe në ujë, bazuar në të dhënat administrativ.

#### **Aktivitetet e reja jo-statistikore**

Përveç aktiviteteve statistikore, për vitin 2019 janë parashikuar edhe aktivitete të tjera mbështetëse, të cilat ndikojnë në mënyrë të tërthortë në cilësinë e statistikave zyrtare dhe besueshmërinë e publikut në to. Në këtë aspekt përfshihen veprimtari në lidhje me organizimin e konferencave, workshopeve, trajnimeve si edhe ndërhyrjeve në infrastrukturën IT për modernizimin e procesit të përpunimit të të dhënave.

Gjithashtu, fokus i veçantë do t'i jepet edhe angazhimit për hartimin e projekt-akteve të duhura për mbarëvajtjen e veprimtarisë statistikore, forcimit të bashkëpunimit me grupet e interesit si dhe hartimit të politikave për interpretimin e drejtë të statistikave zyrtare.

Ndër aktivitetet jo-statistikore veçohen:

- Përgatitja e kuadrit ligjor për zbatimin e Censit të Popullsisë e Banesave;
- Ngritja e strukturave që do të angazhohen për kryerjen e Censit;
- Përgatitja e Strategjisë së Zhvillimit të Sistemit Kombëtar Statistikor 2019-2030;
- Lançimi i sistemit INTRANET, si mekanizëm që ndikon drejtpërdrejtë në mbajtjen e përditësuar të stafit për zhvillimet më të fundit në institucioni, përmirësimin e rrugëve të komunikimit dhe përdorimit të informacionit dokumentar e statistikor;
- Pasurimi i moduleve të trajnimit për statisticienët, punonjësit e institucioneve që japin të dhëna administrative;
- Përgatitja e literaturës statistikore për tu prezantuar në nxënësit e shkollave të mesme;
- Organizimi i fushatave informuese për veprimtarinë statistikore, si për shembull fushatat publicitare në lidhje me censin e ardhshëm të popullsisë e banesave;
- Pasurimi i Revistës shkencore "Kërkimi" me materialet më të fundit studimore që përgatit INSTAT apo kërkues të tjerë të interesuar;
- Hartimi i udhëzuesit për menaxhimin e projekteve mbështetëse;
- Testimi i sistemeve të TI si dhe organizimi i trajnimeve të përdoruesve të këtyre sistemeve;
- Kryerja e proceseve të vetëvlerësimit;
- Auditime statistikore

## Censi i Popullsisë dhe Banesave

Censi i Popullsisë dhe Banesave është aktiviteti kryesor dhe më kompleks statistikor që zhvillohet në nivel vendi. Ky ushtrim mundëson furnizimin e përdoruesve me të dhënat më të fundit të Republikës së Shqipërisë në lidhje me natyrën demografike, sociale dhe gjeohapsinore të popullsisë dhe ndërtesave në vend.

Censi i Popullsisë dhe Banesave do të luajë një rol vendimtar në përditësimin e informacionit statistikor të nevojshëm urgjent në nivel lokal dhe rajonal dhe në kuptimin dhe paraqitjen e ndryshimeve që kanë ndodhur në Shqipëri që nga viti 2001 dhe 2011. Censi do të kontribuojë gjithashtu në krijimin e një regjistri statistikor ndërtesash dhe banesash dhe të regjistrave statistikorë të popullsisë në nivel lokal dhe kombëtar, të cilët do të jenë burimi i statistikave vjetore të Censit të ardhshëm.

Censi i radhës është konsideruar si një projekt prioritar kombëtar nga qeveria shqiptare. Ai do të jetë thelbësor për hartimin e politikave të bazuara në tregues dhe përcaktimin e qëllimeve socio-ekonomike dhe planeve për zhvillim të qëndrueshëm në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal, si dhe për një sistem statistikor të qëndrueshëm dhe efikas, bazuar në një kombinim të të dhënave administrative dhe vrojtmeve.

Sipas standardeve më të fundit të përcaktuara nga Kombet e Bashkuara dhe Eurostat, si dhe duke parasysh ndërlíkueshmërinë dhe koston e lartë të këtij ushtrimi, Censi i kësaj radhe do të jetë i fundit i kryer në mënyrë tradicionale. Bazuar në planin e tij afatmesëm dhe vjetor, INSTAT ka planifikuar të kryejë Censin në tetor të vitit 2020.

Në kuadër të përgatitjeve për Censin të ardhshëm të Popullsisë dhe Banesave, gjatë vitit 2018 INSTAT ka ndërmarrë një sërë aktivitetesh, ku më kryesorët janë:

- **Përgatitja e Strategjisë së Censit**, proces i cili është mbështetur nga Qeveria Zvicerane nëpërmjet projektit “Statistika të Forta Vendore Shqiptare”. Dokumenti strategjik do të shërbejë si dokumenti orientues për të realizuar këtë aktivitet madhor. Strategjia përcakton bazën ligjore, teknologjinë që do të përdoret si dhe aspekte operacionale e financiare të Censit 2020.

- **Rishikimi i ligjit të censit**. INSTAT ka rishikuar Ligjin e Censit të Popullsisë dhe të Banesave me mbështetjen e ekspertëve të huaj si dhe pas konsultimit me të gjithë grupet e interesit. Aktualisht, projektligji është në proces shqyrtimi në Këshillin e Ministrave dhe Kuvendin e Shqipërisë.

- **Pyetësori paraprak i censit**. Përfundoi përgatitja e draftit final të pyetësorit të censit, pas konsultimit të pëmbatjes së tij me grupet e interesit. Për këtë zhvilluan 6 tavolina

konsultative, ndër të cilat 5 për pyetësin dhe një për ligjin e Censit. Konsultimet ndikuan në hartimin e pyetjeve sa më të qarta dhe relevante, në mënyrë që produkti statistikor t'i afrohej kërkesave të përdoruesve. Duhet theksuar se pyetësi i censit është në linjë edhe me strukturën e pyetjeve thelbësore dhe jothelbësore të përcaktuara nga Kombet e Bashkuara.

Në kuadër të proceseve përgatitore është kryer gjithashtu piloti për përditësimin e hartës së Censit në terren, ku qëllimi kryesor ishte kalimi nga përditësimi në formatin e hartës letër në metodën e re të mbledhjes së informacionit gjeografik me teknologjinë GIS, nëpërmjet përdorimit të pajisjeve elektronike.

Në kuadër të Marrëveshjes Financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Evropian, për programin vjetor kombëtar IPA 2014, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Parazgjerimit (IPA II), me Vendim Nr. 716, datë 05.12.2018 është miratuar në parim marrëveshja financiare për rialokimin e një fondi prej 4,8 milion Euro për projektin “Mbështetje për zbatimin e aktiviteteve të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2020”.

Me qëllim që të sigurohet përputhshmëria e standardeve ndërkombëtare të censit, më datë 17 Tetor është dorëzuar paketa e aplikimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, Bankës Botërore dhe Donatorëve të tjerë, CFCU, për përfitimin e Gantit Direkt të financuar nga BE si dhe janë përgatitur Termat e Referencës për asistencën teknike. Nëpërmjet kësaj mbështetje, do të mundësohet ekspertizë dhe ngritje kapacitetesh për realizimin e aktiviteteve të Censit. Ndërkohë, INSTAT ka ngritur grupin përkatës të punës, i cili do të ndjekë zbatimin e projektit në të gjitha hallkat e tij.

Në datë 11.12.2018 u firmos marrëveshja e grantit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, Bankës Botërore dhe Donatorëve të tjerë (CFCU) dhe Institutit të Statistikave (INSTAT). Gjatë muajit Dhjetor filloi procedura e vlerësimit për tenderin “Mbështetje për zbatimin e Censit të Popullsisë dhe Banesave 2020 në Shqipëri” me qëllim përzgjedhjen e kompanisë që do të zbatojë kontratën e shërbimit të asistencës teknike.

#### **Aktivitetet e planifikuara në 2019**

Viti 2019 rezervon pjesën më të madhe të aktiviteteve përgatitore të Censit. Në aspektin e përcaktimit të kuadrit ligjor për kryerjen e censit, brenda këtij viti do të miratohet nga Kuvendi i Shqipërisë projektligji i ri “Për censin e popullsisë dhe banesave”. Projektakti do të mundësojë përafrimin e standardeve të reja të Kombeve të Bashkuara për censet e radhës si dhe do të shërbejë si akti bazë për nxjerrjen e akteve të tjera të karakterit operacional, duke patur parasysh ndarjen e re administrative të



Republikës së Shqipërisë, statusin e INSTAT si organi përgjegjës për mbarëvajtjen e censit dhe rolin e organeve të vetëqeverisjes vendore.

Në tetor të vitit 2019, pritet të kryhet Piloti i Censit, ku do të testohen të gjitha fazat e tij. Aktivitetet do të fillojnë me përditësimin në terren të 11,775 zona censi, me aplikacionin kompjuterik të testuar paraprakisht në pilot. Ndër të tjera do të përditësohet teknologjia GIS; organizimi dhe realizimi i trajnimit të anketuesve; përditësimi dhe përmirësimi i bazës së të dhënave të INSTAT-it (adresat, emrat e rrugëve, pikat e interesit dhe të tjera të dhëna hapësinore). Në kuadër të pilotit, do të testohet mbështetja, orientimi dhe monitorimi i anketuesve dhe stafit në terren me hartën e Censit. Gjithashtu, piloti do të mundësojë finalizimin e pyetësorit, përgatitjen e materialeve ndihmëse të stafit në terren, materialet e trajnimit, etj. Një element i rëndësishëm tek i cili do të punohet gjatë vitit 2019 do të jetë edhe vlerësimi i situatës në terren në lidhje me strukturat lokale që operojnë, kapacitetet, gjendja e sistemit të adresave etj. Kjo parashikon që të zhvillohen takime me organet e vetëqeverisjes vendore për të identifikuar sa më saktë mundësitë dhe elementët që do të mund të suportohen nga këto struktura, por njëkohësisht edhe mbledhur informacion dhe vlerësuar nevojat për rastet kur njësitë vendore nuk mund ta mbështesin Cens-in sipas kërkesave të tij.

Teknologjia e informacionit përbën një element të rëndësishëm në Cens jo vetëm në kuadër të automatizimit të proceseve, por sidomos për faktin që të dhënat do të mbledhen me pyetësorë elektronikë. Gjatë vitit 2019 do të realizohet puna përgatitore për zhvillimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit në mbështetje të Cens. Do të zhvillohen dhe testohen sistemet e TI për pyetësorin elektronik si edhe sistemin e monitorimit të procesit në terren. Një hap i rëndësishëm në mbarëvajtjen e punës është edhe trajnimi i përdoruesve të këtyre sistemeve. Piloti do të jetë momenti kyç për testimin e sistemeve në tërësi dhe përditësimin/përmirësimin e tyre si pasojë e gjetjeve të tij. Gjatë vitit 2019 do të kryhet vlerësimi, kontraktimi dhe zbatimi i kontratës së shërbimit për asistencën teknike. Do të kryhen procedurat e prokurimit për blerjen e pajisjeve IT të nevojshme për kryerjen e aktiviteteve të Censit 2020 duke përfshirë pilotin e Censit dhe përditësimin e hartave si dhe të gjitha procedurat e prokurimit sipas planit të prokurimeve të aprovuar.

Nga ana tjetër, punë përgatitore do të kryhet edhe nga burimet njerëzore për realizimin e veprimtarive menaxhuese të burimeve njerëzore në bashkëpunim me njësitë e tjera dhe stafin e INSTAT-it. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe përpunime me legjislacionin do të hartohen dhe zbatohen procedurat e rekrutimit të stafit shtesë që do të punësohen gjatë 2019 për plotësimin e nevojave referuar aktiviteteve të Cens-it.

## Cilësia e të dhënave

Cilësia e të dhënave statistikore konsiderohet tërësia e karakteristikave dhe elementëve të një produkti statistikor, i cili përmbush sa më shumë të jetë e mundur pritshmëritë e përdoruesve të tij. Kriteret themelore sipas të cilave statistikatat zyrtare duhet të prodhohen, janë të përcaktuara në nenin 5 të ligjit nr. 17/2018 “Për statistikatat zyrtare”, janë: “Rëndësia”, “Saktësia”, “Koha dhe Përpikëria”, “E drejta e hyrjes dhe Qartësia”, “Krahasueshmëria dhe Koherenca”, “Përkatësia”, “Transparenca”.

INSTAT gjatë vitit 2018 ka punuar në kuadër të sigurimit të cilësisë statistikore. Puna është fokusuar në hartimin dhe publikimin e raporteve të cilësisë për përdoruesit, mbështetur në konceptin e cilësisë së Sistemit Evropian të Statistikave. Në përputhje me parimin 4, Cilësia statistikore, të Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane, INSTAT ka ndërmarrë disa iniciativa si: publikimi i Deklaratës së Cilësisë të INSTAT, dokumentimi i proceseve statistikore sipas modelit të përgjithshëm të menaxhimit të proceseve statistikore të njohur ndryshe edhe si GSBPM si edhe puna përgatitore për implementimin e Auditit Statistikor. Në përputhje me parimin 9, ngarkesa ndaj të intervistuarve, të Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane, INSTAT monitoron përmes dy treguesve bazë: numri i pyetësorëve që ndërmarrjet/familjet duhet të përgjigjen si dhe kohëzgjatjen e intervistës.

Në vitin 2019, do të vazhdojë procesi i dokumentimit të produkteve statistikore, prodhimit të raporteve të cilësisë si dhe pilotimin e auditit statistikor. Deri në fund të vitit 2019 do të jenë të dokumentuara të gjitha aktivitetet statistikore sipas modelit GSBPM dhe do të prodhohen 30 raporte cilësie sipas modelit të përcaktuar nga Sistemi Statistikor Evropian (ESS).

### Deklarata e Cilësisë së INSTAT

INSTAT synon të ofrojë produkte dhe shërbime statistikore që korrespondojnë me nevojat për informacion nga grupe të ndryshme të përdoruesve. Përmirësimi i cilësisë së informacionit statistikor kryhet vazhdimisht duke kërkuar kostot më të ulëta të mundshme dhe duke zvogëluar barrën e përgjigjes. Në vitin 2018, INSTAT ka bërë të disponueshëm për publikun Deklaratën e Cilësisë së INSTAT. Nëpërmjet këtij dokumenti përcaktohet se Sistemi i cilësisë në INSTAT bazohet në 15 parimet e Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane (CoP) të publikuara nga ESS dhe të përafuara plotësisht në ligjin e ri për statistikatat zyrtare.

**Dokumentimi i proceseve statistikore**

INSTAT për të ndjekur dhe monitoruar aktivitetet statistikore të planifikuara për t'u kryer gjatë vitit 2018 zbatoi modelin e përgjithshëm të menaxhimit të proceseve statistikore të njohur ndryshe edhe si GSBPM (Generic Statistics Business Process Model), të implementuar në shumë shtete të Evropës dhe më tej. Në vetvete ky model përshkruan dhe përcakton të gjithë bashkësinë e proceseve të nevojshme për t'u ndjekur për prodhimin e statistikave zyrtare, duke siguruar një kornizë standarde dhe terminologji të harmonizuar. Në vitin 2018, INSTAT dokumentoi 48 aktivitete statistikore të cilat ndjekin këtë model. Gjithashtu u organizuan dy workshope për ngritjen e nivelit profesional të stafit mbi njohjen, përdorimin dhe plotësimin e tij.

**Auditi Statistikor**

Mbështetur në pikën 3 të nenit 17 të ligjit për statistikat zyrtare, Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it mund të kryejë auditime statistikore tek prodhuesit e statistikave zyrtare, kur e gjykon të arsyeshme. Auditi statistikor është rruga konkrete për përmirësimin e cilësisë së një procesi apo produkti statistikor, nëpërmjet të cilit identifikohen pikat e forta dhe përmirësohen pikat e dobëta të komponentëve të tij. Auditimi është një proces sistematik, i programuar, i pavarur, i dokumentuar, me anë të të cilit bëhet një vlerësim objektiv i hapave të ndjekur gjatë një procesi statistikor. Me synimin për të rritur përmirësimin e cilësisë së proceseve statistikore, në vitin 2018 INSTAT nisi punën për kryerjen e auditit të proceseve statistikore. Hapat e implementuara ishin hartimi i pyetësorit, i cili do të jetë baza për auditim me intervistim dhe vetëvlerësim, hartimin e udhëzuesit të cilësisë dhe manualit të plotësimit.

**Raportet e Cilësisë**

INSTAT ka publikuar për përdoruesit Raportet e Cilësisë në nivelin e produkteve statistikore, ku në vitin 2018 janë publikuar 20 raporte në faqen e web-it me një rritje prej rreth 30% krahasuar me vitin 2017. Raportet e cilësisë përshkruajnë konceptet dhe metodologjitë statistikore të përdorura për mbledhjen dhe gjenerimin e statistikave zyrtare. Nëpërmjet tyre, përdoruesve u sigurohet informacion mbi format e standardet që përdor INSTAT në metodat dhe përkufizimet e aplikuara si dhe në cilësinë e rezultateve statistikore. Struktura e Raporteve të Cilësisë bazohet në konceptin e cilësisë së Sistemit Evropian të Statistikave (ESS) dhe në parimet lidhur me cilësinë e produkteve statistikore sipas Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane.

**Ngarkesa e të Intervistuarve**

Ngarkesa e të intervistuarve është koha dhe përpjekjet e të anketuearve për tju përgjigjur pyetësoreve të INSTAT në mënyrë të kënaqshme për një aktivitet statistikor. Në vitin 2018 janë anketuar në 16 vrojtimet pranë ndërmarrjeve rreth 21.752 ndërmarrje. Përgjatë vitit 2018 janë anketuar në 10 vrojtime pranë familjeve rreth 59.702 Njësi Ekonomike Familjare.

Statistikat pranë ndërmarrjeve dhe familjeve përdorin dy tregues për të vlerësuar ngarkesën e të intervistuarve (Response burden): numrin e pyetësorëve që ndërmarrjet/familjet duhet të përgjigjen si dhe kohëzgjatjen e intervistës.

Të gjitha anketat pranë ndërmarrjeve të realizuara nga INSTAT përgjatë vitit 2018 kanë si bazën e tyre të zgjedhjes Regjistrin Statistikor të Ndërmarrjeve. Shpërndarja e numrit të pyetësorëve sipas madhësisë së ndërmarrjes për vitin 2018, duke marrë në konsideratë gjithë vrojtimet pranë ndërmarrjeve ekonomike, që INSTAT realizon, jepet në tabelën e mëposhtme.

**Tabela 5: Shpërndarja e numrit të pyetësorëve sipas madhësisë së ndërmarrjes**

Madhësia e ndërmarrjes	0 pyetësorë	1_5 pyetësorë	6_10 pyetësorë	11+ pyetësorë
1_9 të punësuar	139.288	14.106	418	515
10_19 të punësuar	449	2.503	593	238
20_49 të punësuar	497	920	731	366
50+ të punësuar	466	255	309	798

Në vitin 2018, janë anketuar rreth 13,4 % e ndërmarrjeve nga 162.452 të regjistruara në vitin 2017. Janë intervistuar të paktën një herë gjatë vitit 21.752 ndërmarrje, nga të cilat 81,8 % e tyre kanë marrë pjesë vetëm në pesë ose më pak vrojtime, ndërsa 18,2 % e tyre kanë marrë pjesë në më shumë se 5 vrojtime të realizuar nga INSTAT, pranë ndërmarrjeve gjatë vitit 2018.

Shpërndarja e numrit të pyetësorëve sipas viteve nga 2018-2015, duke marrë në konsideratë gjithë vrojtimet pranë ndërmarrjeve ekonomike, që INSTAT realizon, jepet në tabelën e mëposhtme.

Tabela 6: Shpërndarja e numrit të pyetësorëve sipas viteve


Numri i ndërmarrjeve	Viti 2018	Viti 2017	Viti 2016	Viti 2015
Intervistuar të paktën një herë	21,752	24,025	20,615	19,007
0 pyetësorë	140,700	136,748	131,613	93,465
Gjithsej	162,452	160,773	152,228	111,472

Në lidhje me “Ngarkesën e të intervistuarve”, për indikatorin “Numrin e pyetësorëve që INSTAT i dërgon ndërmarrjeve për t’u përgjigjur” nuk mund të krahasohet me vitet e mëparshme, pasi ndryshon numri i aktiviteteve dhe frekuenca e tyre. Gjatë vitit 2018, INSTAT ka realizuar 16 vrojtme pranë ndërmarrjeve ndër të cilët 4 prej tyre janë vrojtme të reja me frekuencë vjetore.

Tabela 7: Përqindja e shpërndarjes së pyetësorëve sipas madhësisë së ndërmarrjes

Madhësia e ndërmarrjes	0 pyetësorë	1_5 pyetësorë	6_10 pyetësorë	11+ pyetësorë
50+ pun	25,5 %	13,9%	16,9 %	43,7%
20_49 pun	19,8 %	36,6 %	29,1 %	14,6 %
10_19 pun	11,9%	66,2 %	15,7 %	6,3 %
1_9 pun	90,3 %	9,1 %	0,3 %	0,3 %

Figura 1: Përqindja e shpërndarjes së pyetësorëve sipas madhësisë së ndërmarrjes



Në grupin e ndërmarrjeve të vogla (1-9 të punësuar), ku është i përqendruar numri më i madh i ndërmarrjeve të vendit, pjesa më e madhe e tyre rreth 90,3 %, nuk kanë për të plotësuar asnjë pyetësor, 9,1 % kanë për të plotësuar 1 deri në 5 pyetësorë dhe vetëm një pjesë shumë e vogël e tyre (më pak se 1 %) ngarkohen me mbi 5 pyetësorë. Siç shikohet nga grafiku, në grupin e ndërmarrjeve me 20 deri 49 të punësuar, 85,4 % e tyre ngarkohen deri në maksimumi 10 pyetësorë për t'u përgjigjur dhe vetëm 14,6 % e tyre ngarkohen me mbi 10 pyetësorë. Ngarkesa e përgjigjes është relativisht e lartë në grupin e ndërmarrjeve me 50 të punësuar e lart ku rreth 74,5 % e tyre duhet t'u përgjigjen të paktën 1 pyetësori.

Të gjitha anketat pranë familjeve të realizuara nga INSTAT përgjatë vitit 2018 kanë si bazën e tyre të zgjedhjes rezultatet e Censurit të Popullsisë dhe Banesave të vitit 2011. Në vitin 2018 janë anketuar rreth 6,5% Njësi Ekonomike Familjare (NjEF) nga 722.262 të regjistruara në Census. Janë intervistuar gjithsej 59.702 NJEF, nga të cilat 93,2% e tyre kanë marrë pjesë vetëm në një vrojtim, ndërsa 6,8 % e tyre kanë marrë pjesë në 2 ose më shumë vrojtime të realizuar nga INSTAT, pranë familjeve gjatë vitit 2018. Shpërndarja e numrit të vrojtimeve sipas qarqeve për vitin 2018, duke marrë në konsideratë të gjitha vrojtimit pranë familjeve që realizon INSTAT, jepet në tabelën e mëposhtme:

**Tabela 8: Shpërndarja e numrit të vrojtimeve sipas qarqeve**

Qarku	Asnjë vrojtim	Një vrojtim	Dy e më shumë vrojtime	Numri i NjEF për Qark
Berat	35,289	3,029	175	38,493
Dibër	26,955	2,453	165	29,573
Durrës	60,973	5,219	459	66,651
Elbasan	66,868	5,725	451	73,044
Fier	75,287	6,328	486	82,101
Gjirokastrë	19,208	1,854	199	21,261
Korçë	55,151	4,714	306	60,171
Kukës	15,387	1,599	140	17,126
Lezhë	29,318	2,670	249	32,237
Shkodër	49,798	4,317	312	54,427
Tiranë	181,515	13,845	857	196,217
Vlorë	46,811	3,904	246	50,961
Gjithsej	662,560	55,657	4,045	722,262

Gjatë vitit 2018, në qarkun e Tiranës janë intervistuar gjithsej 14.702 NJEF ose 24,6 % e tyre. Rreth 92,5 % e familjeve të qarkut Tiranë nuk kanë marrë pjesë në ndonjë vërtetim, 7,1 % e tyre kanë marrë pjesë në 1 vërtetim dhe vetëm 0,4 % e tyre kanë marrë pjesë në 2 ose më shumë vërtetime të realizuara nga INSTAT.


Shpërndarja e numrit të pyetësorëve sipas viteve nga 2018-2015, duke marrë në konsideratë gjithë vërtimet pranë njësisve ekonomike familjare, që INSTAT realizon, jepet në tabelën e mëposhtme:

**Tabela 9: Shpërndarja e numrit të pyetësorëve sipas viteve**

Numri i NJEF	Viti 2018	Viti 2017	Viti 2016	Viti 2015
Intervistuar të paktën një herë	59,702	46,940	40,804	20,104
0 pyetësorë	662,560	675,322	681,458	702,158
Gjithsej	722,262	722,262	722,262	722,262

Indikatori “Numri i pyetësorëve që INSTAT i dërgon familjeve për t’u përgjigjur” nuk mund të krahasohet me vitet e mëparshme pasi ndryshon numri i aktiviteteve dhe frekuenca e tyre. Gjatë vitit 2018, INSTAT ka realizuar 10 vërtetime pranë familjeve ndër të cilat 3 janë vërtetime të reja me frekuencë vjetore.

**Figura 2: Ngarkesa e përgjigjes për NJEF që janë përzgjedhur për t’u intervistuar gjatë vitit 2018**




Anketat e kryera pranë familjeve në Shqipëri kanë si karakteristikë faktin që mbledhin informacion mbi karakteristika të familjeve dhe individëve, që nuk gjenden në regjistra apo rekorde administrative. Si rrjedhim, përpjekjet për të ulur shkallën e ngarkesës janë fokusuar në lehtësitë që mund t'i krijohen familjeve, përsa i përket kuptueshmërisë dhe rëndësisë së informacionit, aplikimit të formave elektronike që shkurtojnë kohën dhe automatizojnë administrimin e intervistimit si dhe përpjekjeve për të regjistruar dhe para-printuar atë pjesë të informacionit, që mund të jetë i disponueshëm.

#### **Kohëzgjatja e intervistës mesatare në minuta**

Në lidhje me indikatorin e dytë kohëzgjatjen mesatare të intervistës për anketat pranë familjeve dhe ndërmarrjeve për vitin 2018, të dhënat jepen në figurën e mëposhtme.

**Figura 3: Kohëzgjatja e intervistës mesatare në minuta/ Pyetësorë**



Kohëzgjatja e intervistës është më shumë për anketat pranë familje mesatarisht rreth 40.47 minuta ndërsa për ato pranë ndërmarrjeve është 37.87 minuta.

INSTAT për të reduktuar ngarkesën e të intervistuarave punon vazhdimisht për të përmirësuar cilësinë e pyetësorëve, programeve të mbledhjes së të dhënave, manualeve dhe trajnimin e anketuesëve.

#### **Anketa mbi Kënaqësinë e Përdoruesve të INSTAT**

Anketa mbi Kënaqësinë e Përdoruesve të INSTAT është një mjet i rëndësishëm për të identifikuar nevojat e përdoruesve dhe adresuar reagimet e tyre aty ku është e mundur me procesin e planifikimit të statistikave zyrtare. Në Prill të vitit 2018, INSTAT zhvilloi raundin e dytë të Anketës së Kënaqësisë së Përdoruesve. Bazuar në gjetjet e vitit 2017, INSTAT mori masa përmirësuese, të cilat çuan në rritjen e treguesve të kënaqësisë.

Niveli i përgjithshëm i kënaqësisë së përdoruesve të INSTAT në vitin 2018 është rritur me 15,8 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë.




Një rritje e rëndësishme kundrejt vitit 2017 dallohet në indikatorin e kënaqësisë së cilësisë së të dhënave dhe shërbimeve që INSTAT ofron me 53,5 pikë përqindje.

Gjatë vitit 2018 kanë pësuar rritje edhe kënaqësia me faqen të internetit të INSTAT dhe kënaqësia me të dhënat përkatësisht me me 7,6 dhe 2,8 pikë përqindje.

Grafiku i mëposhtëm përshkruan krahasimin e nivelit të kënaqësisë gjatë dy anketave të fundit.

**Figura 4: Niveli i përgjithshëm i kënaqësisë sipas viteve 2017-2018**



## Komunikimi dhe Publikimet

Në vitin 2018, INSTAT, më mbështetjen e fondeve IPA, të Bashkimit Europian ka hartuar strategjinë e komunikimit dhe shpërndarjes së informacionit. Ky është një dokument bazë mbi të cilin Drejtoria e Komunikimit dhe Publikimeve ka hartuar planin e veprimit për implementimin e saj. Kjo strategji, do të shërbejë si dokument bazë në përmirësimin nivelit të komunikimit institucional, rritjen e marketingut të prodhimit statistikor si dhe rritjen e marrëdhënieve me përdoruesit apo të tjerë të interesuar në përmbushje të misionit të institucionit. Kjo strategji është bazuar në parimet themelore të Statistikave Evropiane dhe rekomandimeve ndërkombëtare, ku parimet që lidhen me komunikimin dhe shpërndarjen e statistikave zyrtare i mundësojnë të gjithë përdoruesve: akses të barabartë, publikim të njëkohshëm, publikim të të dhënave në të gjitha kanalet e shpërndarjes së informacionit statistikor, ruajtjen e konfidencialitetit statistikor, politikën e trajtimit të gabimeve, publikimin pa pagesë për të gjithë përdoruesit, mbajtjen në vëmendje të përmirësimit vizual të publikimeve të INSTAT si dhe plotësimin e kërkesave të përdoruesve për informacion statistikor, brenda dhe jashtë vendit.

### **Disa tregues të rritjes së vizibilitetit të INSTAT dhe rritjes së performancës së sektorit të Publikimeve dhe Shpërndarjes së Informacionit gjatë vitit 2018:**


- **PUBLIKIMET:** Gjatë vitit 2018, numri i publikimeve të INSTAT shkoi në 159, nga 137 që ishin në vitin 2017, duke u rritur me 22 publikime.
- **KËRKESAT E PËRDORUESVE:** Sa i takon kërkesave të përdoruesve, duke iu referuar databazës së kërkesave të përdoruesve, e cila është krijuar për here të parë në vitin 2009, nga viti në vit vihet re rritja e numrit të kërkesave të përdoruesve për të dhëna statistikor. Gjatë vitit 2018 vihet re një rritje e numrit të kërkesave nga përdoruesit në 1009 kërkesa nga 776 kërkesa që ka patur në vitin 2017 (233 kërkesa më shumë).
- **RRJETI SOCIAL FACEBOOK:** Gjatë vitit 2018, pëlqimet në faqen e Institutit të Statistikave arritën në 5.252 pëlqime nga 4.497 pëlqime në 2017. Ku numri më i madh u arrit gjatë muaji Dhjetor 2018.
- **VIZIBILITETI NË MEDIA:** Përmendja dhe citimi i INSTAT gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2018 është vërejtur gjithsej 3.686 herë (gjatë vitit 2017 numri i përmendjeve ishte 3.571 herë) në përmbajtjen e 2.121 artikujve të botuar në shtypin shqiptar, ndërkohë në faqet e para të gazetave dhe revistave të përditshme rezultojnë 64 përmendje. Në edicionet kryesore të lajmeve të 9 TV-ve kryesore shqiptare përmendja dhe citimi i INSTAT, është vërejtur gjithsej 627 herë në përmbajtjen e 389 kronikave të transmetuara në 9 TV kryesore.

Përmendja dhe citimi në portalet online është vërejtur 7,192 herë në përmbajtjen e 3,748 artikujve.

- **STATISTIKAT E WEBSITE:** Për vitin 2018 faqja web e INSTAT ka pasur 1.341.928 page views[1] nga 1.332.644 në vitin 2017 me një rritje prej 163.425 shikimesh, 0,70 %.


[1] Pageviews – Shikimi i faqeve është numri i përgjithshëm i faqeve të shikuara, këtu numërohen gjithashtu shikime

**Figura 5: Gjatë vitit 2018, janë publikuar 159 publikime, nga të cilat 12 të reja**



#### Librat

- Tregtia e Jashtme e Mallrave dhe Ndërmarrjet, 2018
- Burra dhe Gra në Shqipëri, 2018
- Tregu i Punës, 2016
- Regjistri i Ndërmarrjeve, 2017
- Burra dhe Gra në Shqipëri, 2017
- Turizmi në Shifra
- Shqipëria në Shifra, 2016
- Vjetari Statistikor Rajonal, 2012- 2016
- Vjetari Statistikor 2017
- Krimet dhe Drejtësia Penale, 2018
- Diaspora e Shqipërisë në Shifra, 2018
- Anketa Demografike e Shëndetit (ADSH), 2017 - 2018

**Vjetari Statistikor 2018**


Vjetari Statistikor 2018, vjen tek përdoruesit me një format të ri duke ndjekur shembullin dhe eksperiencën e vendeve evropiane. Kjo e bën këtë botim të krahasueshëm me vendet e tjera të Evropës, duke ndihmuar procesin e INSTAT për prodhimin e statistikave të krahasueshme. Qëllimi kryesor i Vjetarit është të sigurojë në një vëllim të vetëm një përmbledhje të plotë të statistikave sociale dhe ekonomike, për një periudhë të caktuar. Vjetari Statistikor, është një botim prej 172 faqesh, i ndarë në 20 kapituj të cilët përveç pjesës shkrimore dhe metodologjike, përmban tabela dhe grafikë, të cilët kanë objektiv të sigurojnë të dhëna dhe një përshkrim më të plotë të strukturave sociale dhe ekonomike.

**Statistikat e Krimeve dhe Drejtësisë Penale 2018**

Ky publikim paraqet raportin e parë të INSTAT mbi statistikën e krimeve dhe drejtësisë penale, duke u përqëndruar në sistemin e drejtësisë penale, Polici, Prokurori, Gjykatë dhe Burgje. Metoda të ndryshme mund të përdoren për të matur statistikën e krimit; të dhënat administrative janë qasja e përdorur në këtë publikim pasi INSTAT nuk ka kryer ende një studim mbi këto statistika. Raporti përfshin të dhëna për tre vitet e fundit 2015, 2016 dhe 2017. Qëllimi kryesor i publikimit është të paraqes një pasqyrë të hollësishme të sistemit të drejtësisë penale, duke përfshirë në të njëjtin publikim statistika për katër fazat, polici, prokurori, gjykatë dhe burgje. Publikimi është konceptuar në kapituj të veçantë sipas katër fazave të ndryshme të sistemit të drejtësisë penale.



### Diaspora e Shqipërisë në Shifra



Ky publikim kryhet për herë të parë nga INSTAT në kuadër të Strategjisë së Disaporës. Qëllimi i tij është vlerësimi i numrit të diasporës shqiptare dhe profilin e saj mbi karakteristikat bazë demografike dhe sociale. INSTAT do të vazhdojë bashkëpunimin me institucionet partnere të vendeve pritëse të diasporës shqiptare në vijim për të arritur në statistika edhe më gjithëpërfshirëse. Migrimi i shqiptarëve jashtë vendit nuk është një dukuri e re. Ajo është e dokumentuar të paktën që në shekujt e pesëmbëdhjetë dhe të gjashtëmbëdhjetë me largimin e një mase të madhe banorësh të trevave shqiptare. Ai vazhdon ende të

mbetet veprues dhe të japë impaktet e tij domethënëse si në aspektet demografike po ashtu edhe ato sociale dhe ekonomike të vendit.

### Turizmi në Shifra 2018

Instituti i Statistikave të Shqipërisë (INSTAT) në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, hartoi për herë të parë një publikim të veçantë për treguesit kryesorë mbi turizmin në Shqipëri. Duke iu referuar periudhës nga viti 2013-2017, statistikat në lidhje me turistët e huaj dhe vendas në Shqipëri synojnë të monitorojnë karakteristikat dhe zhvillimet e turizmit në vendin tonë. Në strategjinë e re të komunikimit, INSTAT është orientuar që të përmbushë nevojat e përdoruesve duke targetuar grupe të ndryshme përdoruesish. Materiali pasqyron disa nga kërkesat themelore dhe nevojat e disa grupeve të përdoruesve për të dhënat mbi turistët e huaj dhe vendas dhe ndikimin e tyre në ekonominë shqiptare.



### Regjistri i ndërmarrjeve

Statistikat zyrtare bazuar në regjistrin e ndërmarrjeve i shërbejnë të gjithë komunitetit të biznesit, politikëbërësve si edhe akademikëve për të analizuar situatën ekonomike në vend, për të ndërmarrë iniciativa e vendime të drejta dhe për të përmirësuar klimën dhe zhvillimin e bizneseve. Përpjekjet e INSTAT për të pasqyruar realitetin ekonomik në vend dhe angazhimi i tij për t’u përgjigjur kërkesave gjithnjë e në rritje të përdoruesve, kanë qenë maksimale, por nuk do të ishin të mjaftueshme pa vullnetin dhe dëshirën e mirë të ndërmarrjeve që i përgjigjen vrojtimeve të INSTAT-it.



### Shqipëria në Shifra



Pyjet, Transporti, Turizmi.

Shqipëria në Shifra paraqet në mënyre sintetike të dhëna statistikore për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të Shqipërisë. Botimi përmban 19 kapituj: Popullsia, Buxheti i Familjeve, Shëndetësia, Statistikat e Krimeve, Arsimi dhe Njohuritë, Kultura, Tregu i Punës, Çmimet, Llogaritë Kombëtare, Regjistri i Ndërmarrjeve, Tregtia e Jashtme, Teknologjia e Informacionit dhe Komunikacionit, Mjedisi – Mbetjet, Mjedisi, Peshkimi, Mjedisi – Biodiversitet, Bujqësia –

### Burra dhe Gra në Shqipëri, 2018



Kapitujt e përfshirë në botimin “Burra dhe Gra në Shqipëri, 2018”, pasqyrojnë fusha të ndryshme të të dhënave me bazë gjinore, të mbledhura si nga anketat e zhvilluara nga INSTAT si dhe nga informacioni që disponojnë institucionet e tjera shtetërore në vend. Statistikat dhe treguesit e prezantuar në këtë publikim do t’u shërbejnë politikëbërësve, botës akademike, shoqërisë civile dhe përdoruesve të ndryshëm për të analizuar në një kontekst të gjerë arritjet në drejtim të barazisë gjinore. Ky botim shoqërohet në faqen e INSTAT me një infografik dinamik i cili është i lehtë për

tu kuptuar nga të gjithë përdoruesit e statistikave gjinore dhe synon të krahasojë shifrat e burrave dhe grave në jetën e përditshme, nëpërmjet kombinimit të tekstit, grafikëve dhe tabelave.

### Vjetari Statistikor Rajonal

Instituti i Statistikave prezanton Vjetarin Statistikor Rajonal 2018. Vjetari Statistikor Rajonal është një instrument orientues për përdoruesin, duke ofruar një përmbledhje të plotë të statistikave rajonale në një vëllim të vetëm për vitin 2018. Ky votim vjen në një përmbledhje prej 163 faqesh të ndarë në 14 kapituj. Në 31 korrik 2014, me vendim të Parlamentit shqiptar u miratua organizimi i ri administrativoterritorial që e ndan vendin në 12 qarqe dhe 61 bashki me nëndarjet e parashikuara në Ligjin 115/2014 “Për ndarjen administrativo - territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”. Ligji i ri nuk bëri ndryshime lidhur me qarqet; numri i tyre mbeti 12. Risi e publikimit të vitit 2018 është kapitulli i parë ku paraqiten bashkitë në përbërje të qarqeve sipas ndarjes administrativo territoriale të vitit 2014. Ndërkohë që referuar ligjit 115/2014, vetë bashkitë ndahen në nënjësi më të vogla, të cilësuar si njësi administrative. Në përbërje të tyre janë edhe qytetet dhe fshatrat.




### Tregtia e Jashtme e mallrave dhe ndërmarrjet 2018



Statistikat e tregtisë së jashtme të mallrave janë një instrument shumë i rëndësishëm për marrësit e vendimeve në sektorët publik dhe privat. Ato ndihmojnë në përgatitjen e bisedimeve bilaterale dhe multilaterale në kuadrin e politikave tregtare dhe për vlerësimin e ekonomive të tregut. Ato ndihmojnë gjithashtu kompanitë në studimin e tregut dhe në përcaktimin e strategjive të tyre tregtare. Statistikat mbi tregtinë e mallrave përmbajnë të dhëna mbi eksportet/importet e mallrave në Shqipëri, si edhe statistika të tregtisë së mallrave sipas karakteristikave të ndërmarrjeve.

**Kërkesat e përdoruesve**


Databaza e përdoruesve u krijua për herë të parë në vitin 2009. Mbi bazën e kësaj databaze INSTAT përcakton dhe njihet më mirë me kërkesat dhe nevojat që kanë përdoruesit për statistika. Nëse i referohemi historikut të kësaj databaze, mund të themi që kërkesat e përdoruesve kanë pësuar një rritje të ndjeshme nga viti në vit, ndërsa në vitin 2016 pati një rënie të numrit të kërkesave nga përdoruesit nga 729 (2015) në 509 (2016). Gjatë vitit 2018 vihet re një rritje e numrit të kërkesave nga përdoruesit në 1009 kërkesa nga 776 kërkesa që ka patur në vitin 2017 (233 kërkesa më shumë).

**Figura 6: Numri i kërkesave të përdoruesve 2014 - 2018**

Duke e thelluar analizën e statistikave të plotësimit të kërkesave të përdoruesve, vërehet që numri i kërkesave të përdoruesve, në vitin 2018, është rritur, duke arritur shifrën 1009 kërkesa, nga 776 kërkesa në vitin 2017. Në vitin 2018 kemi një rritje të kërkesave me 30 %, kundrejt vitit 2017. Nëse do të bënim specifikimin e mëtejshëm të këtyre kërkesave mund të themi që numrin më të madh të tyre e zënë kërkesat e statistikave të çmimeve me 28.1 % të totalit të kërkesave, duke u pasuar nga kërkesat e statistikave sociale me 8.2 % të totalit të kërkesave, të dhëna nga statistika e tregtisë së jashtme me 6.8 % të totalit të kërkesave.



**Figura 7: Klasifikimi i numrit të kërkesave të përdoruesve sipas fushave specifike statistikore**




Numrin më të madh të kërkesave të plotësuara në vitin 2018 e zënë statistikat e çmimeve me 385 kërkesa, pasuar nga statistikat sociale me 83 si dhe statistikat e tregtisë së jashtme me 69 kërkesa, etj. Një pasqyrë më të hollësishme mund ta konsultoni në tabelën e mëposhtme:

**Tabela 10: Numri i kërkesave të përdoruesve sipas fushave specifike statistikore**


Lënda e Kërkesës	Numri i kërkesave ve 2017	Numri i kërkesave ve 2018	Ndryshimi në përqindje 2017 - 2018	Përqindja ndaj totalit 2018
Çmimet	298	385	29.2	28.1
Bujqësia	21	11	-47.6	1.09
Tregtia e jashtme	56	69	23.2	6.8
ASN	10	2	-8	0.01
Ndërmarrjet	20	31	55	3
Llogaritë kombëtare	32	43	34.4	4.2
Popullsia/lindjet-vdekjet/martesat/divorcet/emigracioni	77	83	7.7	8.2
Ndërtimi	11	4	-7	0.3
Shkaqet e vdekjeve /shendetesia	16	16	0	1.5
Punësimi/papunesia/pagat	43	49	13.9	4.8
Turizmi/transporti/aksidentet	43	30	-30.2	3
Konsumi i familjeve /niveli jeteses / shpenzimet e familjes	13	51	292.3	5.05
Të tjera/të ndryshme/Të dhëna të 2 ose më shumë fushave statistikore/ Pyetësor të ndryshëm	136	235	72.8	23.3
<b>Totali</b>	<b>776</b>	<b>1009</b>	<b>Rritje me 233 kërkesa</b>	<b>100</b>

**Rrjeti Social Facebook**

Gjatë vitit 2018, pëlqimet në faqen e Institutit të Statistikave arritën në 5.252 pëlqime nga 4.497 pëlqime në 2017. Ku numri më i madh u arrit gjatë muaji Dhjetor 2018.




Nga numri total i pëlqimeve, 57 % janë femra dhe 42 % janë meshkuj. Grup moshë me aktive në faqen e INSTAT është 25-34 vjeç, nga të cilët 31 % janë femra dhe 24 % janë meshkuj.



Shikueshmëria e positmeve gjatë vitit 2018 ka qenë 335.509, e cila e ndarë sipas periudhave katër mujore tregon periudhën me shikueshmëri më të lartë.

Janar-Prill – 93.840, Maj-Gusht – 104.724, Shtator-Dhjetor – 136.945.

Shikueshmëria më e lartë e faqes është në orën 21:00.



### Postimet

Numri total i postimeve nga data 1 Janar 2011 - 31 Dhjetor 2018 është 171 postime postime të cilat kanë arritur një shikueshmëri prej 335.509 personash me një mesatare 1.962 për çdo postim. Shikueshmëria e faqes ka kapur numrin më të madh në muajin Dhjetor 2018. Postimet në faqe janë të bazuara në kalendarin e eventeve të facebook (duke respektuar kalendarin e publikimeve të INSTAT), i cili përmban datat e daljes së publikimeve dhe eventeve të tjera të rëndësishme.

**Statuset të cilat kanë pasur shikueshmërinë më të lartë janë:**



Gezuar 1 Qeshorin

12.688 shikime

[https://www.facebook.com/permalink.php?story\\_fbid=1633487970067942&id=590804097669673](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=1633487970067942&id=590804097669673)

Statistika të Forta Lokale Shqiptare 8.656 shikime

<https://www.facebook.com/590804097669673/videos/1617824351634304/?v=1617824351634304>



Konferenca Ndërkombëtare mbi Sfidat e Migracionit 8.198 shikime

[https://www.facebook.com/permalink.php?story\\_fbid=1556470727769667&id=590804097669673](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=1556470727769667&id=590804097669673)



### Mbulimi mediatik

Përmendja dhe citimi i INSTAT gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2018 është vërejtur gjithsej 3.686 herë (gjatë vitit 2017 numri i përmendjeve ishte 3.571 herë) në përmbajtjen e 2.121 artikujve të botuar në shtypin shqiptar, ndërkohë në faqet e para të gazetave dhe revistave të përditshme rezultojnë 64 përmendje. Frekuenca më e lartë e përmendjeve është regjistruar në muajin Gusht dhe sasia më e lartë e përmendjeve vërehet në gazetat “Standard” dhe “Albanian Daily News”.

Në edicionet kryesore të lajmeve të 9 TV-ve kryesore shqiptare përmendja dhe citimi i INSTAT, është vërejtur gjithsej 627 herë në përmbajtjen e 389 kronikave të transmetuara në 9 TV kryesore. Frekuenca më e lartë e përmendjeve është regjistruar në muajin Maj dhe sasia më e madhe e përmendjeve vërehet në TV Scan.

Përmendja dhe citimi në portalet online është vërejtur 7,192 herë në përmbajtjen e 3,748 artikujve. Frekuenca më e lartë e përmendjeve është regjistruar në muajin Dhjetor

dhe sasia më e lartë e përmendjeve vërehet ne portalet “monitor.al”, “panorama.com.al” dhe “gazetatema.net”.

Gjatë vitit 2018, përmendja dhe citimi i INSTAT në web portalet e monitoruara është vërejtur 6.733 nga 3.676 që ishte një vit më parë, duke i renditur i dyti në rang institucionesh, pas Bashkisë së Tiranës.

**Tabela 11: Frekuenca krahasimore e përmendjes dhe citimeve të institucioneve shtetërore në web portalet e monitoruara**

Institucionet	2018	2017	2016
1. Bashkia Tiranë	6.975	7.140	1.840
2. INSTAT	6.773	3.676	1.784
3. Banka e Shqipërisë	5.939	2.682	1.066
4. MF	2.915	2.054	221
5. KM	2.294	1.331	118
6. Ministria e Bujqësisë	1.566	845	36

**Tabela 12: Shpërndarja kronologjike e përmendjes dhe citimeve të INSTAT sipas gazetave të monitoruara gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2018**

Date	Standard	Albanian Daily News	Revista Monitor	Telegraf	Dita	Tema	Sot	Shekulli	Gazeta 55	Gazeta Mapo	Tirana Times	Panorama	Gazeta Shqiptare	Shqiptarja	Ballkan	Koha Jonë	Integrimi	Rilindja Demokratike	Panorama Sport	Grand Total
Jan 2018	25	23	23	5	8	10	10	21	29	13	11	3	6	2	16	6	8	10	2	231
Feb 2018	66	19	32	15	18	36	38	23	42	10	15	14	11	12	33	9	18			411
Mar 2018	59	36	47	23	29	21	18	8	44	11	17	12	7	11	6	13	14			376
Apr 2018	25	29	33	12	16	6	12	8	24	11	14	9	4	8	9	3	6			229
May 2018	45	46	17	11	14	38	6	11	16	12	15	8	20	15	20	5	20	7		326
Jun 2018	44	43	29	11	35	20	15	17	21	11	16	23	7	14	9	11	21	3		350
Jul 2018	39	33	21	19	11	8	17	7	9	11	8	12	4	8	11	8	10			236
Aug 2018	3	34	34	48	50	38	43	19		34	2	26	35	21	20	28				435
Sep 2018	15	41	34	33	27	17	11	43		19	11	7	7	8		5				278
Oct 2018	48	31	35	37	20	29	14	5		11	14	4	13	8		7				276
Nov 2018	27	26	31	28	11	7	9	9		3	7	8	9	4		10				189
Dec 2018	47	32	46	58	31	13	28	26		5	20	8	8	17		10				349
Grand Total	443	393	382	300	270	243	221	197	185	151	150	134	131	128	124	115	97	20	2	3,686

Tabela 13: Shpërndarja sipas rubrikave e përmendjes dhe citimeve të INSTAT sipas gazetave të monitoruara gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2018

Rubrikat	Standard	Albanian Daily News	Revista Monitor	Telegraf	Dita	Tema	Sot	Shekulli	Gazeta 55	Gazeta Mapo	Tirana Times	Panorama	Gazeta Shqiptare	Shqiptarja	Ballkan	Koha Jonë	Integrimi	Rilindja Demokratike	Panorama Sport	Grand Total	
Dossier										1											1
Ekonomi - Economy	151	285	358	125	148	58	111	48	92	69	113	48	43	70	44	24	43	8			1,838
Kronikë - Chronicle	17				5	2	23	10	1	8	1	5		10	1	23		1			107
Kulturë - Culture	5	4	1	1			4	3	1	4	2	4	7	12	6	1					55
Miscellaneous	12	4		3	2	8		2	6	6	3	5	2		6		5				64
Ndërkombëtare			1			2				1		2				1					7
Politikë - Politics	39	33	2	47	24	43	46	29	26	22	5	23	9	10	9	28	13	2			410
Shëndeti - Health										1	1						1				3
Sociale - Social	219	67	20	124	91	130	36	104	58	41	20	49	70	26	58	38	35	9			1,195
Sport							1	1		2										2	6
Grand Total	443	393	382	300	270	243	221	197	185	151	150	134	131	128	124	115	97	20	2		3,686

Tabela 14: Parametra të artikujve ku përmendet INSTAT sipas gazetave të monitoruara gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2018

PRINT	Përmendje	Artikuj	Sipërfaqe publikimi
Albanian Daily News	393	235	45,714
Ballkan	124	78	21,118
Dita	270	151	49,887
Gazeta 55	185	98	31,201
Gazeta Mapo	151	78	29,926
Gazeta Shqiptare	131	82	27,457
Integrimi	97	77	26,442
Koha Jonë	115	78	21,654
Panorama	134	63	26,257
Panorama Sport	2	2	712
Revista Monitor	382	188	97,643
Rilindja Demokratike	20	17	4,524
Shekulli	197	119	19,955
Shqiptarja	128	73	19,542
Sot	221	131	18,080
Standard	443	232	77,354
Telegraf	300	176	71,281
Tema	243	138	43,485
Tirana Times	150	105	53,587
<b>Grand Total</b>	<b>3,686</b>	<b>2,121</b>	<b>685,819</b>

Tabela 15: Shpërndarja kronologjike e përmendjeve të INSTAT në faqet e para të gazetave gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2018

Date	Standard	Terna	Gazeta Mapo	Balkan	Gazeta 55	Panorama	Integrimi	Albanian Daily News	Tirana Times	Telegraf	Shekulli	Dita	Gazeta Shqiptare	Grand Total
Jan 2018		1	1	1										3
Feb 2018	3	1		1	5		1				1			12
Mar 2018	1					1		1						3
Apr 2018			1	1	1									3
May 2018	1	2	1	1			1	1		2				9
Jun 2018	1	1	1	1		1	3	1	2		1			12
Jul 2018						1								1
Aug 2018		1	2	1		1						1	1	7
Sep 2018	1	2				1		1						5
Oct 2018	2											1	1	4
Nov 2018	2													2
Dec 2018	1							1		1				3
Grand Total	12	8	6	6	6	5	5	4	3	3	2	2	2	64

Tabela 16: Shpërndarja kronologjike e përmendjeve dhe citimeve të INSTAT, sipas TV-ve për periudhën Janar-Dhjetor 2018

Date	TV SCAN	TV ORA NEWS	TV TOP CHANNEL	TV NEWS 24	TV KLAN	TV ABC News	TV VIZION +	TV A1 Report	Grand Total
Jan 2018	21	4	2	4	2	4			37
Feb 2018	38	4	4	4	7	1		1	59
Mar 2018	25	10	5	6	3	5	2		56
Apr 2018	13	4	3		4	2	2	4	32
May 2018	23	12	15	12	8	7			77
Jun 2018	35	10	5	8	2	1	8	5	74
Jul 2018	11	4	3	6		2	2		28
Aug 2018	23	8	2	5	1	1	3	7	50
Sep 2018	26	13	20	1	5	3	2	2	72
Oct 2018	13	14	4	8	6	1	10	2	58
Nov 2018	20	11	2		1	2	1		37
Dec 2018	24	4	3		6	4	2	4	47
Grand Total	272	98	68	54	45	33	32	25	627

Tabela 17: Frekuenca krahasimore e përmendjes dhe citimeve të institucioneve shtetërore në web portalet e monitoruara gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2018

Institucione	papornama.com.al	BalkanWeb	alb24.com	energjia.al	gazeta-shqipt.com	gazetatomar.net	lajmifunk.al	mapo.al	nga.al	opinion.al	shqipnews.com	tv4.al	abonnews.al	lapri.al	liveso.al	one news.tv	tyti.net	topshumet.tv	standard.al	gazetakspress.com	indexonline.net	monitor.al	newsboom.al	pamflet.net	shkulli.com.al	3gracia.al	lajmi.net	top.al	gazetaDio.al	kohaprin.com	rd.al	telegraf.al	Grand Total
BashkiaTiranes	721	413	186	2	692	653	180	527	202	124	770	29	240	28	448	309	6	462	113	11	4	25	165	67	60	171	6	65	85	94	16	21	6,975
INSTAT	564	350	261	29	264	512	269	422	111	203	416	12	79	53	369	253	8	207	298	18	37	632	122	360	158	273	80	196	40	77	29	71	6,773
Banka e Shqiperise	676	335	168	15	150	285	241	417	84	147	268	11	92	23	292	297	11	446	217	5	39	595	96	365	154	221	44	132	35	58	4	16	5,939
MF	279	102	59	41	119	167	98	147	19	77	265	4	25	9	111	93	2	82	105	2	54	248	56	195	148	129	100	109	13	29	9	19	2,915
IM	194	58	69	1	95	89	132	143	34	88	204	4	24	23	68	79	2	179	92	4	1	2	49	91	77	156	11	84	27	104	39	71	2,294
Ministria e Bujqesise	116	63	30	1	73	114	58	77	13	46	151	17	21	3	84	74	5	73	45	2	51	94	53	84	27	67	80	23	8	7	1	5	1,566
Grand Total	2,550	1,321	773	89	1,393	1,820	978	1,733	463	685	2,074	77	481	139	1,372	1,185	34	1,449	870	42	186	1,596	541	1,162	624	1,017	321	609	208	369	98	203	26,462

Statistikat e website të INSTAT

Për vitin 2018 faqja web e INSTAT ka pasur 1.341.928 page views[1] nga 1.332.644 në vitin 2017 me një rritje prej 163.425 shikimesh, 0,70 %.

Të gjitha temat kryesore të faqes së INSTAT paraqiten me rritje, në tabelen më poshtë janë të renditura për nga numri i shikimi dhe nryshimi në përqindje nga 2017 në 2018.

<sup>1</sup>Pageviews – Shikimi i faqeve është numri i përgjithshëm i faqeve të shikuara, këtu numërohen gjithashtu shikime

Tabela 18: Page views sipas temave kryesore 2017 - 2018

Tema	Total 2017	Total 2018	Ndryshimi në %
Shkencë Teknologji dhe Shoqëria	972	5.189	197,8
Çmimet	6.202	41.263	147,7
Bujqësia dhe Peshkimi	3.418	18.800	138,4
Statistikat e Përgjithshme dhe Rajonale	2.612	13.961	136,9
Tregtia e Jashtme	3.357	17.891	136,8
Kushtet Sociale	5.105	25.463	133,1
Tregu I Punës dhe Arsimi	14.266	61.446	124,0
Censet	3.697	14.936	120,6
Mjedis dhe Energjia	5.053	11.921	80,9
Industria Tregtia dhe Shërbimet	29.469	68.291	79,5
Ekonomi dhe Financë	73.165	79.014	79,0
Treguesit Demografikë dhe Socialë	64.233	100.697	44,2



## **Marrëdhëniet me jashtë dhe Integrimi Evropian**

---

INSTAT u krijua si institucion i mirëfilltë statistikor në vitin 1993, në periudhën kur populli shqiptar dhe institucionet që e përfaqësojnë synonin krijimin e sistemit pluralist dhe demokratik, të ngjashëm me vendet e tjera të Evropës Perëndimore. Ligji i vitit 1993 për statistikat zyrtare ishte hapi i parë në këtë drejtim për ndërtimin e infrastrukturës institucionale të prodhimit statistikor.

Në vitin 2004, në kohën kur Komisioni Evropian kishte dhënë rekomandimin për hapjen e negociatave për nënshkrimin e MSA-së dhe ishin hapur zyrtarisht bisedimet për nënshkrimin e saj, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin e ri për statistikat zyrtare, duke e pozicionuar INSTAT si institucionin kryesor statistikor në vend si dhe duke vendosur standarde të reja në lidhje me respektimin e parimeve statistikore, proceset e programimit e raportimit si dhe organet drejtuese e raportuese të performancës së tij.

Në kohën e nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA), në vitin 2006, Kuvendi i Shqipërisë miratoi Programin e Statistikave Zyrtare për periudhën 2007-2011, dokumenti i parë i këtij lloji i cili parashikonte veprimtarinë zhvillimore të statistikave zyrtare në terma afatgjata, si dhe angazhimin e përgjegjësitetë e të gjitha institucioneve publike të përfshira, prodhuese apo ofruese të të dhënave.

Neni 88 i MSA-së shpreh vullnetin e palëve për bashkëpunim statistikor me qëllim që të ndërtohet një system i qëndrueshëm statistikor, i aftë të prodhojë të dhëna objektive dhe të sakta për të matur performancën e shtetit shqiptar dhe ecurinë e reformave të ndërmarra. Gjithashtu, në këtë nen shprehet angazhimi për ngritjen e një sistemi që respekton parimet themelore të statistikave të Kombeve të Bashkuara, Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane dhe që zhvillohet drejt standardeve të Acquis Communautaire.

Në kuadër të integritit, INSTAT, si institucioni përgjegjës për Kapitullin 18, ka ndërmarrë hapa konkretë drejt përafrimit të acquis që përfshihen në këtë kapitull. Për arritjen e suksesshme në këtë drejtim, INSTAT dhe shteti shqiptar në tërësinë e tij, ka gjetur mbështetjen dhe bashkëpunimin domethënës nga Eurostat dhe institucionet e tjera kombëtare statistikore të vendeve anëtare. Bashkëpunimi është konkretizuar kryesisht në fushën e monitorimit të ecurisë së zhvillimit statistikor nëpërmjet proceseve vlerësuese Peer Review, Sectoral Peer Review, dhënies së rekomandimeve periodike të Komisionit Evropian, mbështetjes për aktivitete të vecanta statistikore nëpërmjet projekteve CARDS dhe IPA, etj.

Nga memonti i hyrjes në fuqi të MSA-së, janë përmbushur një sërë rekomandimesh të Komisionit Evropian dhe Eurostatit, ku më kryesoret janë ndërhyrjet që duhet të bëjë shteti shqiptar për forcimin e pavarësisë profesionale të stafit të INSTAT dhe agjencive të tjera statistikore, emërimin e drejtorit të Përgjithshëm nëpërmjet procedurave publike, transparente e profesionale, rritjen e hierarkisë institucionale të INSTAT për pagesa motivuese dhe autonomi në menaxhimin e burimeve si dhe prodhimin e statistikave zyrtare sipas standardeve të rekomanduara. Në këtë kuadër, Ligji nr. 17/2018 “Për statistikave zyrtare” mundëson përafrimin e plotë me standardet kryesore që përcakton Rregullorja (KE) 223/2009, e ndryshuar, në lidhje me:

- Parashikimin e parimeve statistikore në përputhje me atë të Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane;
- Ngritjen e institucionit të Drejtorit të Përgjithshëm si personi përfaqësues i Sistemit Kombëtar Statistikor, pavarësia profesionale e të cilit garantohej me ligj;
- Caktimin e Drejtorit të Përgjithshëm si personi i vetëm përgjegjës për të vendosur mbi proceset, metodat, procedurat dhe standardet e prodhimit të statistikave nga INSTAT si dhe për të nxjerrë udhëzime për zbatimin e parimeve të statistikave zyrtare nga prodhuesit e sistemit;
- Përcaktimin e standardeve për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm nëpërmjet procedurave transparente, të pazuara në kritere profesionale;
- Ndërtimin e një marrëdhënie efikase ndërmjet INSTAT dhe Bankës së Shqipërisë për të respektuar statusin e vecantë ligjor në lidhje me pavarësinë institucionale;
- Forcimin e mandatit të prodhuesve të statistikave zyrtare për të drejtën e hyrjes në të dhënat administrative;
- Hartimin e Programit të Statistikave Zyrtare në terma afatgjata, duke parashikuar objektivat strategjike të zhvillimit statistikor;
- Hartimin e Planit Vjetor për zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare;
- Sigurimin e parimit të konfidencialitetit statistikor.

Përveç angazhimit për përmbushjen e detyrimeve si institucioni përgjegjës për Kapitullin 18, INSTAT është angazhuar gjithashtu edhe në furnizimin me informacionin e duhur statistikor të të gjithë kapitujve të tjerë të acquis. Pë këtë qëllim, cdo grup ndërinstitucional ka në përbërje të tij edhe një përfaqësues të INSTAT-it, sipas fushës përkatëse.

## Zbatimi i rekomandimeve

### Progres Raporti për Shqipërinë 2018

INSTAT është përgjegjës për kapitullin 18 "Statistikat. Kapitull, i cili paraqet Acquis të BE-së në fushën e statistikave që zbatohen nga çdo aktor i përfshirë në Sistemin Kombëtar të Statistikave në Shqipëri me qëllim përmirësimin e infrastrukturës statistikore të bazuar në parime si paanshmëria, besueshmëria, transparenca, ruajtja e konfidencialitetit të të dhënave individuale dhe shpërndarjen e statistikave zyrtare.

Progres raporti 2018, i Komisionit Evropian për Shqipërinë, nënvizon që Shqipëria është e përgatitur mesatarisht për statistikën. Ky raport thekson që ka patur një përparim në shumë fusha statistikore si rrjedhim dhe i miratimit të Programin Zyrtar të Statistikave për vitet 2017-2021, por kërkohet përgatitja e një buxheti dhe plan veprimi të detajuar për zbatimin e këtij programi. Instituti i Statistikave (INSTAT) ka nënshkruar disa memorandume mirëkuptimi me agjenci të ndryshme statistikore. Megjithatë, ekziston nevoja për një përdorim më të madh të të dhënave administrative.

Ndërkohë, Bashkimi Evropian rekomandon vazhdimin e përpjekjeve për përmirësimin e statistikave zyrtare, vecanërisht në fushën e statistikave makroekonomike dhe bujqësore, harmonizimin e mëtejshëm të statistikave makroekonomike me standardin ESA 2010 dhe kërkon të paraqitet një informacion më i plotë i procedurës së deficitit të tepruar.

Rregullat e Bashkimit Evropian për Statistikat, kërkojnë që Shtetet Anëtare të jenë në gjendje të prodhojnë statistika bazuar në pavarësinë profesionale, paanshmërinë, besueshmërinë, transparencën dhe konfidencialitetin.

Si rekomandime për ardhmen, raporti thekson që Shqipëria duhet të fokusohet në veçanti në fushat në vijim:

- **të vazhdojë të forcojë burimet e INSTAT, duke përshtatur strukturat e pagave dhe postat e nëpunësve civilë;** dhe
- **të miratojë ligjin e ri të statistikave dhe të bëjë më shumë përpjekje në zbatimin e legjisllacionit ekzistues (siç është programi i ri statistikor zyrtar);**

Për këtë rekomandime, përveç miratimit të Ligjit të ri për Statistikat Zyrtare nr. 17/2018, në lidhje me infrastrukturën, hap domethënës është edhe pozicionimi i INSTAT në shkallën më të lartë të hierarkisë institucionale, si institucion publik i pavarur i cili i raporton, por edhe duke ndikuar drejtpërdrejtë në rritjen e pagave të punonjësve të tij

- **harmonizim të mëtejshëm të statistikave makroekonomike me ESA 2010 dhe rritjen e plotshmërisë së tabelave së tepricës së deficitit të tejkuluar (EDP).**

Përsa i takon ESA 2010, gjatë viteve të fundit INSTAT ka bërë përmirësime të konsiderueshme në zbatimin e këtij standardi. INSTAT ka përditësuar përshkrimin e burimeve dhe metodave të përdorura aktualisht për përpilimin e llogarive kombëtare. Ndërkohë do të vazhdohet puna për përmirësimin e pajtueshmërisë së këtij standardi duke përdorur burime të reja të të dhënave, përmirësimin e metodologjisë dhe shtrirjen e tabelave të transmetuara sipas Programit të Transmisionit ESA2010. INSTAT gjithashtu do të përditësojë rregullisht dhe do të shtrijë përshkrimin e burimeve dhe metodave të përdorura për përpilimin e llogarive Kombëtare duke bashkëpunuar ngushtësisht me agjencitë e tjera statistikore.

### **Vlerësimi i Sistemit Kombëtar Statistikor “Peer Review” 2018**

Gjatë periudhës 4 – 8 Qershor 2018, Eurostat kreu në Shqipëri një mision vlerësimi “Peer Review”, i cili kishte për qëllim të vlerësonte funksionimin e SKS dhe zbatimin e parimeve të Kodit të Praktikës të Statistikave Evropiane, të përafëruara edhe me ligjin shqiptar për statistikën zyrtare. Vlerësimi “Peer Review”, është një shqyrtim i hollësishëm i performancës së sistemit statistikor të një vendi dhe kryhet si për vendet anëtare të BE-së ashtu edhe për vendet kandidatë dhe potencialisht kandidatë për integrim. Procesi përfundoi me hartimin dhe publikimin e një raporti në muajin Nëntor. Raporti vlerësues përmban 24 rekomandime për institucionet e përfshira, shoqëruar edhe me aktivitetet përmirësuese në terma afat-shkurtër, afat-mesme dhe afat-gjata. Aktivitetet përmirësuese janë përfshirë në Planin Vjetor 2019 për zbatimin e PSZ 2017-2021 si dhe Planin Operacional të INSTAT-it 2019.

Rekomandimet e dala nga raporti i vlerësimit, janë të grupuara në tre drejtime kryesore:

#### *1. Forcimin e infrastrukturës institucionale*

Për këtë aspekt janë dhënë 9 rekomandime kryesisht për zgjerimin e llojeve të statistikave zyrtare, shtimin e institucioneve që merren me prodhimin statistikor zyrtar, ngritjen e komitetit të prodhuesve të statistikave zyrtare, koordinimin e punës për përgatitjen e planit vjetor dhe sigurimin e konfidencialitetit statistikor.

Për realizimin e këtyre rekomandimeve, INSTAT ka planifikuar për vitin 2019 këto aktivitete kryesore:

- Hartimin e listës së burimeve administrative që posedojnë institucionet publike;
- Përgatitjen e listës së institucioneve që mund të konsiderohen si prodhues potencialë të statistikave zyrtare;

- Ndryshimin e Programit të Statistikave Zyrtare sipas standardeve të reja të përcaktuara në ligjin e ri për statistikat zyrtare;
- Krijimin e Komitetit të Prodhuesve të statistikave zyrtare;
- Ngritjen e një portali të përbashkët për publikimin e të dhënave statistikore zyrtare;
- Përgatitjen e Planit Vjetor 2019 për zbatimin e PSZ;
- Ngritjen e Komitetit të Konfidencialitetit;
- Bashkëpunimin me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave dhe Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për të harmonizuar kuadrin ligjor që rregullon mënyrën e ruajtjes së të dhënave që përdoren për qëllime statistikore.

### *2. Zhvillimin e mëtejshëm të menaxhimit të cilësisë dhe përmirësimin e kosto-efektivitetit.*

Në lidhje me këtë aspekt janë dhënë 8 rekomandime, ku mund të veçohen ato që kanë të bëjnë me zhvillimin e teknikave elektronike për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, përdorimin e metodave të reja të mbledhjes së të dhënave, duke përfshirë edhe rrugën postare, zbatimin e standardit GSBPM, monitorimin e kohës së përpunimit të një produkti të caktuar statistikor dhe hartimin e raporteve në lidhje me të, matjen sistematike të ngarkesë së publikut në dhënie e informacionit, etj.

Për realizimin e këtyre rekomandimeve, për vitin 2019 INSTAT ka planifikuar:

- Të pilotojë teknika të reja për mbledhjen e të dhënave me qëllim reduktimin e kohës dhe koston së këtij procesi;
- Të intensifikojë marrëdhëniet me shërbimin postar për marrjen e informacionit dhe rregullimin e sistemit të adresave;
- Të bashkëpunojë me Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë për të harmonizuar sistemet elektronike financiare në interes të shkëmbimit të duhur të informacionit;
- Të hartojë udhëzime metodologjike për të gjitha proceset statistikore;
- Kryerja e disa auditimeve pilote për vlerësimin e cilësisë statistikore;
- Ngritja dhe testimi i sistemit të matjes së kohës së dedikuar për produktet statistikore.

### *3. Përmirësimi i komunikimit me përdoruesit dhe aktorë të tjerë*

Përdoruesit e statistikave zyrtare janë konsideruar si grupi kryesor dhe më i rëndësishëm, duke qenë se janë të interesuar drejtpërdrejtë për sasinë dhe cilësinë e

statistikave zyrtare. Për këtë kategori, ekipi vlerësues Peer Review ka dhënë 4 rekomandime, kryesisht për shfaqjen e veprimtarisë së Këshillit të Statistikave, duke publikuar çdo informacion që ka lidhje me të, ngritjen e Grupit të Përdoruesve për fushat statistikore, intensifikimin e komunikimit me median dhe botën akademike.

Për të realizuar këto rekomandime, gjatë vitit 2019 INSTAT do të publikojë në faqen elektronike dokumentacionin e prodhuar nga Këshilli i Statistikave (agjendën, çështjet e shqyrtuara, raportet etj.), do të ngrijë grupe të reja me përdorues të kategorive të ndryshme statistikore, do të rrisë komunikimin me botën akademike dhe universitetet nëpërmjet nënshkrimit të memorandumeve, përfshirjes së profesorit dhe studentëve në veprimtaritë kërkimore, zhvillimin e praktikave profesionale etj.

Raporti i vlerësimit Peer Review për Shqipërinë është publikuar nga INSTAT si dhe në faqen zyrtare të Eurostat:

<https://ec.europa.eu/eurostat/documents/45004/6182541/Peer+review+report+Albania2018.pdf/ffc06530-0905-4ed8-9db0-e832490029ed>

Raporti cilëson pozitivisht në mënyrë të veçantë ligjin e statistikave zyrtare, si hapin e parë dhe domethënës drejt forcimit të SKS me qëllim prodhimin e statistikave zyrtare në mënyrë profesionale, transparente dhe të besueshme.

Rekomandimet e dhëna nga Bashkimi Evropian, por edhe kërkesat e tjera të reflektuara nga Eurostat nëpërmjet raporteve periodike vlerësuese janë shndërruar nga INSTAT në aktivitete zbatuese, të pasqyruara jo vetëm në Planin Operacional 2019, por edhe në Planin Vjetor 2019 për zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare, miratuar rishtazi nga Kuvendi i Shqipërisë.

Në kuadër të çeljes së negociatave, INSTAT kontribuoi me ekspertizën e tij në punën “Për hartimin e raportit statistikor për 5 prioritetet”, material i cili është tashmë pjesë e dosjes së fushatës për mbështjen e hapjes së negociatave. Gjithashtu INSTAT, kishte rolin e shkruarit të raportit dhe mbikqyrësit të integritetit të të dhënave statistikore.

Në bazë të 5 prioritetëve, vitin e kaluar INSTAT ishte pjesë e grupit kryesor dhe të 6 nën-grupeve të punës.

Të udhëhequr nga objektivi strategjik “Fuqizimi i rolit të INSTAT si një pjesëtar aktiv në sistemin statistikor në vend, në rajon dhe në arenën ndërkombëtare”, vitin e kaluar INSTAT është angazhuar në paraqitjen e raporteve, mendimeve e studimeve në arenën ndërkombëtare në fushën e prodhimit dhe zhvillimit statistikor.

Në lidhje me këtë, vlen të theksohet se INSTAT ka mbajtur komunikime të vazhdueshme me Eurostat, organizata ndërkombëtare si UN, UNECE, EFTA, OECD si dhe institucione

ndërkombëtare homologe mbi mbështetjen dhe monitorimin e aktivitete të ndryshme statistikore, në kuadër të zhvillimeve të reja dhe me të fundit në fushën e statistikave.

Kështu, në Komisionin Statistikor të Kombeve të Bashkuara organizuar në muajin Mars 2018, Drejtori i Përgjithshëm, ka mbajtur fjalën dhe pasqyruar qëndrimin e INSTAT në lidhje me përmirësimin e cilësisë statistikore.

INSTAT organizoi për herë të parë seminarin “Përcjellja më tej e mesazhit: Reflektime strategjike për modernizimin e komunikimit statistikor”, organizuar në datat 18-21 Qershor 2018, në Kombet e Bashkuara në Gjenevë në Konferencën e Statisticienëve Evropianë. Ky seminar u konsiderua shumë i suksesshëm nga pjesëmarrësit dhe nga votimet e kryera në fund të aktivitetit. Gjithashtu si ndjekje e rekomandimeve të nxjerra nga seminari dhe si vlerësim për organizimin me sukses të tij, Znj. Ibrahimaj u ftua në Byronë e Konferencës së Statisticienëve Evropianë, si një risi duke qënë se ky takim është vetëm për anëtarët e Byrosë.

Me datë 4 Korrik 2018, Znj. Delina Ibrahimaj, priti në një takim pune Znj. Lidia Bratanova, Drejtore e Divizionit të Statistikave të Komisionit Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për Evropën, UNECE si dhe Z. Steven Vale, Statisticien i Lartë, Këshilltar për Rajonin i Komisionit Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për Evropën UNECE ku diskutuan mundësitë e mëtejshme të bashkëpunimit midis INSTAT dhe UNECE.

Në datat 5-6 Korrik INSTAT organizoi Seminarin Strategjik mbi Menaxhimin , në bashkëpunim me EFTAn dhe Eurostat, me fokus në të dhënat administrative dhe regjistrat. Në këtë seminar morën pjesë vendet e rajonit si dhe shtetet e Partneriteti Lindor, Armenia, Azerbajxhani, Bjellorusia, Gjeorgjia, Moldavia dhe Ukraina.

Në datat 21-24 Tetor 2018, në Dubai, Emiratet e Bashkuara Arabe u organizua “Forum i dytë i Kombeve të Bashkuara Botërore të të Dhënave si dhe Grupi i Punës Botëror i Big Data-ve” ku INSTAT mori pjesë në panelin “ Ndërtimi i besimit në të dhëna dhe statistika” dhe në panelin “Ta masim të pa-matshmen-Të dhëna të reja për informacionin në treguesit e SDG Tier III”

Ndër synimet kryesore të INSTAT për vitin 2019, në lidhje Integrimin Evropian është të mbajë në menyrë të vazhdueshme kontaktet me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Eurostat, institucionet homologe, institucione të tjera dhe organizatat ndërkombëtare me të cilat INSTAT bashkëpunon dhe me njësitë e Integritimit Evropian në ministritë e linjës. Ky sektor gjithashtu kujdeset për pritjet protokollare, organizimin e aktiviteteve të ndryshme brenda dhe jashtë vendit si seminare, konferenca etj. Kryen përkthimet e nevojshme që kërkohen nga institucioni.

**Koordinimi i Projekteve**

Bashkëpunimi statistikor ndërkombëtar synon krahasueshmërinë e statistikave zyrtare me standardet e Bashkimit Evropian dhe Kombeve të Bashkuara. Qëllimi i bashkëpunimit statistikor ndërkombëtar është të forcojë Sistemin Statistikor Kombëtar duke përshtatur metodologjinë dhe praktikat me Acquis dhe duke i integruar ato në Sistemin Evropian të Statistikave. Bashkëpunimi ndërkombëtar i statistikave gjithashtu siguron mbështetje dhe asistencë në ndërtimin e kapaciteteve duke ndikuar në rritjen profesionale.

Një pjesë e konsiderueshme e zhvillimit të statistikave zyrtare është realizuar në kuadër të bashkëpunimit dhe mbështetjes së ofruar nga organizatat ndërkombëtare dhe organizatat kombëtare statistikore të vendeve anëtare. Pjesa më e madhe e mbështetjes është ofruar nga asistenca e Bashkimit Evropian (BE), Sida (Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar), Kombet e Bashkuara (UN), Zyra e Bashkëpunimit Zviceran për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) në bashkëpunim me Zyrën Federale të Statistikave (FSO), si dhe Banka Botërore (BB). Në vijim paraqitet informacion më i detajuar në lidhje me natyrën e mbështetjes.

Projektet me financime të ndryshme, të zbatuara në INSTAT gjatë vitit 2018, janë si më poshtë:

**1. Programi kombëtar IPA 2013**

Projekti kishte si qëllim kryesor kontribuimin në përmirësimin e qeverisjes dhe përgjegjshmërisë nëpërmjet politikave socio-ekonomike, me një qasje më të mirë në statistika cilësore të përafuara me legjislacionin Evropian. Nëpërmjet këtij projekti u arrit ristrukturimi dhe përmirësimi i proceseve statistikore, rritja e kapaciteteve në prodhimin dhe përdorimit të statistikave të bujqësisë dhe të forcave të punës, zhvillimi i një sistemi qendror Data Warehouse, si dhe përmirësimi i funksioneve komunikuese dhe rolit të INSTAT si koordina i Sistemit Kombëtar Statistikor.

**2. Programi IPA Shumë-përfitues**

Programi IPA Shumë-përfitues siguron mbështetje dhe asistencë në ngritjen e kapaciteteve dhe rritjen e ekspertizës institucionale përmes pjesëmarrjes në kurset e trajnimeve dhe trajnimet afatgjata për periudhën 3 - 5 mujore në Institucionet Kombëtare të vendeve anëtare dhe në Eurostat, pjesëmarrja në takimet dhe grupet punës të Sistemit Statistikor Evropian

Objektivi i përgjithshëm i programit është përgatitja e autoriteteve statistikore në vendet përfituese të cilat synojnë anëtarësimin në BE, duke përshtatur metodologjitë dhe



praktikat e tyre me *acquis* dhe duke i integruar ato në Sistemin Evropian të Statistikave. Në këtë kuadër synohet të përmirësohet disponueshmëria dhe cilësia e të dhënave statistikore në vendet përfituese, veçanërisht në fushat kryesore si: statistikat makroekonomike, statistikat e bujqësisë, statistikat sociale, statistika e ndërmarrjeve etj.

### **3. Partneriteti për statistikat Faza e 5-të, Sida**

Gjatë vitit 2018, ka qenë në zbatim faza e pestë e bashkëpunimit midis SCB dhe INSTAT. Fushat prioritare të asistencës teknike gjatë gjithë fazës së projektit përfshijnë Menaxhimin, Metodologjinë dhe Prodhimin Statistikor, Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit, ofrimin të ekspertizës pranë INSTAT etj. Kjo fazë e asistencës përfshin periudhën prej Janarit të vitit 2018 deri në Dhjetor të 2020. Me qëllim zbatimin, monitorimin dhe raportimin me sukses të zbatimit të aktiviteteve, INSTAT ka ngritur grupin e punës, i cili në bashkëpunim me konsulentin e përhershëm të Sida ndjek realizimin e aktiviteteve sipas planit të përcaktuar në dokumentin e projektit. Një ndër mjetet që shërbejnë për monitorimin e projektit janë dhe mbledhjet mujore të grupit të punës, i cili raporton tek Drejtori i Përgjithshëm mbi ecurinë e projektit.

### **4. Financim i drejtpërdrejtë në INSTAT për prokurimin e pajisjeve të IT-së dhe ngritjen e një qendre trajnimi**

Gjithashtu, INSTAT ka përfituar nga Sida edhe një projekt me përgjegjësi të plotë të menaxhimit të fondeve nga vetë INSTAT që ka mbuluar financiarisht prokurimin e pajisjeve të IT-së dhe ngritjen e një qendre trajnimi. Objektivi kryesor është modernizimi i platformës ekzistuese të infrastrukturës dhe krijimi i një qendre trajnimi.

### **5. Rritja e Kapaciteteve të Inovacionit për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM – SMEI).**

INSTAT është aktualisht në fazën e zbatimit të projektit "Rritja e Kapaciteteve të Inovacionit për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme". Kontrata ndërmjet Autoritetit Menaxhues (Greqi) dhe Shoqatës Kombëtare të Bizneseve të Vogla dhe të Mesme (Bullgari) është nënshkruar më 01.08.2017, me një kohëzgjatje prej 24 muajsh. Në këtë projekt, INSTAT ka rolin e partnerit të projektit dhe i gjithë komunikimi bëhet përmes partnerit kryesor Shoqatës Kombëtare të Bizneseve të Vogla dhe të Mesme, Bullgari.

Objektivi kryesor i këtij projekti është të rrisë kapacitetin ndërkombëtar të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM) dhe t'i mbështesë ato në krijimin e një rrjeti të qëndrueshëm, duke përfshirë grupe inovative me NVM të tjera nga rajoni për të ndarë njohuritë dhe zhvillimin e inovacioneve.

**6. Projekti SALSTAT**

SALSTAT-i është pjesë e programit “Bashki të Forta” financuar nga Zyra e Bashkëpunimit Zvicerian për Zhvillim për periudhën Qershor 2017-Maj 2024. SALSTAT-i menaxhohet nga Zyra Statistike Federale Zviceriane dhe INSTAT në bashkëpunim me SDC.

Qëllimi kryesor i SALSTAT është vlerësimi i mundësive për të përmirësuar disponueshmërinë e statistikave në nivel lokal dhe rajonal. SALSTAT është bazuar në reformën Territoriale dhe Administrative (TAR) 2015. Projekti synon të krijojë një sistem statistikor (të dhëna dhe tregues) në nivel rajonal dhe lokal, veçanërisht për statistikat demografike dhe sociale. Vlerësimi përfshin gjithashtu kushtet për krijimin e mundshëm të Regjistrit Statistikor të Popullsisë, si dhe Regjistrin të Ndërtesave dhe Banesave në terma afatgjatë.

Gjatë incepton phase Janar- Gusht 2018 në kuadër të projektit SALSTAT është zhvilluar pyetësi i bashkive dhe i institucioneve. Eshtë zhvilluar konferenca për prezantimin e projektit SALSTAT dhe përgatitja për fazën e implementimit. Gjatë 2018 gjithashtu është nënshkruar dhe marrëveshja për fazën e implementimit të projektit, si edhe janë zhvilluar dhe dy ekspertiza për sektorin e GIS dhe metodologjisë. Janë zhvilluar takime koordinimi në ambjentet e INSTAT me donator që mbështetin INSTAT dhe takime teknike me Bashkitë Forta (HELVETAS). Për të ndjekur ecurinë e punës janë zhvilluar dhe takime javore me komponentet lider për aktivitetet e projektit SALSTAT.

**7. Projekti “Krijimi i një Strategjie për Zhvillimin e Sistemit Kombëtar Statistikor në Shqipëri”**

INSTAT është përfitues i projektit “Krijimi i një Strategjie për Zhvillimin e Sistemit Kombëtar Statistikor në Shqipëri”, financuar nga Banka Botërore. CFCU në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë është përgjegjës për aspektet financiare, kurse INSTAT është përgjegjës për zbatimin e projektit nga ana teknike.

Qëllimi i grantit është që të mbështesë INSTAT në përgatitjen e një strategjie kombëtare për zhvillimin e Sistemit Kombëtar Statistikor për vitet 2019-2030, zhvillimin e planeve të veprimit afatmesëm dhe ngritjen e kapaciteteve të stafit të INSTAT-it për zbatimin e strategjisë.

Gjatë vitit 2018, janë përgatitur dokumentat e aplikimit të grantit si dhe Termat e Referencës për Kompaninë që do të kryejë Strategjinë e SKS. Me VKM Nr. 719, datë 05.12.2018 është miratuar letërmarrëveshja e Grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Ndërtim dhe Zhvillim.

**8. Projekti “Mbështetje për zbatimin e aktiviteteve të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2020, në Shqipëri”**

Në kuadër të Programit IPA 2014 INSTAT është përfitues i Grantit “Mbështetje për zbatimin e aktiviteteve të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2020, në Shqipëri”.

Qëllimi i grantit është që të mbështesë INSTAT në kryerjen e aktiviteteve operative të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2020, në mënyrë që politikbërësit, qeverisja qendrore, ajo lokale dhe qytetarët e Shqipërisë të disponojnë dhe shfrytëzojnë statistika të përditësuara dhe gjithëpërfshirëse mbi popullsinë rezidente të vendit.

Gjatë vitit 2018, INSTAT ka përgatitur dhe përcjellë pranë CFCU paketën e aplikimit për Grantin. Më 11.12.2018 është nënshkruar kontrata e Grantit ndërmjet INSTAT dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Financimit dhe Kontraktimit (CFCU) pranë Ministrisë së Financave të Shqipërisë, aprovuar nga Bashkimi Evropian.

Gjatë kësaj periudhe raportuese janë përgatitur Termat e Referencës për Asistencën Teknike, si dhe kanë filluar procedurat e prokurimit për përzgjedhjen e kompanisë.

## **Burimet njerëzore dhe financiare**

---

Menaxhimi i burimeve njerëzore është i orientuar në zhvillimin e aftësive të punonjësve, mbështetjen në punë, identifikimin dhe trajnimin e tyre, duke synuar përfshirjen e personelit dhe rritjen e angazhimit drejt zhvillimit të qëndrueshëm institucional dhe rritjes së vazhdueshme të performancës.

Në këtë kuadër, INSTAT ka ndërmarrë disa hapa dhe është në proces të vazhdueshëm të hartimit të politikave dhe strategjivë që ndihmojnë në arritjen e objektivave institucionale dhe zhvillimin e aftësive të punonjësve.

Në funksion të përmirësimit të rezultateve të kënaqësisë së punonjësve, INSTAT kryen anketën e kënaqësisë së punonjësve, si një strategji të vazhdueshme mbi analizën e faktorëve që ndikojnë në uljen apo rritjen e kënaqësisë së punonjësve dhe hartimin e planit të veprimit mbi rritjen e kënaqësisë së punonjësve.

Në Maj të vitit 2018, është hartuar Strategjia e trajnimeve INSTAT si dhe kalendari vjetor i trajnimeve, me qëllim ngritjen, përmirësimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm të njohurive profesionale të përditësuara jo vetëm për personelin e INSTAT, por edhe të agjencive statistikore, medias, botës akademike, përdoruesve të ndryshëm të statistikave zyrtare.

Objektivat kryesorë të strategjisë së trajnimeve:

- Organizimin e trajnimeve duke patur si fokus prioritetet aktuale, si: Cilësia statistikore; Përdorimi i burimeve administrative; Njohuri bazë mbi statistikat për administratën publike;
- Organizimi i trajnimeve në një sistem të unifikuar;
- Organizimi i trajnimeve profesionale si shtesë e kurseve të trajnimit të detyrueshme dhe administrative;
- Përqëndrimi i trajnimeve në punën që realizohet aktualisht nga INSTAT, duke zhvilluar aftësitë praktike dhe për tu plotësuar me njohuritë teorike;
- Organizimin e trajnimeve cilësore si nga ana e përmbajtjes së temave të trajnimeve ashtu dhe nga niveli i pjesëmarrësve në trajnime

Gjithashtu, në këtë kuadër është ngritur Qendra e Trajnimit Statistikor, si një instrument për të siguruar infrastrukturën e nevojshme trajnuese të target grupeve. Kjo qendër e ushtron veprimtarinë e saj në bashkëpunim të ngushtë me Shkollën e Administratës

Publike (ASPA), në përputhje me nenin 8 të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe nenet 27, pika 4 e 28 të ligjit për statistikat zyrtare.

Për përmirësimin e vazhdueshëm të punës dhe informatizimin e informacionit për Burimet Njerëzore, në nëntor të vitit 2018, ka filluar implementimi i Softit të Burimeve Njerëzore, i cili përfshin të gjitha modulet të cilët do të ndihmojnë në përmirësimin e proceseve të punës të këtij sektori.

#### **Aktivitetet të realizuara për vitin 2018**

Në prill të vitit 2018 u miratua në Kuvendin e Shqipërisë Ligji 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare” dhe me hyrjen në fuqi të këtij ligji, INSTAT kalon institucion i pavarur. Bazuar në ligjin e sipërpërmendur Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse ka në përgjegjësinë e saj detyrat dhe përgjegjësitë e Njesisë Përgjegjëse për të kryer procedurat e rekrutimit referuar Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Në këtë kuadër, gjatë vitit 2018, Njësia përgjegjëse në INSTAT në zbatim të Ligjit nr.152/2013 “Ligji për Nëpunësin Civil”, si dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tij mbi proceset e rekrutimeve, është angazhuar me zhvillimin e procedurave të rekrutimeve për punonjës të strukturës, pjesë e shërbimit civil, për plotësimin e pozicioneve vakante të institucionit.

Miratimi në Kuvendin e Shqipërisë i strukturës së re organizative të INSTAT, me Nr.127/2018 datë. 29.12.2018, i jep një formë të re organizative Institutit të Statistikave.

Në organikën e re të INSTAT, e miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me nr. 127/2018 datë 29.12.2018, janë miratuar 20 punonjës të rinj shtesë.

Struktura e re e INSTAT ka në organikën e saj pozicionin e Sekretarit të Përgjithshëm si nëpunësi më i lartë civil në institucion, i cili ka rol kryesor në formulimin e politikave, koordinon dhe garanton përfshirjen e kontributeve të dhëna nga njësitë administrative dhe/ose institucionet e tjera gjatë procesit të formulimit të politikave, sipas fushës së përgjegjësisë që mbulon institucioni.

Gjithashtu janë krijuar tre drejtori të përgjithshme të cilat, bazuar në fushat e përgjegjësisë së secilës prej tyre dhe duke mbajtur parasysh interesat më të mira të vendit për statistika zyrtare, do të asistojnë Drejtorin e Përgjithshëm në menaxhimin e

institucionit. Gjithashtu, ato do të përcjellin synimet dhe vizionin e menaxhimit të drejtimeve të institucionit në agjencitë e tjera statistikore.

Struktura e re organizative ka në organikën e saj në total 236 punonjës (nga 216 që kishte më përpara), 174 punonjës qendër dhe 50 punonjës në Zyrat Rajonale si dhe 12 punonjës me klasë page.

Si dhe në vitet e mëparshme stafi INSTAT-it përbehet kryesisht nga gjinia femërore. Përqindja e vendit që zënë femrat është 69% kundrejt meshkujve me 31 %.

**Rekrutime.** Njësia Përgjegjëse në INSTAT gjatë vitit 2018 ka përfunduar procedurat e rekrutimeve sipas Ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin civil” për 41 punonjës.

**Praktikantët.** Në kuadër të “Programit Kombëtar të Praktikave të punës për vitin 2018”, INSTAT ka përzgjedhur dhe kanë përfunduar me sukses 10 praktikantë.

Në përfundim të periudhës 3-mujore të praktikës në kuadër të këtij programi janë kontraktuar me kontratë 1-vjecare - 2 Specialist Praktikantë.


**Punonjës me kontratë afatgjatë dhe me kontratë afatshkurtër.** Gjatë vitit 2018 janë kontraktuar 309 punonjës me kontratë afatgjatë në pozicionet kontrollor, kontrollor anketimi, operator dhe anketues. Numri i punonjësve me kontratë afatshkurtër ka qënë 836 të punësuar në pozicionet , anketues me kontratë të përkohshme në pozicionet sipas anketave, anketues, operatorë dhe kontrollorë ankete.

#### **Trajnimet e stafit.**


Gjatë vitit 2018 janë trajnuar gjithësej 12 punonjës në trajnime afatgjata në kuadër të programeve të BE-së dhe Eurostat IPA me shumë përfitues, si dhe 69 punonjës në trajnime të tjera 3-4 ditore.

Gjithashtu, gjatë vitit 2018, Instituti i Statistikave, në zbatim të ligjit 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare” si dhe të “Strategjisë së Trajnimeve, 2018”, ka zhvilluar një sërë trajnimesh (11 në total) për punonjësit e INSTAT, por jo vetëm. Përveç trajnimeve të zhvilluara me punonjësit e INSTAT, janë zhvilluar trajnime për institucionet e administratës shtetërore, ku mund të përmendim trajnimet e zhvilluara me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve apo edhe me Qendrën Kombëtare të Biznesit mbi njohjen e Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike (NVE).

**Figura 8: Rekrutimet nga Njësia Përgjegjëse**



**Figura 9: Numri i punonjësve në raportin Femra/Meshkuj**



**Financa**

**Aktivitetet realizuara për vitin 2018**

INSTAT është institucionin publik qendror, i pavarur. Burimet e financimit për kryerjen e aktivitete statistikore dhe atyre mbështetëse sigurohen kryesisht nga buxheti i shtetit. Ndikim domethënës kanë edhe financimet e huaja nëpërmjet donatorëve apo granteve të alokuara nga ata, si dhe të ardhurat dytësore apo fondet jashtë limitit, të cilat sigurohen nga veprimtaritë dytësore që kryen INSTAT.


Për vitin 2018 janë shpenzuar nga buxheti i shtetit rreth 516,205 mijë lekë, së bashku me donatorët janë shpenzuar 560.3 milion lekë sipas tabelës së më poshtme:

Tabela 20: Shpenzimet

000/lek

Art	SHPENZIMET	FAKT					
		2013	2014	2015	2016	2017	2018
	Paga + kontribut	231,328	278,819	280,366	274,469	349,893	396,913
	Mallradhesherbimetetjera	59,071	60,091	57,575	58,318	67,427	62,330
	<b>Totali operative</b>	<b>290,398</b>	<b>338,910</b>	<b>337,941</b>	<b>332,787</b>	<b>417,320</b>	<b>459,243</b>
	Investime	2,997	6,928	6,401	11,599	18,902	27,560
<b>1</b>	<b>TOTALI BUXHETI</b>	<b>293,396</b>	<b>345,838</b>	<b>344,342</b>	<b>344,386</b>	<b>436,222</b>	<b>486,803</b>
	Paga + kontribut	12,942	14,055	6,518	6,539	11,526	9,500
	Mallradhesherbimetetjera	103	44	7,954	10,254	17,980	19,853
	<b>Totali operative</b>	<b>13,045</b>	<b>14,099</b>	<b>14,472</b>	<b>16,793</b>	<b>29,506</b>	<b>29,353</b>
	Investime	0	0	0	0	0	0
<b>2</b>	<b>TOTALI ngateardhurat</b>	<b>13,045</b>	<b>14,099</b>	<b>14,472</b>	<b>16,793</b>	<b>29,506</b>	<b>29,353</b>
	Paga + kontribut	1,146	527	869	3,515	1,313	2,080
	Mallradhesherbimetetjera	11,610	4,949	4,620	950	18,453	21,009
	<b>Totali operative</b>	<b>12,756</b>	<b>5,476</b>	<b>5,489</b>	<b>4,466</b>	<b>19,766</b>	<b>23,089</b>
	Investime	328					2,366
<b>3</b>	<b>Teardhura jashtë limiti</b>	<b>13,084</b>	<b>5,476</b>	<b>5,489</b>	<b>4,466</b>	<b>19,766</b>	<b>25,455</b>
	Paga + kontribut	8,514	4,558	723	1,430	1,746	3,666
	Mallradhesherbimetetjera	61,143	98,905	15,883	606	3,950	9,162
	<b>Totali operative</b>	<b>69,657</b>	<b>103,463</b>	<b>16,606</b>	<b>2,036</b>	<b>5,696</b>	<b>12,828</b>
	Investime	400		2,769		25,775	5,879
<b>4</b>	<b>Të ardhura donator</b>	<b>70,057</b>	<b>103,463</b>	<b>19,375</b>	<b>2,036</b>	<b>31,471</b>	<b>18,707</b>
	Paga + kontribut	253,930	297,959	288,476	285,953	364,477	412,159
	Mallradhesherbimetetjera	131,926	163,989	86,032	70,128	107,810	112,355
	<b>Totali operative</b>	<b>385,856</b>	<b>461,948</b>	<b>374,508</b>	<b>356,081</b>	<b>472,287</b>	<b>524,513</b>
	Investime	3,725	6,928	9,170	11,599	44,677	35,805
	<b>TOTALI</b>	<b>389,581</b>	<b>468,876</b>	<b>383,678</b>	<b>367,680</b>	<b>516,964</b>	<b>560,318</b>

Figura 10: Shpërndarja e shpenzimeve operative dhe investimeve në vitet 2012-2018 me fondet e buxhetit të shtetit paraqitet si më poshtë:





Siç shihet nga grafiku volumin kryesor të shpenzimeve në vite e zë pjesa e pagave të stafit të INSTAT-it dhe ajo e personave të kontraktuar me kohë të pjesshme.

Për shkak të natyrës së punës që ka institucioni, pjesën kryesore të shpenzimeve e zënë pagat e personelit me kohë të plotë dhe të pjesshme, si dhe kontributet e sigurimeve shoqërore të tyre.

Instituti të Statistikave për vitin ushtrimor 2018, i janë akorduar nga buxheti i shtetit 530,445 mijë lekë .

Për periudhën Janar- Dhjetor 2018, janë shpenzuar nga fondet e buxhetit të shtetit 516,205 mijë lekë .

Realizimi i shpenzimeve të Aparatit Qendror INSTAT dhe Zyrave të Statistikave në rrethe, sipas zërave të krahasuara me planin vjetor paraqitet në pasqyrat e mëposhtme:

**Tabela 21: Realizimi i shpenzimeve Janar - Dhjetor 2018**

mije /leke

Art	Shpenzimet	Plan	Fakt	Real % PR
600	<b>Paga</b>	<b>360,993.00</b>	<b>349,878.50</b>	<b>96.9</b>
	ZyratRajonale	30,710.00	30,606.80	99.7
	AparatiQendrorngabuxheti	322,183.00	311,174.60	96.6
	AparatiQendrorngateardhurat	8,100.00	8,097.10	100
601	<b>Kontribute sig shoq-shend</b>	<b>56,657.00</b>	<b>56,533.40</b>	<b>99.8</b>
	ZyratRajonale	5,169.00	5,108.50	98.8
	AparatiQendrorngabuxheti	50,038.00	50,022.00	100
	AparatiQendrorngateardhurat	1,450.00	1,402.90	96.8
602	<b>Mallradhesherbimetetjera</b>	<b>83,700.00</b>	<b>81,195.20</b>	<b>97</b>
	ZyratRajonale	5,000.00	4,683.00	93.7
	AparatiQendrorngabuxheti	58,700.00	56,658.90	96.5
	AparatiQendrorngateardhurat	20,000.00	19,853.30	99.3
604	<b>Transferimekorente</b>	<b>550</b>	<b>522.7</b>	<b>95</b>
	AparatiQendrorngabuxheti	550	522.7	95
606	<b>Transferimebuxheteshfamiljare</b>	<b>545.2</b>	<b>515.2</b>	<b>94.5</b>
	<b>SHUMA</b>	<b>502,445.20</b>	<b>488,645.00</b>	<b>97.3</b>
	<b>InvestimeAparatiQendror</b>	<b>28,000.00</b>	<b>27,560.30</b>	<b>98.4</b>
231	Shpenz per rritjen e AQ tetrup Buxheti	28,000.00	27,560.30	98.4
	<b>TOTALI</b>	<b>530,445.20</b>	<b>516,205.30</b>	<b>97.3</b>

Siç shihet nga pasqyra, në artikullin 600, paga (që zë rreth 68 % të buxhetit) janë shpenzuar 349,878, mijë lekë, e barabartë kjo me 96.9% krahasuar me planin vjetor .

Në artikullin sigurime shoqërore e shëndetsore janë shpenzuar 56,533 mijë lekë, e barabartë kjo me 99.8 % krahasuar me planin vjetor.

Në zërin mallra dhe shërbime të tjera, për vitin 2018 janë shpenzuar 81,195 mijë lekë, e barabartë kjo me 97 %,krahasuar me planin vjetor.

Në zërin transferime korente, për vitin 2018 janë shpenzuar 523 mijë lekë, e barabartë kjo me 95 %.

Në zërin transferime buxhetesh, për vitin 2018 janë shpenzuar 515 mijë lekë, e barabartë kjo me 94.5 %.

Në zërin investimet janë shpenzuar 27,560 mijë lekë ose 98.4 % e krahasuar me planin vjetor.

**Tabela 22: Buxheti sipas programit “Veprimtaria Statistike”**

Mijë/lekë


SHPENZIMET	Plani	Fakti	%
			Realizimit
Veprimtaria Statistike	530,445	516,205	97.3
Të ardhura jasht limitit	25,455	25,455	100
<b>TOTALI</b>	<b>555,900</b>	<b>541,660</b>	<b>97.3</b>

**Tabela 23: Realizimi i shpenzimeve Janar – Dhjetor 2018**

Mijë/lekë

Art	SHPENZIMET	Plan	Fakt	Real
				%
600	Paga+sig	417,650.00	406,411.90	97.3
602	Mallradhesherbimetetjera	84,795.20	82,233.10	97
	SHUMA	502,445.20	488,645.00	97.3
	InvestimeAparatiQendror	28,000.00	27,560.30	98.4
231	Shpenz per rritjen e AQ tettrupBuxheti			
	<b>TOTALI</b>	<b>530,445.20</b>	<b>516,205.30</b>	<b>97.3</b>

Figura 11: Shpenzimet 2018



Siç shikohet nga të dhënat e tabelës, plani i shpenzimeve të buxhetit në artikullin 600 (paga dhe sigurime) që zë rreth 79 % të tij është realizuar 97.3 %, në artikullin 602 shpenzime të tjera korrente që zë 16 % të buxhetit është realizuar 97 % dhe në artikullin 231 shpenzime për investime që zë 5 % të buxhetit është realizuar 98.4%. Shpenzimet totale janë realizuar 97.3 %, në krahasim me planin vjetor.

## Zbatimi i rekomandimeve

---

### Zbatimi i rekomandimeve të institucioneve kushtetuese ose të pavarura

Në vitin 2017, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka kryer dy autidime pranë Institutit të Statistikave, njëri në lidhje me zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare dhe tjetri në lidhje me standardet e infrastrukturës së teknologjisë për informacionin.

Rekomandimet e lëna (në total 8 rekomandime), janë pranuar dhe zbatuar nga INSTAT gjatë vitit 2018 dhe në vijim, për shkak të natyrës dhe specifikës së rekomandimit të lënë. Në formë më të detajuar, informacioni në vijim:

#### Rekomandimi 1

*“Instat të marrë masa në hartimin e PBA për të dyja fazat e saj, duke trajtuar qëllimin e politikave të programeve, objektivat e politikave të programeve, projektet e investimeve publike, produktet e programeve, dhe kostot e tyre respektive si dhe rastet e kërkesave shtesë të bëje argumentimin e tyre si dhe plotësimin e formateve standarte të MF.”*

#### Realizimi

Me shkresën nr. 378/2 prot. datë 28.01.2018 dhe shkresën nr. 378/5 Prot, datë 25.08.2017 INSTAT i ka dërguar Ministrisë së Financave programin buxhetor afatmesem 2018-2020 bashkë me pasqyrat e planifikimit buxhetor dhe relacionin shoqërues. Më shkresën nr. 448/2 datë 30.04.2018 INSTAT i ka dërguar Ministrisë së Financave programin buxhetor afatmesëm 2019-2021 të argumentuar në përputhje me ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor të Republikës së Shqipërisë". Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 10 datë 28.02.2017 dhe Udhëzimi plotësues të Ministrisë së Financave nr. 10/3 datë 13.07.2017 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020" bashkë me pasqyrat e planifikimit buxhetor dhe relacionin shoqërues. Referuar dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, evidentohet fakti se nga ana e subjektit të audituar është argumentuar procesi i planifikimit të kërkesave buxhetore afatmesme për vitet 2018-2020 në të dy fazat, janë trajtuar qëllimi dhe objektivat e politikave të programeve, projektet e investimeve publike produktet e programeve dhe kostot e tyre respektive, ndërsa në rastet e kërkesave shtesë është bërë argumentimi i tyre dhe plotësimi i formateve standarde të Ministrisë së Financave 2018-2020. **Grupi i auditimit vlerëson se zbatimi i këtij rekomandimi është i pranuar dhe i zbatuar.**

#### Rekomandimi 2

*“Institucioni gjatë hartimit të raportit të monitorimit si dhe raporteve periodike të cilat dorëzohen në ministrinë e financave të kryhen me të gjitha argumentimet si cilësore ashtu dhe sasiore si dhe të argumentohen mosrealizimi i produkteve dhe parashikimi i tyre në të ardhmen për realizimin e tyre. INSTAT-i të marrë masa ku pas përfundimit të raporteve 3-mujore ti publikojë ato në faqen zyrtare të tyre dhe si rezultat në faqen e MF.”*

*Realizimi*

Me shkresën nr. 336 datë 27.02.2018 INSTAT ka dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit raportin e monitorimit të ecurisë së zbatimit të buxhetit për vitin 2017. Referuar raportit INSTAT ka marrë masa duke reflektuar të gjithë elementët. **Rekomandimi është i pranuar dhe i zbatuar.**

**Rekomandimi 3**

*“- Të merren masa dhe të nxirren përgjegjësitë konkrete ndaj personave shkaktarë përgjegjës për detyrimet financiare të krijuara në dëm të buxhetit si pasojë e vendimeve të gjykatave.*

*- INSTAT të marrë masa dhe të bashkëpunojë me DAP për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë për ish punonjësit me të drejtë rikthimi në vendin e punës, në mënyrë që të ndërpritet rritja e detyrimeve financiare në buxhetin e shtetit.*

*- Të gjitha detyrimet e krijuara sipas vendimeve të gjykatave të ekzekutohen në mënyrë vullnetare pa urdhër të ekzekutimit të përmbaruesit me qëllim eliminimin e pagesës së tarifës së shërbimit të përmbaruesit.”*

*Realizimi*

-Rekomandimi është pranuar, por në momentin e auditimit të zbatimit të rekomandimit Institucioni sqaron se e ka të pamundur zbatimin e rekomandimit në vazhdimësi për arsye se titullari i asaj kohe është ndarë nga jeta dhe vendimmarrjet e gabuara janë marrë nga titullari i cili ka nderruar jetë. Cdo veprim juridik në lidhje me marrje masash apo dhe nxjerrje të përgjegjësive ndaj personave shkaktarë përgjegjës për detyrimet financiare të krijuara në dëm të buxhetit si pasojë e vendimeve të gjykatave do të ishte një veprim juridik i pavlefshëm. **Rekomandimi është pranuar i pa zbatuar për efekt të pushimit juridik të vlefshmerisë së veprimit.**

-Rekomandimi që Instituti i Statistikave të ndjekë të gjitha shkallët e gjykimit për të gjitha rastet ankimimit, ndaj vendimit të titullarit dhe ish titullarëve të institucionit për largim nga puna, **është pranuar dhe zbatuar.**

-Rekomandimi të gjitha detyrimet e krijuara sipas vendimeve të gjykatave të ekzekutohen në mënyrë vullnetare, pa urdhër ekzekutimi përmbaruesi, me qëllim eliminimin e pagesës së tarifës së shërbimit të përmbaruesit **është pranuar dhe zbatuar.**

-Instituti i Statistikave të marrë masa dhe të bashkëpunojë me Departamentin e Administratës Publike, për zbatimin e vendimeve të formës së prerë, për ish punonjësit, me të drejtë rikthimi në vendin e punës, në mënyrë që të ndërpritet rritja e detyrimeve financiare në buxhetin e shtetit **është pranuar dhe zbatuar.**

**Rekomandimi 4**

*“Autoriteti Kontraktor, INSTAT, të marrë masa që në çdo fillim viti kalendarik në pamundësi të ngritjes së njësisë së prokurimit, të përzgjedhe burime njerëzore në njësitë e prokurimit të cilat duhet të jenë të trajnuara pranë APP ose të aplikohet marrja e ekspertëve të jashtëm në*

përputhje me bazën ligjore të prokurimeve, të vendosen specialistë të fushës përkatëse, me qëllim që të përlogaritet sa më drejtë fondi limit, përzgjedhja e llojit të procedurave, përcaktimi i kërkesave specifike në DT, në mbështetje të bazës ligjore, duke sjellë rritjen me efikasitet, efektivitet dhe ekonomikitet, të përdorimit të fondeve publike në dispozicion të institucionit.”

*Realizimi*

Grupi i auditimit vlerëson se subjekti me shkresën nr. 65 datë 15.01.2018 ka hartuar listën e personave pjesë të procesit të prokurimeve për vitin 2018 si dhe trajnimet për prokurimet janë të përfshira në kalendarin e trajnimeve. **Rekomandimi cilësohet i zbatuar.**

#### **Rekomandimi 5**

“Autoriteti Kontraktor, INSTAT, të marrë masa nëpërmjet Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, të realizojë monitorimin e Kontratës, duke u bazuar në çmimin e deklaratave doganore.”

*Realizimi*

INSTAT ka zbatuar rekomandimin në fjalë për procedurën e prokurimit për vitin 2018. **Grupi i auditimit vlerësoi se ky rekomandim është zbatuar.**

#### **Rekomandimi 6**

“Nga ana e strukturave drejtuese të INSTAT të merren masat që të realizohen në kohë procedurat e përqëndruara tenderuese në përputhje me bazën ligjore të prokurimit publik, në mënyrë që të kemi përdorim me efektivitet të fondeve publike.”

*Realizimi*

Grupi i auditimit vlerësoi se **zbatimi i këtij rekomandimi është i ezauruar**, pasi me ndryshimet ligjore të VKM nr. 81 dhe 82 14.02.2018 janë pasqyruar.

#### **Rekomandimi 7**

“Nga ana e titullarit të INSTAT duhen marrë masat e menjëhershme për plotësimin e vendeve vakante në sektorin e auditimit si dhe Drejtori i Përgjithshëm të shqyrtojë mundësinë e rritjes së numrit të audituesve në INSTAT me qëllim mbulimin e të gjitha fushave me risk dhe rritjen e frekuencës së angazhimeve të auditimit. Sektori i auditimit të brendshëm të marrë masat që të rrisë frekuencën e auditimeve të IT dhe auditimeve të performancës në INSTAT. Të merren masa nga menaxhimi i lartë për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga sektori i auditimit të brendshëm.”

*Realizimi*

Pavarësisht se grupi i auditimit vlerësoi se zbatimi i rekomandimit i takon auditimit të radhës për të parë rezultatet e tij, ai **konsiderohet i pranuar dhe zbatuar**. INSTAT e ka ezauruar këtë rekomandim pasi janë plotësuar të gjitha vendet vakante në Sektorin e Auditimit të Brendshëm, me qëllim realizimin e rekomandimit brenda vitit 2018.

#### **Rekomandimi 8**

*“INSTAT të marrë masa për trajnime të vazhdueshme të stafit dhe hartimin e një programi trajnimesh. Sipas mundësive të institucionit trajnimet që gjeneron INSTAT si brenda dhe jashtë vendit përfshijnë të gjithë stafin sipas një skematike bazuar kjo në barazi dhe reciprocitet.”*

#### *Realizimi*

Nga materiali i vënë në dispozicion grupit auditimit u konstatua nga grupi i auditimit se është hartuar Strategjia e Trajnimeve për vitin 2018-2020 si (dhe kalendari i trajnimeve që do shërbejë si plan veprimi për vitin 2018 dhe në vazhdim. **Grupi i auditit vlerësoi se rekomandimi është zbatuar (në vazhdimësi).**

Për sa i takon auditimit të dytë, ekipi auditues ka studiuar dokumentacionin rregullator dhe infrastrukturën IT që përdor INSTAT në mbështetje të të gjitha proceseve të përpunimit statistikor. Pas kryerjes së procesit auditues, ekipi i kontrollit ka lënë 7 rekomandime për tu plotësuar nga institucioni. Për realizimin e tyre, bazuar në kërkesat dhe afatet e lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, është hartuar një plan konkret veprimi i cili, nga ana tjetër, është rivlerësuar nga institucioni auditues. Rekomandimet sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar, janë pranuar 100% nga INSTAT. Realizimi i rekomandimeve të lëna për tu zbatuar në mënyrë të menjëhershme dhe në periudhë 3 mujore, është zbatuar 100%, ndërsa rekomandimet e lëna për zbatim në vazhdimësi janë akoma subjekt i zbatimit nga ana e institucionit. Për më gjërë në vijim janë rekomandimet në detaj.

#### **Rekomandimi 1**

*“Drejtorja e Teknologjisë së Informacionit dhe strukturat drejtuese të INSTAT-it të adresojnë qartë objektivat në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe duke marrë në konsideratë kohën, burimet e nevojshme të marrin masa për hartimin e miratimit të Planit Strategjik të Teknologjisë së Informacionit”*

#### *Realizimi*

Në zbatim të këtij rekomandimi, Drejtorja e Teknologjisë së Informacionit e INSTAT hartoi “Strategjinë e Teknologjisë së Informacionit” dhe “Planin Strategjik të Teknologjisë së Informacionit”, miratuar nga Titullari i Institucionit me Vendimin nr. 1106/14 Prot, datë 20/03/2018 “Për miratimin e Strategjisë dhe Planit strategjik të Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit”. Sipas Grupit të auditimit, **rekomandimi është zbatuar plotësisht.**

#### **Rekomandimi 2**

*“Strukturat drejtuese të INSTAT-i të marrë masa në të ardhmen që për standardet, politikat dhe rregulloret e reja dhe ndryshimet e tyre të aprovohen nga organet përkatëse përpara përdorimit. Drejtorja e Teknologjisë së Informacionit duhet të marrë masa për menaxhimin e ndryshimit nëpërmjet komunikimit, trajnimit e testimit në të gjitha nivelet e organizatës në intervale sistematike kohore të ndryshimeve në rregulloret dhe procedurat korresponduese”*

*Realizimi*

Të gjitha rregulloret e reja apo ndryshimet e rregulloreve ekzistuese janë aprovuar nga organet përkatëse përpara përdorimit të tyre. Lista e rregulloreve të hartuara dhe miratuara gjatë vitit 2018:

“Strategjia e Teknologjisë së Informacionit”

“Plani Strategjik të Teknologjisë së Informacionit”

“Rregullorja për hapjen dhe mbylljen e Përdoruesve në Sistemet e Teknologjisë së Informacionit”

“Strategjia e rimëkëmbjes nga katastrofat”

“Planin e Vazhdueshmërisë së Biznesit”

Sipas Grupit të auditimit, **rekomandimi është zbatuar plotësisht.**

**Rekomandimi 3**

*“Strukturat drejtuese të INSTAT, duke marrë në konsideratë kohën dhe burimet e nevojshme, të marrin masa për hartimin e politikave dhe planeve të menaxhimit të riskut, si dhe të përcaktojnë burimet e mjaftueshme për të menaxhuar risqet.”*

*Realizimi*

Regjistri i riskut është miratuar nga Grupi i Menaxhimit Strategjik në mbledhjen e datës 20/02/2018, me vendimin e Titullarit të Institucionit nr. 352/1 Prot., datë 28/02/2018.

**Rekomandimi cilësohet i zbatuar.**

**Rekomandimi 4**

*“INSTAT të marrë masa për plotësimin e burimeve njerëzore në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit duke plotësuar vendet vakante si dhe hartimit të politikave për menaxhimin e ndryshimeve të tyre për pozicionet kritike.”*

*Realizimi*

Spektori i Burimeve njerëzore në INSTAT brenda muajit shkurt 2018 ka ngarkuar në sistemin e rekrutimit online të DAP pozicionet vakante të Drejtorisë së TI. Pas ndryshimit të varësisë së institucionit për efekt të ligjit të ri ku Njësia Përgjegjëse e rekrutimeve i kaloi institucionit, janë shpallur konkurset për pozicionet vakante në muajin Maj dhe Qershor për 9 pozicione të Drejtorisë së TI. **Rekomandimi cilësohet i zbatuar.**

**Rekomandimi 5**

*“Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit e INSTAT të hartojnë, miratojnë e zbatojnë rregulla për hapjen dhe mbylljen e përdoruesve në sistemet e teknologjisë së informacionit, gjurmët e procesit të dokumentohen”*

*Realizimi*



Në zbatim të këtij rekomandimi Drejtorja e Teknologjisë së Informacionit hartoi “Rregulloren për hapjen dhe mbylljen e Përdoruesve në Sistemet e Teknologjisë së Informacionit” e cila është miratuar nga Titullari i Institucionit me Vendimin nr. 1106/13 Prot., datë 24/01/2018. **Rekomandimi cilësohet i zbatuar.**

#### **Rekomandimi 6**

*“INSTAT, të marrë masa të për të:*

*a. ndërtuar një strategji të rimëkëmbjes nga katastrofat;*

*b. kryerjen e vlerësimit e aseteve të Teknologjisë së Informacionit dhe hartimin e listës të artikujve prioritarë për proceset emergjente;*

*c. të parashikojë dhe të realizojë investime me qëllim mundësimin e ofrimit të shërbimit pa ndërprerje dhe parandalimin e humbjes ose të shkatërrimit aksidental të të dhënave;*

*d. të hartojë Planin e Vazhdueshmërisë së Biznesit;*

*e. të marrë masa për krijim e ambienteve të testimit të BACKUP dhe kryejë testimet dhe dokumentimin e procesit*

#### *Realizimi*

a. Drejtorja e Teknologjisë së Informacionit, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse ka përgatitur Strategjinë e Rimëkëmbjes nga Katastrofat.

b. Drejtorja e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në bashkëpunim me Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit ka kryer vlerësimin e aseteve të Teknologjisë së Informacionit dhe ka hartuar Listën e artikujve prioritarë për proceset emergjente.

c. Institucioni për të realizuar mundësinë e zbatimit të rekomandimit të lënë po vlerëson mundësinë e realizimit të investimeve me qëllim mundësimin e ofrimit të shërbimit pa ndërprerje dhe parandalimin e humbjes ose të shkatërrimit aksidental të të dhënave. Ky rekomandim është objekt i realizimit në vijimësi.

d. Drejtorja e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në bashkëpunim me Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit ka hartuar Planin e Vazhdueshmërisë së Biznesit.

e. Drejtorja e Teknologjisë së Informacionit, në kuadër të zbatimit të projektit Sida (Sida Direct Funding), ka marrë masa për krijimin e sistemit të testimit të BACK-UP dhe të kryejë testimet dhe dokumentimin e procesit. Ky proces do të finalizohet pas migrimit të serverave aktualë tek ata të rinj (projekti Sida Direct Funding).

Aktet për zbatimin e pikave a, b dhe d janë miratuar nga Grupi i Menaxhimit Strategjik në mbledhjen e datës 20/02/2018 me vendimin e Titullarit të Institucionit nr. 352/1 Prot., datë 28/02/2018.

**Rekomandimi cilësohet i zbatuar.**

#### **Rekomandimi 7**

“INSTAT për të rritur sigurinë fizike dhe logjike të dhomës së serverave në drejtim të uljes së riskut të aksesit të paautorizuar, vendosjes vetëm të pajisjeve të përcaktuara në këto ambiente, ngritjes së sistemeve të përshtatshme kondicionimi, ndarjes së sistemeve elektrike, vendosjes së sistemeve të mbrojtjes e sinjalizimit të marrë masa të dokumentuara për përmirësimin e kushteve në dhomat e serverave, duke analizuar dobësitë të hartohet një plan veprimi bazuar në specifikimet e rregullores së AKSHI-t “për ndërtimin e dhomës së serverave”.”

#### *Realizimi*

Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit, ka marrë masa për hartimin e planit të veprimit për përmirësimin e kushteve në dhomën e serverave, bazuar në specifikimet e rregullores së AKSHI-t "Për ndërtimin e dhomës së serverave" brenda datës 30.03.2018, "Aneksi 1. Plani Strategjik i Teknologjisë së Informacionit".

Më konkretisht deri tani është realizuar:

- Heqja e pajisjes së sistemit të kondicionimit të qendëruar nga ambientet e dhomës së serverave.
- Largimi i pajisjeve që nuk janë të nevojshme për dhomën e serverave.
- Instalimi i sistemit të video survejimit brenda dhe jashtë ambienteve të dhomës së serverave.
- Prokurimi i instalimit të një dërrës të re dhe akses kontrolli për dhomën e serverave. Është në proces lidhje kontrate
- Prokurimi i instalimit të sistemit të mbrojtjes nga zjarri. Është në proces zbatimi kontrate.
- Instalimi i kondicionerëve të përshtatshëm për dhomën e serverave.

#### **Grupi auditues e cilëson rekomandimin të zbatuar**

Në Raportin përfundimtar të dorëzuar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, rezulton se janë marrë të gjitha masat për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi.

#### **Informacion mbi konfliktet gjyqësore ku INSTAT është palë**

INSTAT është palë në një numër të konsiderueshëm çështjesh gjyqësore, të bartura kryesisht që nga viti 2013, të cilat kanë të bëjnë me padi për pavlefshmërinë e vendimeve administrative për ndërprerjen e punës dhe shpërblim dëmi, padi për ekzekutimin e detyrimeve kontraktore dhe kundërshtimin e veprimeve përmbarimore.

INSTAT është thirrur si person i tretë në konflikte administrative për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës së nëpunësve civilë, si dhe në një çështje ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Drejtën e Informimit, e cila ka të bëjë me respektimin e konfidencialitetit të të dhënave statistikore, mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtën e informimit.

Për çështjet që kanë për objekt pavlefshmëri të zgjidhjes së marrëdhënieve të punës dhe shpërblim dëmi, aktualisht janë paraqitur nga INSTAT, si palë e paditur, 6 rekurse pranë Gjykatës së Lartë si dhe 4 rekurse nga palët paditëse.

Përsa i takon pavlefshmërisë së titujve ekzekutivë për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, aktualisht janë në shqyrtim dy çështje pranë Gjykatës së Apelit.

Në një çështje tjetër, e cila është në shqyrtim nga Gjykata Administrative e Apelit, INSTAT është thirrur si i paditur për pretendimin për mosekzekutimin e detyrimeve kontraktuale.

Përsa i takon kallzimeve apo çështjeve penale, nuk janë regjistruar raste të tilla në lidhje me veprimtarinë e institucionit.

## **Kontaktet e institucionit**

---



**INSTAT - Instituti i Statistikave**

**Instituti i Statistikave - Tiranë**

**Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tiranë, Kodi Postar 1017**

**Email: [info@instat.gov.al](mailto:info@instat.gov.al)**

**Telefon+(355) 42222411**